



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
Raport për auditimin e ushtruar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore

RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT

“Mbi Përputhshmërinë”

Tiranë, Shtator 2024

Nr.	Përmbajtja	
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1.	Përshkrim i shkurtër i auditimit	3-4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	4-5
3	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-6
II	HYRJE	6
1.	Objektivat dhe qëllimi	6
2.	Identifikimi i çështjes	7
3	Përgjegjësitë e strukturave	7
4.	Përgjegjësitë e audituesve	7-8
5.	Kriteret e vlerësimit	8
6.	Standardet	8-9
7.	Metodat e auditimit	9
8.	Dokumentimi i auditimit	9
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	9
1	Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	9-10
2	Përshkrimi i auditimit sipas drejttimeve të auditimit.	10-92
2.1	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	10-14
2.2	Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore.	14-20
2.3	Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2023.	20-50
2.4	Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.	50-55
2.5	Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023.	55-61
2.6	Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore.	61-65
2.7	Mbi procedurat e prokurimit me fonde publike dhe zbatimin e kontratave.	65-81
2.8	Auditimi mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.	81-86
2.9	Mbi përputhshmërinë e procedurave të kryera në përlogaritjen dhe pagesat e pensioneve, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës.	86-89
2.10	Të tjera të dala gjatë auditimit.	89-92
IV	REKOMANDIME	92-101

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr.476/1 prot; datë 15.04.2024, i ndryshuar me nr. 476/2 prot; datë 08.05.2024, për veprimtarinë nga data 01.01.2023 deri në datën 31.12.2023.

a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është një institucion publik i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar bazuar në nenin 71, të këtij ligji misioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) është administrimi sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij institucioni, mbulimi i popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë, rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar, përmirësimi i efikasitetit në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë, mbulimi i të gjithë popullsisë me element të sigurimeve shoqërore dhe akordimi i përfitimeve për pension, paaftësi të përkohshme në punë, barrëlindje, aksidente në punë dhe sëmundje profesionale e përfitime suplementare në momentin e lindjes të së drejtës dhe nevojës për to.

Objektivat: Garantimi i mbulimit sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme, të mbajtura në nivele të pranueshme; Zbatimit të një sistemi sigurimesh shoqërore që i përgjigjet më mirë stadit të arritur në zhvillimin ekonomik e social të vendit; Përsosjes së menaxhimit të skemës së sigurimeve shoqërore, sidomos të mbledhjes së të ardhurave kontributive dhe shpërndarjes sa më të drejtë të tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta. Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore, duke synuar rritjen graduale më të shpejtë të kontributeve në krahasim me rritjen e përfitimeve si dhe duke minimizuar subvencionet buxhetore.

b. Rëndësia e auditimit:

Auditimi i këtij institucioni ka rëndësi, duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që lidhen me vlerësimin e aktivitetit të saj, si administrimin e sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij Institucioni, mbulimi i popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë, rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetarë, përmirësimi i efikasitetit në menaxhimin e fondeve për administrimin e sistemit të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.

c. Qëllimi i auditimit:

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023-31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësime me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar.

Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Ligjshmëria e hartimit dhe zbatimit të buxhetit
- Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore.
- Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2023.
- Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.
- Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023.
- Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore.
- Mbi procedurat e prokurimit me fonde publike dhe zbatimin e kontratave.
- Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.
- Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.

- Mbi përputhshmërinë e procedurave të kryera në përlllogaritjen dhe pagesat e pensioneve, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes së të dhënave:

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është në varësi të çështjeve të auditimit, ku janë përdorur veçmas metodat dhe teknikat e mëposhtme: verifikimi i buxhetit, prokurimeve publike, llogaritja e pensioneve etj.

e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë, për të cilat Grupi i auditimit ka konstatuar 20 gjetje dhe ka dhënë 21 rekomandime.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:

Nga auditimi në ISSH, u konstatuan disa nga gjetjet kryesore janë:

Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara nga ISSH (kontributet/të ardhura tatimore) dhe të dhënave të treguesve fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit të MFE, rezulton se fakti i të ardhurave nga fondet speciale (sigurimet shoqërore) paraqiten në vlerën 124,628 milionë lekë, ndërsa nga ISSH, janë deklaruar 124,618 milionë lekë, ose 10 milionë lekë më shumë.

- Në planifikimin strategjik për vitin 2023, tavanet e shpenzimeve të dërguara nga MFE janë 585 milionë lekë më pak se sa shpenzimet e planifikuara nga ISSH. Hartimi i treguesve të buxhetit vjetor dhe afatmesëm në fazën strategjike kryhet i përqëndruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së, duke mos përfshirë 15 njësitë shpenzuese rajonale.

- Shqyrtimi dhe miratimi i PBA-së nuk ka ndjekur të gjitha hapat e procedurës deri në miratimin në Këshillin Administrativ.

- Nga DIP rezultojnë 9,614 dosje të pa inspektuara dhe të pa çertifikuara, nga të cilat 8,775 dosje pensioni të pa inspektuara, që i përkasin vitit 2020 si dhe 839 dosje që i përkasin viteve 2019-2021, për rishqyrtim.

- Në DRSSH-të, ndalesa e masës së pensionit në një pjesë të konsiderueshme është kryer në masën 20%, në kundërshtim të nenit 62, pika 2, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar.

- Në sistemet CMIS dhe PCAMS, janë konstatuar 3 raste të përfitimit të padrejtë, pasi përfituesit kanë rezultuar njëkohësisht ekonomikisht aktiv në administratën publike/institucione shtetërore, që në momentin e lidhjes së pensionit, në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 i ndryshuar.

- Nga auditimi i dosjeve të përfituesve për pensione në sistemet CMIS dhe PCAMS, janë konstatuar 3 raste të përfitimit të padrejtë, pasi: a) përfituesit kanë rezultuar njëkohësisht ekonomikisht aktiv në administratën publike/institucione shtetërore.

- Në një rast njësia e prokurimit ka vendosur kritere të veçanta jo në përputhje me objektin e prokurimit.

h. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

Me qëllim zgjidhjen e problematikave, janë dhënë disa rekomandime si vijon:

- Titullari i Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të shqyrtojnë mospërputhjet me Treguesit e Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, përta i përket fondeve për ISSH.
- Drejtoria e Financës në vijim, të marrë masa të duhura për një planifikim sa më real të fondeve buxhetore nëpërmjet analizave të mirë studiuar të sistemit të sigurimeve shoqërore me qëllim shmangien e transferimeve buxhetore midis artikujve dhe midis njërive shpenzuese. Shqyrtimi dhe miratimi i PBA-së të ndjekë të gjitha hapat e procesit deri në miratimin në Këshillin Administrativ, në përputhje me kërkesat e ligjit të sigurimeve shoqërore.
- Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të ISSH, si dhe rakordimit të tyre me strukturat përkatëse, ka rezultuar se nga ISSH, detajimi planit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe analizimi i tyre (fakt/plan), është kryer duke përfshirë në këtë plan dhe fakt edhe të ardhurat jo tatimore, ose "Të tjera DPT dhe ISSH" në shumën 1,740,926 mijë lekë. Në

përfundim, realizimi i të ardhurave nga kontributet e mbledhura nga DPT dhe ISSH, kundrejt planit të miratuar nga MFE është në masën 98,6% dhe jo në masën 100 % të raportuar nga ISSH.

- Strukturat drejtuese të ISSH-së, në vijim, në detajimin e planit të të ardhurave nga kontributet dhe të realizimit të tyre, nuk duhet të përfshihen të ardhurat jo tatimore (Të tjera DPT dhe ISSH), në zbatim të klasifikimit të të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, sipas Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pjesë e ligjit dhe akteve normative.
- Drejtori i Përgjithshëm, të hartojë plan masash me afate, për të mundësuar certifikimin e dosjeve të pa certifikuar, duke vlerësuar të angazhojë edhe Drejtorinë e Përfitimeve në ISSH, e cila ka në përbërje të saj specialistë të fushës së lidhjes së pensioneëve. Gjithashtu, të marrë masa për inspektimin dhe certifikimin e të gjitha dosjeve të përfituesve brenda afatit 3-vjeçar.
- Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa që DRSSH-të të ndryshojnë masën e ndalesës së pensioneëve nga 20% në 50%, ashtu siç parashikohet në përcaktimet e nenit 62, pika 3, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, si dhe të marrë masa dhe të sigurohet që ndalesa e pensionit të jetë në përpjestim të drejtë me indeksimin e tij.
- Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për analizimin e situatës si dhe të nxjerrë përgjegjësitë sipas rasteve, të marrë masa për rishqyrtimin e dosjeve të nxjerra me problematikat e trajtuara dhe të evidentuara nga ana e grupit të auditimit, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune i cili të kryej në mënyrë periodike ballafaqimet midis sistemit CMIS dhe PCAMS.
- Nga auditimi rezultoi se në rreth 462 dosje përfitimi, DRSSH/DSSH nuk kanë zbatuar afatet e përcaktuara sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, neni 62, pika 2.
- Titullarët e DRSSH/DSSH-ve, të marrin masa dhe të sigurohen që dosjet e konstatuara me problematikë nga ana e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve, të rishqyrtohen brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e DIP dhe të përcaktimeve ligjore.
- Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo aplikimin për kriteret e veçantë të jetë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

Opinion për auditimin e përputhshmërisë:

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nënligjore (kriteret e paracaktuara të vlerësimit), për veprimtarinë ISSH mbi politikën e pensioneëve në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore; planifikimit dhe realizimin e buxhetit; të inspektimit të pensioneëve; menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore; menaxhimit financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm; procedurat e prokurimit publik, si dhe përputhshmërinë e procedurave të kryera në përlllogaritjen dhe pagesat e pensioneëve në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Durrës.

Opinion i pa modifikuar, me theksim çështjeje:

Sipas opinionit tonë, përveç theksimit të çështjeve të cilësuar në paragrafin e “Theksimi i çështjes” subjekti i audituar, ISSH dhe DRSSH Durrës, kanë vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Rregullorja e miratuar me Urdhrin nr. 2115, datë 15.03.2018, të ISSH “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, “Statuti i ISSH” miratuar me VKM nr.161, datë 11.04.1994 etj, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Baza për opinionin e pa modifikuar, me theksim çështjeje:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Opinioni e dhënë e mbështet në faktin se, ISSH dhe DRSSH Durrës, në përgjithësi kanë vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Mangësitë e evidentuara në disa çështje

të audituara, nuk janë të përhapura dhe materiale dhe për këtë arsye nuk sjellin modifikim të situatës. **Theksimi i çështjes:** Titullari i Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të shqyrtojnë mospërputhjet me Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, përsa i përket fondeve për ISSH.

-Drejtoria e Financës në vijim, të marrë masat e duhura për një planifikim sa më real të fondeve buxhetore nëpërmjet analizave të mirë studiuar të sistemit të sigurimeve shoqërore me qëllim shmangien e transferimeve buxhetore midis artikujve dhe midis njësive shpenzuese. Shqyrtimi dhe miratimi i PBA-së të ndjekë të gjitha hapat e procesit deri në miratimin në Këshillin Administrativ, në përputhje me kërkesat e ligjit të sigurimeve shoqërore.

-Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të ISSH-së, si dhe rakordimit të tyre me strukturat përkatëse, ka rezultuar se nga ISSH, detajimi i planit të të ardhurave dhe shpenzimeve dhe analizimi i tyre (fakt/plan), është kryer duke përfshirë në këtë plan dhe fakt edhe të ardhurat jo tatimore, ose “Të tjera DPT dhe ISSH” në shumën 1,740,926 mijë lekë. Në përfundim, realizimi i të ardhurave nga kontributet e mbledhura nga DPT dhe ISSH, kundrejt planit të miratuar nga MFE është në masën 98,6% dhe jo në masën 100 % të raportuar nga ISSH.

-Nga Drejtoria e Inspektimit të Pensioneve (DIP) rezultojnë 9,614 dosje të pa inspektuara dhe të pa çertifikuara, nga të cilat 8,775 dosje pensioni të pa inspektuara, që i përkasin vitit 2020 si dhe 839 dosje që i përkasin viteve 2019-2021, për rishqyrtim.

-Në DRSSH-të, ndalesa e masës së pensionit në një pjesë të konsiderueshme është kryer në masën 20%, në kundërshtim me nenin 62, pika 2, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Në sistemet CMIS dhe PCAMS, janë konstatuar 3 raste të përfitimit të padrejtë, pasi përfituesit kanë rezultuar ekonomikisht aktiv në administratën publike/institucione shtetërore që në momentin e lidhjes së pensionit, në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Nga verifikimet e kryera, në lidhje me të drejtën e përfitimit për pension, janë konstatuar përfitime të padrejta, pasi përfituesit për pension invaliditeti dhe pleqërie kanë rezultuar njëkohësisht edhe të punësuar, kjo në 15 raste në vlerën 360,427 lekë, të pa çertifikuara nga DIP dhe në 9 dosje në vlerë 192,754 lekë, të çertifikuara nga DIP, veprime në kundërshtim me pikën 2 dhe 3, të nenit 57, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

-Është konstatuar se në të paktën 20 raste, ndalesa e pensionit është bërë nga ana e DRSSH-ve në masën 20% dhe jo në masën 50%, ashtu siç përcaktohet në nenin 62 pika 2, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Në një rast njësia e prokurimit ka vendosur kritere të veçanta jo në përputhje me objektin e prokurimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr.476/1 prot; datë 15.04.2024, ndryshuar me nr.476/2 prot; datë 08.05.2024 “*Auditim mbi përputhshmërinë dhe mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës*, për periudhën nga 01.01.2023 deri në 31.12.2023, nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- V. B., Përgjegjëse Grupi;
- Xh. K., audituese;
- T. A., auditues;
- A. V., auditues;
- A. M., audituese.

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Ky auditim ka si objektiv kryesor vlerësimin e nivelit të zbatimit të kriterëve referuar kuadrit ligjor në fuqi si, Ligji 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH”, me ndryshime, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë fushën e sigurimeve shoqërore në RSH. Dhënia e opinionit mbi përputhshmërinë e aktivitetit të Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur mbi shkallën e zbatimit nga subjektet e audituara ligjeve dhe akteve nënligjore, gjatë veprimtarisë së tij.

Qëllimi i auditimit është që pas vlerësimit të drejtë të nivelit të riskut në subjekt, dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me zbatimin e planit të buxhetit të ISSH, realizimin e të ardhurave nga kontributet dhe shpenzimet, zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe zbatimin e procedurave në përcaktimin e masës së pensioneve nga DRSSH Durrës, vlerësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Inspektimit, Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, funksionimin e MFK, zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm të KLSH etj.

Identifikimi i çështjes:

Nëpërmjet këtij auditimi kërkojmë të identifikojmë dhe të analizojmë riskun, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, ku u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit.

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit nr.476/1 prot; datë 15.04.2024 ndryshuar me nr. prot; 476/2 datë 08.05.2024, si më poshtë:

- Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.
- Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore.
- Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2023.
- Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.
- Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023.
- Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore.
- Mbi procedurat e prokurimit me fonde publike dhe zbatimin e kontratave.
- Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.
- Mbi përputhshmërinë e procedurave të kryera në përlllogaritjen dhe pagesat e pensioneve, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar:

Strukturat drejtuese të ISSH, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për fushat e veprimtarisë së ISSH në drejtim të administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, përcaktimit të masës së pensioneve për përfituesit dhe inspektimin e tyre.

Përgjegjësitë e audituesve:

Përgjegjësia jonë është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

- Të vlerësojmë nëse informacionet mbi çështjet në të gjitha aspektet materiale janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4100), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit u ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde në aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.
- Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në këtë evidencë ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).

- Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të objektivit.

Ne jemi të pavarur, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i përmbushim përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar.

Auditimi është kryer në përputhje me Kodin Etik dhe Standardet duke përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë së procesit të legalizimit dhe rregullshmërisë së veprimtarisë.

Kriteret e vlerësimit:

Në të gjitha fazat e auditimit, sipas programit të detajuar, në përshtatje me Standardet e Auditimit dhe në referencë me problematikat e trajtuara, janë marrë në konsideratë si kriter vlerësues, ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Rregullore e Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit Administrativ të KLSH-së, miratuar me Vendimin të Kryetarit të KLSH nr. 58, datë 08.04.2022; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), “Udhëzuesit e INTOSAI-t”; Udhëzues të përgjithshëm dhe specifik për auditimin, si dhe në praktikat më të mira ndërkombëtare të fushës së auditimit publik; Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”; Ligji nr.10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.8097, datë 21.3.1996, i ndryshuar “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”; Ligji nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” Ligji nr. 9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”; Ligji nr.10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.8097, datë 21.3.1996, i ndryshuar “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; Ligji nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; Ligji 162/2020 “Për prokurimin publik”; Ligji nr.44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; Ligji nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Ligji nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; Ligji nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.84/2022 datë 24,11,2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, me ndryshimet përkatëse, etj.

- VKM nr. 77, datë 28.01.2015, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”, ndryshuar me VKM 653 dt. 22.07.2015, VKM 551 dt. 27.07.2016, VKM Nr. 660 dt. 10.10.2019, VKM Nr. 720 dt. 16.09.2020, VKM nr. 604, datë 14.09.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi” VKM nr. 187 datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës”; VKM nr.788, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e aksidentit në punë ose për shkak të punës”; VKM nr.396, datë 28.06.2007 “Për përcaktimin e sëmundjeve profesionale”; VKM nr. 604, datë 14.9.2022 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”; Vendimi nr.158, datë 12.3.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, i shfuqizuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet përkatëse etj.

Standardet e auditimit:

Auditimi bazohet në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit nr.07, datë 17.01.2024, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI si dhe udhëzimeve dhe rregullave të nxjerra në zbatim të tyre etj.

Metodat e auditimit:

Për arritjen e objektivave, audituesit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit dhe në procedurat analitike, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista verbale dhe teste kontrolli. Nga vlerësimi i riskut në fazën e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, ka funksionuar në mënyrën e duhur, si dhe është konsideruar me risk të ulët, për këtë arsye për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe korrektësisë (në auditimin e përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar, janë aplikuar:

- a. Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasimin e tyre.
- b. Intervistimi - është përdorur intervistimi verbal i marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit të auditimit.
- c. Raporte dhe informacione - janë marrë raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të.
- d. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm - audituesi ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit.
- e. Teknikat me ndihmën e kompjuterit - janë përdorur të dhënat në sistemet CMIS dhe PCAMS, për procedura të programuara, në lidhje me procedurat e ndjekura nga DRSSH Durrës për mbledhjen e kontributeve dhe kryerjen e pagesave etj.
- f. Metoda e testimit të detajuar: Audituesit kanë kryer ekzaminimin e dokumenteve të institucionit sipas objektivave të auditimit dhe kanë marrë evidenca më të besueshme se sa intervistimi ose në mbështetje të informacioneve të mbledhura gjatë intervistimit.

Dokumentimi i auditimit:

Mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundur dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë.

Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren “Për Procedurat e Auditimit”, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së Nr.07, datë 17.01.2024 si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI).

III-PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim:

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është një institucion publik i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 25/2017, datë 09.03.2017. Bazuar në nenin 71, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Misioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) është administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti; vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij institucioni; mbulimi i popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë; rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetarë; përmirësimi i efikasitetit të menaxhimit të fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të

lira dhe fondit rezervë.

Objektivat e përgjithshme të ISSH-së:

- Vazhdimin të punës për implementimin e skemës së reformuar të pensioneve;
- Zbatimin të politikave të Qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve nëpërmjet rritjes së masës së pensioneve, nëpërmjet indeksimit të tyre;
- Përmirësimin të administrimit të buxhetit të ISSH-së dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Vazhdimin të punës për krijimin e një baze të plotë, të informatizuar të të dhënave, siç janë periudhat kontributive të personave, zbatimi i plotë i një sistemi të informatizuar të autorizimit dhe pagesave të pensioneve në mënyrë online, si për pagesat në zonat urbane ashtu dhe ato rurale;
- Përmirësimin rrënjësor të praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, fokusimin e tij në luftën kundër informalitetit, duke zbatuar standardet e përcaktuara.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore drejtohet nga:

- Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore është organi më i lartë ekzekutiv dhe përbëhet nga 12 anëtarë.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.

Auditimi Financiar dhe i Përputhshmërisë është kryer sipas Programit të Auditimit nr. 13/1 prot; datë 09.01.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.01.2023 deri në datë 28.04.2023 në Drejtorinë e Përgjithshme në Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë, për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2022.

Raporti përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e kryer sipas Programit të Auditimit nr. 13/1, datë 09.01.2023 janë dërguar me shkresën nr. 13/8 prot; datë 26.07.2023 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mësipërm konstatohet se: në përfundim të auditimit janë rekomanduar gjithsej 16 masa organizative të cilat janë pranuar nga subjekti.

a). Hartimi i Planit të Veprimit dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve.

Nga auditimi u konstatua se, për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 13/8 prot; datë 26.07.2023 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, ISSH ka kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditor në KLSH me shkresë nr. 85/5, datë 15.08.2023, në përputhje me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, ku pasqyrohen veprimet që do të ndërmerren për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe strukturat përgjegjëse.

b). Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Referuar shkresës nr. 13/8 prot; datë 26.07.2023, “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të ushtruar në Drejtorinë e Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, ISSH **nuk ka kthyer përgjigje** në KLSH mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Si konkluzion, nga ana e ISSH, nuk është respektuar afati ligjor të raportimit në KLSH, mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga ana e KLSH-së brenda afatit 6 muajsh, nga njohja me Raportin Përfundimtar të Auditimit, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 154, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, i cili përcakton se: “Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.

Nga grupi i auditimit u verifikua realizimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm dhe

nga shqyrtimi i plan veprimt, përgjigjeve të subjektit në lidhje me masat e marra si dhe dokumentacionit përkatës të vënë në dispozicion, ka rezultuar nga 16 masa organizative të lëna, niveli i pranimit është në masën 100 % nga të cilat:

9 masa janë realizuar, 6 masa janë në proces zbatimi dhe një masë zbatuar pjesërisht. Statusi i zbatimit të rekomandimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Lloji i masave	Masa të dhëna (numër)	Statusi i zbatimit të rekomandimeve				Pranuara
		Zbatuarplotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuara	
Masa organizative	16	9	1	6	-	16
Totali	16	9	1	6	-	16

Burimi i të dhënave: ISSH, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH-së.

Në mënyrë të detajuar rekomandimet e zbatuara pjesërisht dhe në proces zbatimi, paraqitet si më poshtë:

-A. Masa organizative të lëna.

1.1. Rekomandimi: Titullari i ISSH, të marrë masa për zhveshjen nga ndikimi i realizimit të të ardhurave jo tatimore (të tjera DPT dhe ISSH) të analizimit të treguesve plan/fakt të ardhura, duke zbatuar klasifikimin në të ardhura tatimore dhe jo tatimore sipas Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pjesë e ligjit dhe akteve normative.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit ka rezultuar:

Me shkresën nr. 2703 prot. dt 08.02.2023, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, është bërë ndarja e planit të të ardhurave. Në lidhje me procesin e detajimit të zërave të ardhurave në raportimet financiare dhe fiskale të vitit 2023, nga ana e Drejtorisë së Kontributeve dhe Drejtorisë së Financës në ISSH, është mbajtur parasysh që ndarja e të ardhurave të bëhet sipas klasifikimit të zërave dhe llogarive përkatëse të të ardhurave.

ISSH do të përmirësojë në vazhdim procedurën e detajimit si dhe të mundësojë një detajim të zërave sipas Treguesve Fiskal të Buxhetit të Shtetit.

Statusi: Në proces zbatimi

2.1. Rekomandimi: Titullari i ISSH dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të shqyrtojnë mospërputhjet me Treguesit e Fiskal të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, përsa i përket fondeve për ISSH, të raportuara në Kapitullin II “Të ardhurave tatimore”; II.3.1 “Të ardhura nga Fondet Speciale” (ISSH) dhe në Kapitullin I “Shpenzimet korente”, pika 5 “Shpenzimet për fondet speciale” (ISSH).

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit ka rezultuar:

ISSH ka bërë akordime me:

- Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për të ardhurat e mbledhura (Kontributet), Shkresa nr. 235/1 datë 12.01.2024 “Mbi akordimin e të ardhurave të realizuara nga kontributet për Sigurimet Shoqërore nga DPT”.

- Me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për të ardhurat e transferuara nga TSA në ISSH, Shkresa nr. 235/2 datë 12.01.2024 dhe shkresa hyrëse me nr. 950/1 e datës 25.01.2024 e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit për të ardhurat e transferuara nga TSA në ISSH.

- Ka dërguar me shkresë përcjellëse evidencat Fiskale, i ka hedhur dhe rakorduar në sistemin SIFQ të Ministrisë. Shkresa nr. 543prot; datë 16.01.2024, “Dërgohet evidenca fiskale për muajin dhjetor dhe progresivi 2023”, e cila është e barabartë me performancën financiare në bilancin e vitit 2023.

- Ka bërë rakordime me Degën e Thesarit Tiranë, për të ardhurat e transferuara në ISSH nga Buxheti i Shtetit, Shkresa nr. 235 prot. datë 09.01.2024, “Akt-rakordim për financimin e Buxhetit të shtetit sipas grupit, titullit, artikullit dhe llogarisë ekonomike”.

- Ka bërë rakordime me Bankën e Shqipërisë dhe MFE për llogarine e unifikuar t të ISSH-së, Shkresa nr. 314 prot. datë 08.01.2024, nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, “Informacion për gjendjen e llogarisë së ISSH-së në Bankën e Shqipërisë”, për dy llogaritë speciale të ISSH-së në Bankën e

Shqipërisë.”

- Ka bërë Akt rakordim me Postën Sh.A, Akt rakordimi me Postën Shqiptare Sh.A. i nënshkruar rregullisht nga të dy palët me dt. 10.01.2024.

- Ka bërë Akt rakordim me FSDKSH për të ardhurat e mbledhura dhe të transferuara, Akt rakordimi me FSDKSH i nënshkruar rregullisht nga të dy palët.

Të gjithë këto të dhëna janë të pasqyruara ne Bilancin e vitit 2023.

Statusi: Në proces zbatimi

3.1. Rekomandimi: (Rekomandimet e lëna nga grupi i kaluar në proces zbatimi apo të pa zbatuara.)

Titullari i ISSH, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për zbatimin e 6 (gjashtë) rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht dhe ato në proces zbatimi, si dhe të marrë masa për respektimin e afateve të raportimit në KLSH, mbi hartimin e plan veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve, brenda afatit 20 ditor dhe raportimin e nivelit të zbatimit të tyre brenda afatit 6 mujor, nga njohja me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit ka rezultuar:

1. Rekomandimi (2.1.): Instituti i Sigurimeve Shoqërore të mundësojë rritjen e të ardhurave e numrin e kontribuesve, uljen e deficitit të skemës së pensioneve, zvogëlimin e subvencionit të buxheti shtetit për skemën e pensioneve dhe përmirësimin e raportit kontribute me prodhimin e brendshëm bruto (PBB).

Masat e marra: për vitin 2023 është rritur numri i kontribuesve si dhe të ardhurat e përfituara nga kontributet dhe si rrjedhojë është ulur edhe deficieti i skemës së pensioneve.

Statusi: Realizuar për vitin 2023 dhe në proces zbatimi në vazhdimësi

2. Rekomandimi (2.2.): Instituti i Sigurimeve Shoqërore t'i bëjë prezent dhe të kërkojë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ndërhyjë në zgjidhjen problematikave të mbartura në marrëdhëniet e saj me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për diferencat e kontributeve të derdhura nga subjektet privatë dhe shtetërorë për sigurimet shoqërore të cilat konstatohen në 103 mijë subjekte debitorë, me vlerë rreth 15.8 miliard detyrime të prapambetura.

Masat e marra: Drejtoria e Kontributeve në ISSH i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe për dijeni Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3727 prot; datë 30.05.2022, “Mbi subjektet me detyrime të prapambetura në përgjegjësi të organeve tatimore”, duke shprehur ecurinë e problematikave të konstatuara që burojnë nga mos pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga ana e subjekteve aktive, si dhe të vlerësojnë shqetësimin e krijuar nga rritja me ritme të larta e numrit të subjekteve me detyrime të prapambetura.

Me shkresën nr. 5891 prot; datë 26.08.2022, “Për problematikën në vazhdimësi në lidhje me rritjen e numrit të subjekteve me detyrime të prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore”, Drejtoria e Kontributeve i është drejtuar përsëri Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe për dijeni, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke i dhënë informacion dhe bërë një panoramë më të detajuar situatës shqetësuese për rritje me ritme të larta të numrit të subjekteve me detyrime të prapambetura, si dhe vlera të larta të këtyre detyrimeve që mbartin këto subjekte.

Statusi: Në proces zbatimi

3. Rekomandimi (4.1.): Drejtori i Përgjithshëm, të plotësojë pozicionin në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, vakant në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe të marrë masa që të kryejë trajnime të punonjësve të kësaj drejtorie.

Masat e marra: Drejtoria e Auditit të Brendshëm, gjatë vitit 2023, vazhdon të ketë 3 vende vakante.

Statusi: Zbatuar pjesërisht

4. Rekomandimi (8.1.): Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për dërgimin dhe miratimin e “Rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e ISSH-së”, në përputhje me strukturën organizative aktuale, si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të sigurojë trajnimin dhe rishikimin e kohës dhe mënyrës së vlerësimit të duhur të punonjësve.

Masat e marra: Me urdhrin nr. 4385 prot; datë 22.06.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, është urdhëruar në funksion të zbatimit të dixhitalizimit të procesit së të dhënave të ISSH dhe të zbatimit të vendimit për mbylljen e sporteve, si dhe ofrimin e shërbimeve online, ngritja e grupit të punës për ndryshimin e strukturave organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, DRSSH, DSSH dhe DAQ. Si rrjedhojë, Rregullorja e Brendshme me organizimin dhe funksionimin e ISSH është në proces rishikimi.

Titullari i ISSH, ka nxjerrë udhëzimin nr. 1, datë 07.02.2023 “Për vlerësimin e performancës të punonjësve të ISSH”. Në zbatim të udhëzimit ka ndryshuar forma dhe mënyra e vlerësimit e punonjësve, një herë në vit, si dhe sipas një formulari tip.

Pas përfundimit të procesit të miratimit të strukturës së re, po vijohet me përpilimin e rregullores për funksionimin e organizimin e ISSH e cila do i përshtatet strukturës së re të miratuar.

- Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës me nr. 4385 Prot, datë 22.06.2022.

- VKA nr. 13, datë 28.12.2023, “Për miratimin e strukturës organizative dhe numrin e punonjësve të ISSH-së”.

Statusi: Në proces zbatimi

5. Rekomandimi (10.1.): Këshilli Administrativ të shqyrtojë dhe të analizojë në veçanti zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, duke nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin dhe/ose mosrealizimin në afat, si dhe të marrë masa që të sigurojë zbatimin e plotë të tyre.

Masat e marra: Me urdhrin nr. 4385 prot; datë 22.06.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, është urdhëruar ngritja e grupit të punës për ndryshimin e strukturave organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, DRSSH, DSSH dhe DAQ. Rregullorja e përshkrimeve të punës, e cila është miratuar me shkresë nr. 2115 prot, datë 15.03.2018, është në proces rishikimi duke u përshtatur sipas funksionit dhe përgjegjësive të reja të krijuara, kryesisht shërbimet online. Rregullorja e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e ISSH është në proces rishikimi.

Statusi: Në proces zbatimi

Statusi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i kryer në vitin 2021 është: Në proces Zbatimi

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat e duhura për një planifikim sa më real të fondeve buxhetore në dispozicion, si dhe uljen e transferimeve buxhetore, nga një njësi në tjetrën dhe nga një artikull në tjetrin.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit ka rezultuar:

Në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH, duke ju referuar shkresave për alokim fondesh për vitin 2023 ka rreth 17% me pak se viti 2022, shkresa të cilat janë kompetencë e DRSSH-ve, por që miratohen edhe nga Titullari. Numri më i madh i shkresave për ndryshim fondi ka të bëjë me ndryshimet sipas VKM-ve dhe Akteve Normative gjatë vitit.

Për vitin 2023, çdo ndryshim plani në Buxhetin e Brendshëm (Administrata), si edhe çdo ndryshim në DRSSH, është e shoqëruar me evidencë shkresore.

ISSH ka përmirësuar në vazhdim procedurën e planifikimit si dhe ka mundur një programim të shpenzimeve sa më afër realitetit të vitit në vazhdim.

Në vijim të shkresës së nxjerrë nga ISSH-së nr. 6342/1 datë 24.07.2023 “Mbi hartimin e projekt-buxhetit për vitin 2024-2026”, Drejtoritë Rajonale dërgojnë në ISSH programimin përkatës për buxhetin vjetor dhe afatmesëm 2024-2026, për një planifikim sa më afër buxhetit real në mënyrë që të ketë sa më pak rialokim fondesh gjatë vitit. Pasi shikohen programimet e DRSSH-ve ekipi i menaxhimit përgatit programimin e PBA-së.

Statusi: Në proces zbatimi

5.1.Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të nxjerrë përgjegjësitë në përshpejtimin e procedurave për organizimin e brendshëm të Institucionit, si dhe të marrë masa për miratimin e Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e ISSH.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit ka rezultuar:

Pas përfundimit të procesit të miratimit të strukturës së re, po vijohet me përpilimin e rregullores

për funksionimin e organizimit të ISSH e cila do të përshtatet strukturës së re të miratuar.

- Urdhri i Drejtorit të Përgjithshëm për ngritjen e grupit të punës me nr. 4385 prot; datë 22.06.2022.
- VKA nr. 13, datë 28.12.2023, “Për miratimin e strukture organizative dhe numrin e punonjësve të ISSH-së”.

Statusi: Në proces zbatimi

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në ISSH, të përmirësojë formatin “Njoftim për shpallje konkurrimi”, për kandidatët të nivelit menaxherial, duke u bazuar në përcaktimet e Rregullores “Për Personelin e ISSH”, si dhe Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave (KVK), të marrë masa që rekrutimet të bëhen të bazuara mbi kriteret e pranimit të përcaktuara në Rregulloren “Për Personelin e ISSH”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit ka rezultuar:

Drejtorja e Administrimit të Përgjithshëm, në vlerësim të rekomandimit të KLSH, rishikoi Formatin “Njoftim për shpallje konkurrimi” për pozicionet të nivelit menaxherial me qëllim përmirësimin e saj sipas përcaktimeve të Rregullores “Për personelin e ISSH-së”. Rekrutimi për vitin 2023 në nivel menaxherial është realizuar duke respektuar formatin e duhur “Njoftim për shpallje konkurrimi”, duke respektuar dhe Kriteret e pranimit nga Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave.

Janë plotësuar vendet vakante specialist në Drejtorinë e Inspektimit të Përfitimeve, por sikurse edhe konstatohet në Akt Konstatim nr.6 ka parregullsi të konstatuara në procesin e rekrutimit.

- Është kryer trajnimi i stafit të Drejtorisë së Auditit, i kërkuar sipas nevojave të tyre në lidhje me njohjen dhe zbatimin e Ligjit “Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Statusi: Në proces zbatimi

1.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ISSH dhe Drejtori i Përgjithshëm Administrativ të marrin masa për plotësimin e pozicioneve vakante në Drejtorinë e Inspektimit të Përfitimeve dhe Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, si dhe për hartimin e kalendarit të trajnimeve, referuar nevojave reale të stafit, për organizimin e trajnimeve në lidhje me njohjen dhe zbatimin e Ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit ka rezultuar:

Rekrutimi për vitin 2023 në nivel menaxherial është realizuar duke respektuar formatin e duhur “Njoftim për shpallje konkurrimi”, duke respektuar dhe kriteret e pranimit nga Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave.

Janë plotësuar vendet vakante specialist në Drejtorinë e Inspektimit të Përfitimeve por Drejtoria e Auditit të Brendshëm, gjatë vitit 2023, vazhdon të ketë 3 vende vakante.

Me Urdhër nr. 232/2, datë 16.01.2023, është miratuar programi vjetor 2023 i trajnimeve për stafin e ISSH-së, nr. 323 prto, datë 16.01.2023.

Statusi: Pjesërisht e Zbatuar

Si konkluzion, në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, konstatohet se janë dhënë 16 rekomandime, të cilët janë pranuar të gjithë, si dhe janë zbatuar 9 rekomandime, janë në proces zbatimi 6 rekomandime dhe është zbatuar pjesërisht një rekomandim. Sa më sipër, nga auditimi ka rezultuar se nga strukturat e caktuara në programin e masave të miratuar nga titullari i ISSH, për zbatimin e rekomandimeve, nuk është vepruar në kohë dhe nuk janë marrë masat e duhura dhe për rrjedhojë një pjesë e tyre rezultojnë në proces zbatimi ose të realizuara pjesërisht.

2.2. Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore.

Për auditimin e të cilave u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Të ardhurat totale të ISSH (skema e detyrueshme dhe skemat suplementare), viti 2023;
- Shpenzimet totale të ISSH, viti 2023;
- Financimi nga Buxheti i Shteti, viti 2023;

- Marrëveshjet e bashkëpunimit të ISSH me institucionet homologe përgjatë vitit 2023;
- Shpenzimet për programe të veçanta shtetërore, viti 2023;
- Investimi i Fondit Rezervë përgjatë 2023.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, drejtohen dhe administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH, këtu e në vijim). sipas nenit 71 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Misioni i ISSH, i përcaktuar në Rregulloren e miratuar më 15.03.2018, “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” është: *“Administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij institucioni, mbulimi i popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo drejtë, rritja e numrit të kontribuuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar, përmirësimi i efikasitetit në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë”*.

Nga grupi i auditimit është verifikuar, si është realizuar objektivi i ISSH për të garantuar mbulimin sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme. Sipas Rregullorestë miratuar, në ISSH detyrat për realizimin e këtij objektivi janë:

- Zbatimi të një sistemi sigurimesh shoqërore, që i përgjigjet më mirë stadit të arritur në zhvillimin ekonomik e social të vendit.
- Përsosja e menaxhimit të skemës së sigurimeve shoqërore, sidomos të mbledhja e të ardhurave kontributive dhe shpërndarja sa më e drejtë e tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta.
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore, duke synuar rritjen graduale por më të shpejtë të kontributeve në krahasim me rritjen e përfitimeve si dhe duke minimizuar subvencionet buxhetore.

Nga grupi i auditimit janë verifikuar të gjithë elementët e mësipërm, nga ku rezultoi: Politikat e pensioneve në drejtim të mbulimit të popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore. Në kuadër të strategjive kombëtare në fushën e mbulimit social ISSH duhet në mënyrë të vazhdueshme të sigurojë ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve të jetesës për pensionistët dhe të moshuarit nëpërmjet:

- Zbatimit të kuadrit rregullator për fondet e pensioneve, sipas indeksit të çmimeve të konsumit;
- Mbulimit me pensione sociale të personave mbi 70 vjeç, që nuk kanë mundur të kontribuojnë në skemën e pensioneve;
- Mbrojtjes së shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish-shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit, në përputhje me konventat, marrëveshjet dy palëshe dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Zbatimit të kuadrit rregullator për zhvillimin e kompensimeve në varësi të ndryshimeve të çmimit të energjisë elektrike për pensionistët dhe kompensime të tjera të rregulluara me anë të VKM-ve.

Në lidhje me veprimtarinë e ISSH, në drejtim të zbatimit të pikave të mësipërme, në kuadër të realizimit të Strategjisë Kombëtare në fushën e mbulimit social, përgjatë vitit 2023 ka rezultuar se:

Gjatë vitit 2023, të ardhurat e pensioneve janë indeksuar vetëm një herë, në masën 8.6% sipas VKM Nr. 553, datë 28.9.2023 “Për Indeksimin e Pensioneve”.

Ndryshimet e të ardhurave, për të kompensuar nivelin minimal të pensioneve janë bërë me anë të VKM-ve të paraqitura më poshtë:

Sipas Aktit Normativ nr.5, datë 25.10.2023 “Për disa ndryshime në ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, shuma e të ardhurave dhe shpenzimeve janë 167,315 milionë lekë, i cili në total nuk ka sjellë efekte në planin fillestar të miratuar me ligjin 84/2022, por ka ndryshuar brenda për brenda tij: ka sjellë rritje të planit të të ardhurave të kontributeve me 14,576 milionë lekë dhe të transferuara për indeksimin e pensioneve me 1,000 milionë lekë, si dhe uljes së transfertës nga buxheti i shtetit me 15,576 milionë lekë.

- Në VKM nr. 187, datë 31.03.2023 “Për shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023”, efektet financiare në shumën 3,536,735 mijë lekë, shumë e cila do të mbulohen nga buxheti i ISSH i vitit 2023, pra nga Buxheti i Shtetit;
- Në VKM nr. 553, datë 28.09.2023 “Për Indeksimin e pensioneve”, efektet financiare në shumën 3,184,000 mijë lekë do të mbulohen nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve të parashikuara në buxhetin e Instituti i Sigurimeve Shoqërore të vitit 2023;
- Në VKM nr. 654, datë 30.11.2023 “Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fund vitit 2023”, efektet financiare në shumën 3,548,377 mijë lekë do të mbulohen nga buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, i miratuar për vitin 2023;
- Në VKM nr. 819, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e kategorisë së personave që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension familjar, për vitin 2023”, efektet financiare në shumën 560,473 mijë lekë do të mbulohen nga “Fondi i Kontigjencës”, i miratuar në buxhetin e vitit 2023 dhe buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023.
- Mbulimi me pension dhe me kompensime, të kategorive të veçanta të përfituesve, nga ana e ISSH-së.

Skema e sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë ka karakter kontributiv, ku personat për të përfituar duhet të kenë kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore për periudha të caktuara kohe, siç parashikohen në Ligjin 7703/1993, por gjithashtu ISSH mbulon me përfitime sociale, jo vetëm ata individ që kanë kontribuar dhe kanë plotësuar periudhat e kontribuesit, por dhe individ, të cilët janë mbi moshën 70 vjeç, që nuk plotësojnë kushtet për asnjë pension nga skema e detyrueshme apo kur të ardhurat e tyre janë më të pakta se sa pensioni social (kjo dhe në zbatim të Udhëzuesit për Koordinimin e Sigurimeve Shoqërore në Këshillin e Evropës, ku përcaktohet se personat duhet të mbulohen nga skema sociale për t’u siguruar mbrojtje nga një ose më shumë se një nga nëntë risqet sociale të parashikuara në Konventën nr.102 “Për sigurimet shoqërore”, të Organizatës Ndërkombëtare të Punës), në këtë drejtim dhe Ligji nr.7703/1993, i ndryshuar parashikon në nenin 5/1 të tij, përkufizimin e pensionit social, kush mund ta përfitojë dhe masën e tij. Për vitin 2023 rezulton se kanë përfituar pensione sociale 2,278 individë, ku shuma totale e të ardhurave të shpërndara për këtë kategori ka qenë 183 milionë lekë.

Skema e sigurimeve shoqërore, në përgjithësi, përfshirë dhe skemën në RSH, të cilat kryesisht kanë karakter territorial, rregullohen nga legjislacioni kombëtar, në rastin e RSH nga Ligji nr.7703/1993, i ndryshuar, i cili përcakton shumën e përfitimeve, kushtet e dhënies së pensioneve dhe kohëzgjatja e derdhjes së kontributeve. Aspekti i territorialitetit të kufizuar, privon nga e drejta për të përfituar individët, që banojnë përtej territorit të vendit, por në lidhje me këto kategori, neni 7 i Ligjit nr.7703/1993, të ndryshuar përcakton se: *“Sigurimet shoqërore u japin mbrojtje edhe shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish-shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit, në përputhje me konventat, marrëveshjet dy palëshe dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”*.

Në zbatim të nenit të sipërcituar dhe të pikës 1 dhe 2, të nenit 48 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ku në pikën 1 përcaktohet vendosja e rregullave për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit me nënshtetësi shqiptare, të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar dhe për pjesëtarët e familjeve të tyre që janë ligjërisht rezidentë aty, dhe në pikën 2 është përcaktohet se: *“Shqipëria u akordon punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar dhe ligjërisht të punësuar në territorin e saj, dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre rezidentë të ligjshëm aty, të njëjtin trajtim siç specifikohet në pikën e dytë dhe të tretë të paragrafit 1...”* rezulton se nga ISSH gjatë vitit 2023 janë lidhur dhe kanë hyrë në fuqi tri marrëveshje bashkëpunimi (marrëveshja në fushën e Sigurimeve Shoqërore me Republikën e Kosovës; Marrëveshja në fushën e mbrojtjes me Kanadanë dhe Marrëveshja me Konfederatën Zvicerane) si dhe janë zhvilluar 4 negociata për marrëveshje. Marrëveshjet ndërkombëtare midis Republikës së Shqipërisë (RSH) dhe shteteve të tjera në fushën e mbrojtjes shoqërore u vinë në ndihmë dhe mbështetje qytetarëve shqiptarë, që kanë vite që jetojnë dhe punojnë në këto vende, por gjithashtu kanë edhe vite pune të realizuara në Republikën e Shqipërisë. Me nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve bilaterale është bërë koordinimi i skemave të sigurimeve shoqërore, në mënyrë që shtetasit, subjekt i legjislacioneve të dy vendeve të mos humbasin të drejtat gjatë zhvendosjes nga Shqipëria në vendin tjetër. Për vitin 2023 rezulton se, marrëveshjet e

lidhura nuk kanë nisur ende të kenë efekt (asnjë përfitues prej tyre). ISSH, gjatë vitit 2023 u ka siguruar mbrojtje shtresave në nevojë, duke kryer kompesime sipas VKM-ve përkatëse në lidhje me kompesimet për energjinë elektrike, për të ardhura, për ish të persektuarit, invalidët e luftës, etj në shumën totale 16,107 milionë lekë, ose 99% kundrejt atyre të planifikuara. Krahasuar me një vit më parë kjo kategori shpenzimesh është më e ulët me 74%, në total, kjo për shkak se vitin e kaluar ka patur rritje të shumës së kompesimeve, në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra në 2023, rritjes së numrit të përfituesve etj. Shpenzimet për programe të veçanta përvitin 2023 në mënyrë të detajuar paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1 "Shpenzimet për kompesime të pensionisteve përgjatë vitit

Në milionë lekë

Ref. e llogarisë.	Përshkrimi	Plan 2023	Fakt 2023	Fakt 2022	% Fakt/plan 23	% e 23-22
	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	16,207.3	16,107.2	21,622.2	99%	74%
60.060.008	Kompensim suplementar për çmimet (shportën) për pensionistet	4,604.3	4,588.0	4,640.1	100%	99%
60.600.081	Kompensim të ardhura për pensionet e shtetit	10,770.6	10,680.7	16,196.6	99%	66%
60.600.081	Kompensim të ardhura për pensionet e fshatit	431.9	384.2	424.8	89%	90%
6.060.009	Pensione të veçanta shtetërore (Pensione të posaçme)	91.8	179.8	94.2	196%	191%
6.060.010	Kompensim suplementar për ish të persektuarit	227.2	187.6	182.6	83%	103%
6.060.011	Kompensim për veteranët dhe invalidët e luftës	48.1	40.5	50.1	84%	81%
60.600.121	Kompensim suplementar për çmimin e karburantit	33.3	46.4	33.7	139%	138%

Burimi: ISSH, të përpunuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Analizë e shpenzimeve për "Pensione të posaçme shtetërore" për vitin 2023.

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se brenda zërave të shpenzimeve për programe të veçanta kemi tejkalim të planit për shpenzime tek pensione të posaçme shtetërore, në shumën 88 milionë lekë. Plani për vitin 2023 është 91.8 milionë lekë dhe realizimi 179.8 milionë lekë. Tejkalmi i shpenzimeve për këtë zë ka ardhur si rezultat i zbatimit të VKM nr. 374 datë 21.06.2023, "Për një ndryshim në vendimin nr. 429 datë 12.09.2002 të Këshillit të Ministrave, "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore", të ndryshuar, dërguar nga ISSH për Drejtoritë Rajonale, me shkresën nr. 5577 datë 29.06.2023 dhe udhëzimit nr. 12 datë 27.06.2023 dërguar me shkresën nr. 5577/1 datë 29.06.2023, ku specifikisht citohet:

Pika 6, e vendimit nr. 429, datë 12.09.2002, të këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

Pensioni i posaçëm shtetëror është sa dhjetëfishi i pensionit social, pra shtesa e pensionit të posaçëm shtetëror do të jetë sa dhjetëfishi i pensionit social, por shuma e pensionit total të përfituesit nuk duhet të jetë më shumë se dymbëdhjetëfish i pensionit social.

Në kuptim të pikës 1 të këtij vendimi kur shuma e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror bashkë me pensionet e përfituara nga ligjet e përcaktuara ë sipas pikës 1 të këtij vendimi e kalon dymbëdhjetëfishin e pensionit social, shuma e pensionit të posaçëm shtetëror, që akordohet me vendim individual të Këshillit të Ministrave, do të llogaritet si diferencë e dymbëdhjetëfishit të pensionit social me shumën e përfitimeve nga ligjet e tjera.

Efektet financiare nga zbatimi i këtij vendimi llogariten në shumën 207 milionë lekë dhe do të përballohen nga fondi i buxhetit të sigurimeve shoqërore, të miratuar për vitin 2023.

Duke patur parasysh tejkalmimin e shpenzimeve tek ky zë, të ndodhur për shkak të zbatimit të këtij vendimi, janë marrë masat që planifikimi i fondeve për vitin 2024 të jetë rreth 285 milionë lekë ose 194 milion lekë më shumë se viti 2023, ose sa më afër realizimit të këtij shpenzimi.

- Tejkalmi kemi edhe në zërin 6060012 shpërblim mujorë shtesë mbi pensionin e invaliditeti, ky zë shpenzimesh është realizuar në shumën 46,407 mijë lekë, ose 139% kundrejt fondeve të planifikuara, kjo sepse me anë VKM nr. 885/2022 është bërë rimbursimi i karburantit për kategori dhe masa e

rimbursimit të tij është rritur nga 7,000 lekë në 10,000 lekë.

Në të gjitha rastet e tjera mosrealizimet e planeve apo tejkallimet kanë ardhur si rezultat i rregullimeve të bëra përgjatë vitit 2023 me anë të VKM-ve të veçanta, të cilat kanë ofruar mbështetje në lidhje programet e posaçme të paraqitura në tabelën më sipër.

Shpenzimet e tjera brenda këtij grupi janë mbajtur brenda limitit të përcaktuar.

Veprimtaria e ISSH-së në drejtim të mbledhjes së të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi dhe nga të siguruarit vullnetarë. Misioni i ISSH-së, gjithashtu përfshin dhe: “ritjen e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar”. Në lidhje me këto tregues, gjatë vitit 2023 ka rezultuar si më poshtë:

Tabela nr.2 “Të ardhurat sipas llojeve të kontributit, të mbledhura Në mijë lekë

Përshkrimi	2023			2022			%Δ 23-22
	Plan	Fakt	realiz	Plan	Fakt	realiz	Fakt
Të vetëpunësuarit në Bujqësi							
Të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore	2,393	2,901	121%	1,725	2,365	137%	22.60%
Numri i kontribuesve	66,516	75,451	113%	48,104	62,070	129%	22%
Sigurimi Vullnetar							
Të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore	600	712	119%	450	573	127%	24.20%
Numri i kontribuesve	6,211	7,362	119%	5,788	6,904	119%	6.60%

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Për vitin 2023 plani i parashikuar për zërin të ardhura nga kontributet (e të vetëpunësuarve në bujqësi) është në vlerë 2,393 mijë lekë, ndërsa realizimi është në vlerën 2,901 mijë lekë, me një tejkallim në vlerë 508 mijë lekë dhe në % në masën 21%.

Për vitin 2022, të vetëpunësuarit në bujqësi, janë planifikuar 1,725 mijë lekë dhe realizuar në 2,365 mijë lekë, me një tejkallim 640 mijë lekë e shprehur % në masën 37%. Gjithashtu, kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes numrit të kontribuesve të të vetëpunësuarëve në bujqësi, kontribues në vitin 2022 ishin 62,070 persona, ndërsa në vitin 2023 është në numrin 75,451 me një rritje prej 13,381 kontribues.

Për vitin 2023 plani i parashikuar për zërin të ardhura nga kontributet nga sigurimet vullnetare janë planifikuar 600 mijë lekë dhe realizuar në vlerë 712 mijë lekë, me një tejkallim në vlerë 112 mijë lekë dhe në % në masën 19%. Krahasuar me vitin 2022, në vitin 2023 kemi një tejkallim në vlerë 139 mijë lekë më shumë, por e shprehur në % tejkallimi është më e lartë në vitin 2022, pasi plani është më i vogël i shprehur në % në masën 25% në vitin 2022.

Në krahasim me vitin 2022 kemi rritje të numrit të kontribuesve për sigurimet vullnetare, nga 6904 që ishin në vitin 2022, kanë arritur në 7362 në vitin 2023.

Në analizat e bëra nga grupi i auditimit dhe nga të dhënat e marra nga ISSH, në lidhje me këta dy treguesit për të vetëpunësuarit në bujqësi dhe vullnetarë rezulton se, pavarësisht rritjes në numrin dhe shumën e kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi, situata nuk paraqitet pozitive.

- Nuk ka interesim nga grup moshat e reja për të punuar pranë ekonomive të tyre fermerë dhe punësimi i përhershëm apo sezonal i tyre në sektorë të tjerë.

- Po ashtu moshat mesatare e lartë e fermerëve dhe mungesa e pasardhësve të gatshëm për të vazhduar punën në bujqësi paraqet një kërcënim për fuqinë punëtore në të ardhmen e afërt.

- Niveli i ulët ekonomik në zonat rurale, kryesisht ato të thella malore, ose larg zonave urbane, nuk mundëson kapacitet financiar të kësaj kategorie nga kryerja e aktivitetit bujqësor ose blegtoral, për të paguar kontributet e sigurimeve shoqërore.

Duke krahasuar dy vitet 2022-2023, rezulton se në vlerë kemi rritje të ardhurave të realizuara, pavarësisht planit të planifikuar me të ulët në vitin 2022, pasi ka pas ndryshime në pagën minimale, me VKM nr. 113 datë 01.03.2023 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”.

Rritja e pagës minimale krahasuar me një vit më parë është 17.6 % (krahasimi është bërë me pagën e fundit të vitit 2023 në raport me pagën e fundit të vitit 2022), ndërsa në 2022 rritja e pagës minimale ka qenë 13.3%, (krahasimi është bërë me pagën e fundit të vitit 2022 në raport me pagën e fundit të

vitit 2021).

- Gjatë vitit 2023 numri i kontribuesve, ka pësuar një rritje me 3.6% krahasuar me vitin 2022. Rritja e pagës minimale dhe rritja e numrit të kontribuesve ndikojnë në masën e të ardhurave të mbledhura nga ISSH, nga kontributet e drejtpërdrejta të cilat krahasuar me një vit më parë janë rritur me 18%. Për të parë ndikimin e këtyre treguesve në të ardhurat kontributive është marrë në analizë masa mujore e kontributit për të vetëpunësuarit (person fizik) dhe për sigurimin vullnetar të cilat, kanë ndikim të drejtpërdrejtë nga ndryshimi pagës minimale, nga ku konstatohet se masa e kontributit si rezultat i rritjes së pagës minimale është rritur me 17.6% krahasuar me një vit më parë për të dy kategoritë, për pasojë rritja e numrit të kontribuesve ka ndikuar më tepër në rritjen e totalit të ardhurave të drejtpërdrejta nga kontributet. Në mënyrë të detajuar treguesit e mësipërm paraqiten si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 3 “Treguesit e pagës minimale, numër kontribues dhe të ardhura nga kontributet e drejtpërdrejta në ISSH, për periudhën 2021-2022”.

Përshkrimi	2023	2022	%Δ 23-22
Paga minimale mesatare (lekë)	40,000	34,000	17.60%
Nr. Kontribuesve ISSH + DPT	783,252	755,730	3.60%
Të ardhurat nga kontributet shoqërore të drejtpërdrejta (mil lekë)	124,618	105,657	18%
Masa mujore e kontributit për të vete punësuarit (person fizik)	9,200	7,820	17.60%
Masa e kontributit për sigurimin vullnetar	8,640	7,344	17.60%

Burimi i të dhënave: ISSH: përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga tabela më sipër rezulton, se nga rritja e pagës minimale është rritur masa e kontributit njëlloj për të vetëpunësuarit (person fizik) dhe për të siguruarit vullnetarë nga 7,820 lekë në 9,200 lekë dhe 7,344 lekë në 8,640 lekë ose me 17.6%. Të ardhurat e drejtpërdrejta të mbledhura nga ISSH për këto dy kategori, për vitin 2022 janë rritur me 11.4%, rritje e cila i atribuohet më shumë rritjes së numrit të kontribuesve, se sa pagës rritjes së pagës minimale.

Administrimi i skemës së pensioneve përgjatë vitit 2023, është analizuar bazuar në një set treguesish, të cilat paraqesin situatën e sigurimeve shoqërore përgjatë vitit 2023, të cilët paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 4 “Treguesit e situatës së sigurimeve shoqërore për vitin 2023”

Përshkrimi	2023	2022	%Δ 23-22
Nr. Pensionistëve(raste)	704,999	686,923	2.60%
Pensione te reja gjatë vitit(raste)	30,352	29,664	2.30%
Pensione te mbyllura përgjatë vitit (raste)	13,727	15,309	(10.30%)
Masa mesatare e pensioneve të reja (lekë)	15,569	15,125	2.90%
Shpenzimet për përfitime	144,061	131,864	9.20%
Koha mesatare e përpunim të kërkesës për pension(ditë)	42	25.2	60%
% e pensioneve të lidhura para afatit ndaj totalit	98.5	98.5	0.00%
Mosha mesatare e daljes në pension(vjeç)	63.6	63.4	0.30%
Koha mesatare e gëzimit të pension (vite)	22.9	22.9	0.00%
Norma e varësisë së sistemit	1.17	1.17	

Burimi i të dhënave: ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH-së

Referuar të dhënave të tabelës së sipërme rezulton se:

Numri i pensioneve përgjatë vitit 2023 ka pësuar një rritje me 2.6% krahasuar me një vit më parë, pensionet e reja (që kanë plotësuar kushtet për tu lidhur në vitin korrent) janë rritur me 2.3% dhe ato të mbyllurat janë ulur me 10.3% krahasuar me vitin 2022. Masa mesatare e pensioneve të reja është rritur me 2.9% krahasuar me 2022, kjo si rezultat i rritjes së periudhës kontributeve në lidhje me këtë kategori dhe kontributeve të derdhura që sjellin një bazë të vlerësuar më të lartë, por dhe pensionet ekzistuese janë rritur si rezultat i indeksimit ç’ka sjellë shpenzime totale për përfitime më të larta në masën 4.5%, krahasuar me një vit më parë.

ISSH përgjatë vitit 2023, ka përpunuar më shpejt kërkesat për pension, koha mesatare e përpunimit të kërkesës për pension nga 25.2 ditë që ishte në vitin 2022 ka rezultuar në 42 ditë, gjithashtu përqindja e pensioneve të lidhura para afatit, ndaj totalit të pensioneve të lidhura përgjatë vitit është rritur me 3.7%, ç’ka tregon se kërkesat për pension janë administruar më mirë përgjatë vitit 2023.

- Moshë e daljes në pension ka ndryshuar vetëm për gratë krahasuar me një vit më parë, koha mesatare e gëzimit të pensionit është rritur me 0.2% kjo për shkak të reformës hyrë në fuqi në Janar 2015.

- Norma e varësisë së sistemit (numër mesatar i kontribuesve/numër mesatar i pensioneve) është ulur me 0.8%, krahasuar me vitin 2022, në vitin 2023 norma e varësisë është 0.84 ndërsa në vitin 2022 norma e varësisë ishte 0.85.

- Në vitin 2023 për një pensionist ishin 1.19 kontribues, nga 1.18 që ishte më parë, (ritmi i rritjes së përfituesve është 2.3% , ndërsa ritmi i rritje së kontribuesve është 3.2%).

Për vitin 2022 të hyrat gjithsej në ISSH janë 168,529 milion lekë , nga të cilat 105,657 milion lekë të ardhura të mbledhura nga DPT në vlerë 102,035 milion lekë dhe 3,622 milion lekë nga ISSH dhe 62,872 milion lekë financim nga buxheti i shtetit.

Financimi nga buxheti i shtetit duke krahasuar dy vitet për vitin 2023 vjen më një ulje prej 16,145 milion lekë.

Plani i të ardhurave për vitin 2023 është në vlerë 124,599 milion lekë, ndërsa të ardhurat e realizuara për vitin 2023 janë në masën 124,618 milion lekë, e përbërë nga DPT 119,979 milion lekë, nga ISSH 4,639 milion lekë, me një tejkalim në total prej 19 milion lekë, realizuar 100%, ndërsa të ardhurat nga transferata e buxhetit të shtetit ka qenë 46,727 milion lekë. Totali i të hyrave për vitin 2023, në total 171,345 milion lekë.

Duke krahasuar dy vitet u konstatua se: Financimi nga buxheti i shtetit duke krahasuar dy vitet për vitin 2023 vjen më një ulje prej 16,145 milion lekë. Ndërsa të ardhurat si ato nga DPT dhe ato në përgjithësi të ISSH kanë pësuar një rritje prej 18,961 milion lekë, nga të cilat: tatimet janë të rritura 17,944 milion lekë dhe nga ISSH kemi një rritje prej 1,017 milion lekë.

Të ardhurat nga suplementari për vitin 2023 janë në vlerë 1,968 milion lekë, ndërsa për vitin 2022 janë në vlerë 1,639 milion lekë.

Në mënyrë të detajuar treguesit financiar të performancës së ISSH-së paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 5 “Treguesit e situatës së sigurimeve shoqërore, për vitin 2023”

Përshkrimi	2023	2022	%Δ 23-22
Të ardhurat nga kontributet e drejtpërdrejta (milion lekë)	124,618	105,657	18%
Të ardhurat nga transferata e buxhetit të shtetit (milion lekë)	46,727	62,872	(26%)
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore (milion lekë)	170,238	163,037	4%
Rezultati fiskal (milion lekë)	1,107	5,492	(80%)

Burimi i të dhënave ISSH: përpunoi Grupi i auditimit KLSH-së

Konkluzion: ISSH përgjatë vitit 2023 ka vepruar në drejtim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara në statutin e saj, është përmirësuar në drejtim të administrimit të kërkesave për pension dhe në drejtim të treguesve financiarë korrent, duke realizuar të ardhurat e planifikuara në masën 100% dhe duke ruajtur limitet e miratuara të shpenzimeve.

Në të ardhmen pritet që shpenzimet të jenë më të larta për shkak të trendit rritës të: numrit të pensioneve, kohës mesatare të gëzimit të pensionit dhe treguesit të varësisë së sistemit. Këta tregues ndikohen dhe nga faktorët demografikë të popullsisë së Republikës së Shqipërisë.

Në drejtim të qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore situata paraqitet pozitive, pasi dhe norma e varësisë së sistemit është ulur me 0.8% krahasuar me një vit më parë.

Përsa më sipër mbajtur Akt konstatim nr.7 datë 19.07.2024 protokolluar në ISSH me nr.8026 prot; datë19.07.2024.

2.3. Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2023.

Në zbatim të drejtimit të mësipërm u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1.Rakordimet me institucionet përkatëse (MFE dhe DPT)
- 2.Pasqyrat financiare të ISSH-së të vitit 2023
- 3.Raporte vjetore të ISSH-së të vitit 2023
- 4.Raporte statistikore të ISSH-së dhe analiza statistikore, të vitit 2023.

Rezultati fiskal vjetor i ISSH për vitin 2023, sipas ISSH:

Viti 2023 është mbyllur me një rezultat fiskal pozitiv, me tepricë të të hyrave mbi shpenzimet në shumën 1,107 milion lekë. Realizimi i tyre për vitin 2023 paraqitet më poshtë:

Tabela nr. 3.1 "Të ardhura dhe shpenzime"

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Gjithsej		Diferenca	Realizimi në %
		Plan	Fakt		
I.	Të ardhurat	124,599,000	124,618,101	19,101	100%
1	DPT të ardhura	121,256,000	119,979,210	(1,276,790)	99%
2	ISSH kontribute të tjera		31,719	31,719	
3	ISSH të ardhura	3,343,000	4,607,172	1,264,172	138%
II.	Financime nga buxheti	46,727,235	46,727,235	-	100%
III.	Totali të ardhurave (I+II)	171,326,235	171,345,336	19,101	100%
	Shpenzimet				
I.	Transferta për buxhetet familjare e individët	167,775,962	166,940,791	(835,171)	100%
1	Shpenzime për përfitime	144,010,027	144,059,900	49,873	100%
2	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	16,207,276	16,107,171	(100,106)	99%
3	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,558,659	6,773,720	(784,938)	90%
II.	Shpenzime administrative	3,550,680	3,297,383	(253,296)	93%
III.	Totali i Shpenzimeve (I+II)	171,326,641	170,238,174	(1,088,467)	99%
	Rezultati fiskal		1,107,162		

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Shuma 31,719 mijë lekë janë derdhje kontributive referuar VKM-së nr. 909, datë 18.11.2020 "Derdhje kontributeve naftëtarë", derdhje si pasojë e vendimeve gjyqësore për të cilat ISSH nuk i ka të planifikuara.

Shuma 46,72,235 mijë lekë përfaqëson faktin e transfertës nga buxheti i shtetit për mbulimin e disa skemave të pensioneve.

Shuma 171,326,64 mijë lekë përfaqëson të ardhurat e planifikuara në total që kanë ardhur si pasojë e ndryshimeve të akteve ligjore.

Të ardhurat dhe shpenzimet të detajuara, plan dhe fakt paraqiten në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 3.2 "Të dhëna analitike të ardhura & shpenzime"

Në mijë lekë

TË ARDHURAT		Gjithsej		Diferenca	%
A	DPT	Plani Përfundimtar	Fakt		
		121,256,000	119,979,210	-1,276,790	99%
1	Sigurim shoqëror	118,776,000	118,010,882	-765,118	99%
	Buxhetorë	39,486,232	38,678,142	-808,090	98%
	Jo buxhetorë	6,563,103	6,732,743	169,640	103%
	Firma	68,187,069	68,165,264	-21,805	100%
	Individë	4,032,294	3,873,577	-158,717	96%
	Të tjera	507,302	561,156	53,854	111%
2	Suplementare	2,480,000	1,968,328	-511,672	79%
3	Kontribute të tjera	-	31,719	31,719	
	Sigurim shoqëror		31,719	31,719	
B	ISSH	3,343,000	4,607,172	1,264,172	524%
	Të vetpunësuar bujqësi	2,393,000	2,901,153	508,153	121%
	Vullnetare	600,000	711,898	111,898	119%
	Të ardhura tjera	350,000	994,121	644,121	284%
	Totali	124,599,000	124,618,101	19,101	623%
C	Financime nga buxheti	46,727,235	46,727,235	0	100%
	Totali të Ardhura (A+B+C)	171,326,235	171,345,336	19,101	100%
	SHPENZIMET	Plan	Fakt	Diferenca	%
A	Transferta për buxhetet familjare e individët (I+II+III)	167,775,962	166,941,402	-834,560	100%
I	Shpenzime për përfitime	144,010,027	144,060,511	50,484	100%
1	Kompensim për paaftësi të përkohshme për shkak të sëmundjes	589,611	684,730	95,119	116%
2	Kompensim për leje lindje	281,545	299,655	18,109	106%
	-Barrë lindje qytet	3,600,738	4,161,843	561,105	116%
	-Barrë lindje fshat	475,453	426,491	-48,962	90%
3	Totali shpenzimeve për pensione	139,039,624	138,464,734	-574,890	2
	-Pensione qyteti	126,367,490	125,889,891	-477,599	100%

	-Pensione fshati	12,672,134	12,574,844	-97,291	99%
4	Kompensim për paaftësi për shkak të dëmtimit në punë	23,055	23,058	2	100%
II	Shpenzime për programe të vecanta shtetërore	16,207,276	16,107,171	-100,106	99%
1	Kompensim supl. për çmimet për pensionistët	15,806,853	15,652,834	-154,018	99%
	-Kompensim supl. për çmimet për pensionistët qytet	14,980,723	14,889,267	-91,456	99%
	-Kompensim supl. për çmimet për pensionistët fshat	826,130	763,567	-62,563	92%
2	Pensione të vecanta shtetërore	91,827	179,839	88,012	196%
3	Pensione sociale (ishte-kompensim për ish të persekutuarit)	227,248	187,633	-39,615	83%
4	Kompensim për veteranët e luftës	48,051	40,458	-7,593	84%
5	Kompensim suplementar për çmimin e karburantit	33,297	46,407	13,110	139%
III	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,558,659	6,773,720	-784,938	90%
1	Sigurim suplementar për ish-ushtarakët	3,831,659	4,006,898	175,239	105%
2	Përfitime për policinë e shtetit		18,910	18,910	
3	Trajtime të vecanta për pilotët	98,398	78,151	-20,247	79%
4	Përfitime për ushtarakët e nëndetseve në pension.	12,590	12,492	-99	99%
5	Shpenzime për statusin dëshmor i atdheut	27,306	34,986	7,681	128%
6	Trajtime të vecanta për punonjësit e industrisë ushtarake	74,921	69,814	-5,106	93%
7	Transferta të tjera tek individët (shpenzime për statusin e profesorit)	231,676	215,155	-16,521	93%
8	Sigurim suplementar shtetëror për ish funksionareët	1,156,324	1,001,051	-155,273	87%
9	Pagesa të parakohshme për minatorët	1,244,649	600,043	-644,606	48%
10	Pagesa të parakohshme për naftëtarin	559,474	510,612	-48,862	91%
11	Pagesa të parakohshme për metalurgun	101,970	75,337	-26,633	74%
12	Transferta të tjera tek individët (shpenzime funerali)	219,691	150,272	-69,420	68%
B	Shpenzime administrative	3,550,680	3,297,256	-253,423	93%
1	Paga, shpërblime, dhe shpenz. tjera personeli	1,451,639	1,427,460	-24,179	98%
2	Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore	241,504	226,880	-14,624	94%
3	Mallra dhe shërbime të tjera	1,434,537	1,307,274	-127,263	91%
4	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	423,000	335,643	-87,357	79%
	Totali (A+B)	171,326,641	170,238,174	-1,088,467	99%
C	Rezultati fiskal (Fakt-Plan)		1,107,162		
D	Financimi i planifikuar dhe terhequr	46,727,235	46,727,235	0	100%
E	Financimi i nevojshëm (D-C)		45,620,073		

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga auditimi mbi saktësinë e treguesve të mësipërm ka rezultuar:

2.3.1. Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe rakordimi i tyre:

Plani fillestar i të ardhurave nga kontributet dhe financimi nga buxheti i shtetit për ISSH është miratuar me Ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, ku shuma e të ardhurave dhe shpenzimeve rezulton në total në shumën 159,912 milion lekë. Gjatë vitit janë bërë disa ndryshime me Aktin Normativ nr.5, datë 18.10.2023 “Për disa ndryshime në ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, ku shuma e të ardhurave dhe shpenzimeve janë 167,315 milion lekë, të cilat në raport me planin fillestar kanë efekt në rritjen e planit të të ardhurave nga kontributet me 14,576 milion lekë dhe të transfertës për indeksimin e pensioneve me 1,000 milion lekë, si dhe uljes së transfertës nga buxheti i shtetit me 15,576 milion lekë. E përmbledhur plani i ISSH-së me ndryshimet e buxhetit në skemën e Sigurimeve Shoqërore sipas ligjit vjetor të buxhetit dhe akteve normative paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 3.3 “Plani i të ardhurave me ndryshime”

Në milionë lekë

Buxheti i Sigurimeve Shoqërore (Në milionë lekë)	Ligji nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” Neni 4	AN nr. 5, datë 18.10.2023 Neni 4	Ndryshimet (Në vlerë) Plan fillestar/ përfundimtar
I. Skema e sigurimit të detyrueshëm	159,912	159,912	0
Kontributet	107,833	122,119	14,286
Transferimet nga buxheti i shtetit	46,449	31,163	(15,286)
Transferta për indeksimin e pensioneve	2,100	3,100	1,000
Bonusi i pensionistëve	3530	3530	0
Shpenzimet gjithsej	159,912	159,912	0
II. Skema e sigurimit suplementar	7,403	7,403	0

Kontributet	2,190	2,480	(290)
Transferimet nga buxheti i shtetit	5,113	4,823	290
Transferita për indeksimin e pensioneve	100	100	-
Bonusi i pensionistëve			-
Shpenzime gjithsej	7,403	7,403	0
III. Totali (I+II)	167,315	167,315	0
Kontributet	110,023	124,599	14,576
Transferimet nga buxheti i shtetit	51,562	35,986	(15,576)
Transferita për indeksimin e pensioneve (VKM nr. 553, datë 28.09.2023)	2,200	3,200	1,000
Bonusi i pensionistëve (VKM nr. 654, datë 30.11.2023)	3,530	3,530	
Total sipas MFE	167,315	167,315	167,315
Të Ardhura e Shpenzime gjithsej sipas ISSH		171,326	
Diferenca ISSH-MFE(ndryshime të buxhetit sipas VKM)		4,011	

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e ISSH, rezulton se plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore është në total në shumën 171,326 milion lekë. Në këtë plan janë përfshirë të ardhurat nga kontributet, si dhe financimi nga buxheti i shtetit, akorduar me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023”, ndryshimet me AN si dhe totali i financimeve me VKM për programe të veçanta në shumën 4,011 milion lekë.

Financimet me VKM, gjatë vitit 2023:

Tabela nr.3.4 “Financimet me VKM”

Në mijë lekë

Nr.	VKM	Përfshirë në AN	Shuma e financuar sipas (VKM)	Shuma sipas (AN)	Ndryshimet në Buxhetin e ISSH
1		Nr. 553, datë 28.09.2023	3,184.00	3,200	-16
2	Nr. 187, datë 31.03.2023		3,536.74		3,536.74
3		Nr.654, datë 30.11.2023	3,530	3,530	0
6	Nr.819,datë 28.12.2023		490.5		490.5
	Totali		10,741	6,730	4,011

Burimi i të dhënave: ISSH, të përpunuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Në tabelën 3.4 reflektohen ndryshimet ndërmjet shumave të financuar me AN dhe shumave financuar me VKM, ndryshim ky, që vërehet tek zbatimi i VKM-së nr. 553, datë 28.09.2023 “Për Indeksimin e pensioneve”, e cila sipas AN është programuar për 3,200 milion lekë, ndërsa efekti financiar sipas këtij vendimi do të përlllogaritet në shumën 3,184 milion lekë. Pra, sipas kësaj VKM-je efekti financiar i përlllogaritur është më pak në shumën 16 milion lekë, krahasuar me përcaktimin në AN, diferencë kjo që është mbuluar nga buxheti vjetor i ISSH-së. Diferenca prej 4,011 milion lekë i përket fondeve të alokuara ISSH-së, në zbatim të VKM-ve, të cituara në tabelën nr. 3.4, nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë si më poshtë:

- Në VKM nr. 187, datë 31.03.2023 “Për shpërblimin e pensionistëve për vitin 2023”, efektet financiare në shumën 3,536,735 mijë lekë, do të mbulohe nga “Fondi i Kontigjencës”, i miratuar në buxhetin e vitit 2023.

- Në VKM nr. 553, datë 28.09.2023 “Për Indeksimin e pensioneve”, efektet financiare në shumën 3,184,000 mijë lekë do të mbulohe nga fondi për politikën e indeksimit të pensioneve të parashikuara në buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 2023.

- Në VKM nr. 819, datë 28.12.2023 “Për shpërblimin e kategorisë së personave që përfitojnë pension invaliditeti dhe pension familjar, për vitin 2023”, efektet financiare në shumën 560,473 mijë lekë do të mbulohe nga “Fondi i Kontigjencës”, i miratuar në buxhetin e vitit 2023 dhe buxheti i Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023.

Në lidhje me financimin nga buxheti i shtetit, ISSH ka rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë për shumën 46,727 milion lekë, sipas Akt rakordimit, nr. 235, datë 09.01.2024, referuar ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2023” dhe në vijim të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, për periudhën 12 mujore të vitit 2023.

Konkluzion: Nga verifikimi i të dhënave mbi planin e të ardhurave dhe shpenzimeve për ISSH, në raport me treguesit fiskal të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, të raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është evidentuar se: Nga krahasimi i planit përfundimtar të të ardhurave të ISSH (kontributet/të ardhura tatimore) dhe të dhënave të tabelës “Treguesit Fiskal të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit”, Kapitulli II.3.1 “Të ardhurat nga fondet speciale”, rezulton se plani i të ardhurave është i rakorduar, në shumën 124,599 milion lekë.

Përsa i përket planit të shpenzimeve, midis dy institucione ka një mos përputhje në shumën 4,011 milion lekë. Planin e shpenzimeve në raport me treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, të raportuar nga MFE Kapitulli I.5 “Totali i shpenzimeve”, është raportuar në shumën 170,237 milion lekë, më pak për 4,011 milion lekë se sa raportuar nga ISSH.

Realizimi i të ardhurave dhe rakordimi i tyre.

Skema e të ardhurave për mbulimin e shpenzimeve të skemës së sigurimeve shoqërore përbëhen nga dy grupe kryesore:

1. Të ardhura nga kontributet (DPT+ISSH).
2. Financimi nga buxheti i shtetit.

Realizimi i të ardhurave nga kontributet sipas ISSH, bazuar në rakordimin me DPT, MFE dhe llogarinë e të ardhurave të ISSH-së, për kontributet e derdhura në ISSH (të vetëpunësuar në bujqësi dhe sigurim vullnetar), paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr.3.5 “Të ardhurat totale”, viti 2023

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Gjithsej		Diferenca	Realizimi në %
		Plan	Fakt		
I (1+2+3)	Të ardhurat (DPT+ISSH)	124,599,000	124,618,101	19,101	100
1	DPT të ardhura	121,256,000	119,979,210	-1,276,790	99
2	ISSH të ardhura	3,343,000	4,607,172	1,264,172	138
3	ISSH kontribute të tjera. (Derdh në llog, të ISSH)		31,719	31,719	
II	Financime nga buxheti	46,727,235	46,727,235	-	100
III	Totali të ardhurave (I+II)	171,326,235	171,345,336	19,101	100

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Kontributet e sigurimet shoqërore, të derdhura nga subjektet fizike e juridike, privat e buxhetore, kontribues të bujqësisë dhe vullnetarë dhe të ardhura të tjera rezultojnë në shumën 124,618,101 mijë lekë, nga të cilat 119,979,210 mijë lekë, ose 96 % e tyre janë mbledhur nga DPT dhe 4,638,891 mijë lekë, ose 4 % e tyre janë mbledhur nga ISSH.

Tabela nr. 3.6 “Realizimi i të ardhurave nga kontributet 2023/2022 dhe F/P 2023

Në mijë lekë

Të ARDHURAT	Fakt 2022	Viti 2023		Realizimi në %		
		Plan	Fakt	2023/2022	F/P2023	
1	Sektori publik+privat	99,966,499	118,776,000	118,010,882	118	99
	Buxhetore	33,375,606	39,115,038	38,678,142	116	99
	Jo buxhetore	5,547,456	6,808,794	6,732,743	121	99
	Firma	57,635,135	68,935,237	68,165,264	118	99
	Individë	3,408,291	3,917,332	3,873,577	114	99
2	Të tjera DPT	428,797		561,156	131	
3	Suplementare	1,639,271	2,480,000	1,968,328	120	79
	DPT(1+2+3)	102,034,567	121,256,000	119,979,210	118	99
4	Vullnetarë	573,359	600,000	711,898	124	119
5	Të vetpunësuar bujqësi	2,364,956	2,393,000	2,901,153	123	121
6	Të ardhura tjera (jo tatimore)	637,391	350,000	994,121	156	284
7	Derdh në llog e sig (tatimore)	46,250	-	31,719	69	
	ISSH(4+5+6)	3,621,956	3,343,000	4,607,172	127	138
	Gjithsej Sigurime	105,656,523	124,599,000	124,618,101	118	100

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga analiza e detajimit të planit dhe realizimit për vitin 2023, ka rezultuar se ISSH, në detajimin e planit të të ardhurave nga kontributet (të ardhura tatimore) në shumën 124,599,000 mijë lekë, të miratuar nga MFE për rrjedhojë dhe faktit të të ardhurave ka përfshirë edhe “të ardhura të tjera” (nga

ISSH), të cilat sipas klasifikimi buxhetor, janë të ardhura jo për kontribute të sigurimeve shoqërore, respektivisht në shumën 350,000 mijë lekë në plan dhe 1,740,926 mijë lekë në fakt.

Pësa i përket planit të të ardhurave:

Nga ISSH, është bërë planifikim i të ardhurave jo tatimore në shumën 350,000 mijë lekë, si pjesë e planit të miratuar nga MFE në shumën 124,599,000 mijë lekë, plan i cili përfaqëson të ardhura tatimore nga kontributet, e detajuar në: plani i të ardhurave nga kontributet në shumën 124,249,000 mijë lekë dhe nga të ardhura të tjera (jo tatimore) në shumën 350,000 mijë lekë.

Të ardhurat e planifikuara sipas strukturave mbledhëse nga ISSH janë ndarë në të ardhura nga kontributet e mbledhura nga DPT, që rezultojnë në total në shumën 121,256,000 mijë lekë dhe të ardhura nga kontributet e mbledhura nga vet ISSH në total në shumën 2,993,000 mijë lekë, në total 124,249,000 mijë lekë, ndërsa të ardhurat jo për kontribute për sigurime shoqërore janë detajuar, nga ISSH në shumën 350 milion lekë.

Përsa i përket realizimit të të ardhurave:

- Të ardhurat e mbledhura nga DPT, në shumën 119,979,210 mijë lekë, përbëhen nga: të ardhura nga derdhja e kontributeve (të ardhura tatimore) në shumën 119,418,054 mijë lekë dhe të ardhura të tjera (jo për kontribute për sigurime shoqërore), nga gjoba dhe kamatë vonesa në shumën 561,156 mijë lekë, sipas rakordimit të ISSH me MFE. Si rrjedhim i përfshirjes në të ardhurat tatimore të realizuara gjithsej edhe ato të të realizuar nga gjobat, rezulton se të ardhurat e mbledhura nga DPT, realisht janë realizuar në masën 98.5% dhe jo 99%.

- Kontribute të mbledhura nga vetë ISSH (të vetëpunësuar në bujqësi, vullnetarë dhe të tjera) në total janë paraqitur në shumën 4,607,172 mijë lekë, nga e cila 711,898 mijë lekë janë kontribute vullnetare; shuma 2,901,153 mijë lekë janë kontribute nga të vetëpunësuar në bujqësi. Në shumën 2,901,153 mijë lekë e të ardhurave të realizuara nga kontribute për të vetëpunësuar në bujqësi, janë përfshirë edhe të ardhura të tjera (jo kontributive) nga kamatëvonesa në shumën 185,649 mijë lekë. Të ardhura tjera (jo tatimore) në shumën 994,121 mijë lekë ku përfshihen të ardhura nga komisione, interesat (729,893 mijë lekë komisione + 825.19 mijë lekë nga shërbime + 263,403 mijë lekë arkëtimet nga debitorët e përfitimeve) ose realizuar 184% më shumë se sa planifikimi vjetor dhe 56% më shumë se viti i kaluar.

Kontributet e tjera në shumën 31,719 mijë lekë përfaqësojnë të ardhura nga ekzekutim vendime gjykate në shumën 197.04 mijë lekë; kontribute për gratë e diplomatëve në shumën 4,019.68 mijë lekë dhe kontribute për naftëtarët në shumën 27,501.95 mijë lekë. Krahasuar me vitin 2022, janë realizuar 69% më shumë.

Nga ana e ISSH-së në faktin e të ardhurave janë përfshirë edhe “të ardhura të tjera” të cilat sipas klasifikimi buxhetor, janë të ardhura jo kontributive ose “Të tjera DPT dhe ISSH” gjithsej në shumën 1,740,926 mijë lekë (nga DPT 561,156 mijë lekë+nga ISSH 1,179,767 mijë lekë).

Konkluzion: Nga analiza e planifikimit dhe realizimit të treguesve për vitin 2023, ka rezultuar se ISSH nuk ka kryer një detajim të drejtë të planit të të ardhurave dhe për rrjedhojë të realizimit dhe analizave përkatëse, pasi në faktin e realizimit të të ardhurave nga ISSH janë përfshirë dhe të ardhurat jo tatimore në shumën 1,740,926 mijë lekë. Të ardhurat tatimore të realizuara në vitin 2022, kundrejt planit në shumën 124,599,000 mijë lekë, janë në shumën 122,877,175 mijë lekë dhe të ardhura jo tatimore në shumën 1,740,926 mijë lekë. Realizimi i të ardhurave nga kontributet referuar planit të miratuar nga MFE, nuk është në masën 100 %, por 98,6 %.

Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara:

Tabela nr.3.7 “Rakordimi i të ardhurave të realizuara me MFE”

Në mijë lekë

Burimi i të dhënave: ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH	ISSH	MFE
Përshkrimi		
Gjendje në 01.01.2023	2,147,891	2,147,891
Tatimore (Klasa 7, llog 75)	119,418,054	119,418,054
Jo tatimore (Klasa 7, llog.711), gjoba	385,459	385,459
Jo tatimore (Klasa 7, llog.709), kamatëvonesa.	175,697	175,697
Total të ardhura	119,979,210	119,979,210

Transferuar nga TSA ¹ progresive	120,475,000	120,475,000
Gjendja më datë 31.12.2023	1,652,101	1,652,101

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Të ardhurat e mësipërme janë konfirmuar nga dy institucionet me Akt rakordim nr.950/1 prot; datë 25.01.2024 të MFE dhe nr. 235/1, datë 12.01.2024 të ISSH, për vitin 2023. Sipas këtij akt rakordimi:
- Gjendja e të ardhurave cash në fillim të vitit 2023 është 2,147,890,534 lekë. Të ardhurat e realizuara nga DPT rezultojnë në total 119,979,210,237 lekë nga e cila:

Në skemën e sigurimit të detyrueshëm+të ardhurat në skemën suplementare rezultojnë 119,418,054,465 lekë, të cilat zënë 95,5% të realizimit gjithsej të të ardhurave nga DPT.

-Të ardhurat jo tatimore (gjoba & kamatë vonesa) rezultojnë në total 561,155,772 lekë (385,458,471 +175,697,301), të cilat zënë 0,5% të realizimit gjithsej të të ardhurave nga DPT.

- Sipas MFE të ardhurat e transferuara në llogarinë e unifikuar të thesarit “Depozitë qeverie” pranë Bankës së Shqipërisë janë në vlerën 120,475,000,000 lekë.

- Gjendja e të ardhurave cash në fund të vitit 2023 është 1,652,100,771 lekë për llogari të vitit 2023, e cila transferohet në bankë në vitin 2024 dhe paraqitet në Aktiv të bilancit vjetor në llog 44 “Institucione të tjera publike”.

Rakordimi me Treguesit Fiskale të Konsoliduar të Buxhetit:

Tabela nr.3.8 “Raportimi i realizimit të të ardhurave dhe ndryshimet/diferencat në raportim”, viti 2023

Në milionë lekë

Nr.	Përshkrimi	Të ardhura të realizuara	Diferencat midis raportimeve		
		a	b=(1-2)	c=(1-3)	d=(2-3)
1	ISSH (Rakordimi me DPT dhe të ardhurat e ISSH)	124,618			
2	ISSH-MFE (Treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit)	124,628	(10)		
3	ISSH-MFE (Oracle)	124,575		(43)	
					(53)

Burimi i të dhënave: ISSH. të përpunuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Diferencat e mësipërme, mbi të ardhurat e realizuara nga ISSH sipas raportimeve nga ISSH dhe ato të regjistruara në sistemin Oracle, për vitin 2023, kanë një ndryshim në shumën 43 milion lekë. Sipas raportimit Acruar të ISSH totali i të ardhurave nga kontributet (DPT+ISSH) rezultojnë të jenë 124,618 milion lekë, ndërkohë që sipas raportimit në sistemin Oracle të MFE “Realizimi i Buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqëror” për zërin “Të ardhura (Drejt. e Tatimeve) ISSH” rezulton të jenë në shumën 124,575 milion lekë. Nëse krahasojmë treguesit fiskal të MFE zëri Të ardhura nga fondet speciale “Sigurimet Shoqërore” me të dhënat e raportuara nga ISSH rezulton diferencë në vlerën 10 milion lekë më shumë.

Konkluzion: Nga krahasimi i të ardhurave të raportuara nga ISSH dhe të dhënave të Tabelës së treguesve të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, Kapitulli II.3 “Të ardhurat nga fondet speciale” dhe të dhënave të sistemit Oracle për zërin “Të ardhura (Drejt. e Tatimeve) ISSH” rezulton se fakti i të ardhurave nuk është i rakorduar. Sipas të dhënave të MFE fakti i “Të ardhurave nga fondet speciale “Sigurimet Shoqërore” paraqitet në vlerën 124,628 milion lekë, pra me diferencë në vlerën 10 milion lekë më shumë, krahasuar me ISSH që paraqiten në vlerën 124,618 milion lekë, si pasojë e raportimit ndryshe mbi treguesit fiskal të MFE zëri “Të ardhura nga fondet speciale Sigurimet Shoqërore”.

Të ardhurat e realizuara e të deklaruara nga ISSH janë në shumën 124,618 milion lekë ku përfshihen të ardhurat tatimore në shumën 122,877 milion lekë dhe të ardhura jo tatimore (jo për kontribute për sigurime shoqërore), në shumën 1,741 milion lekë.

Mbi financimin nga buxheti i shtetit:

Financime të buxhetit të shtetit, të cilat janë grante nga buxheti i shtetit për mbulimin e shpenzimeve të disa skemave të pensioneve dhe financime nga buxheti i shtetit për mbulimin e deficitit të skemës së pensioneve, për vitin 2023 kanë rezultuar në shumën 46,727 milion lekë. Plani nga Transferta e Buxhetit sipas ligjit ka qenë në shumën 57,292 milion lekë dhe si pasojë e ndryshimeve ligjore totali

¹ Llogaria e unifikuar e thesarit “Depozitë qeverie” llogari e personalizuar në BSH që menaxhohet nga MFE për Fondin e Sigurimeve Shoqërore.

i tyre rezultojn në shumën 46,727 milion lekë, pra rezultojn me ulje në shumën 10,565 milion lekë ose ulur në masën 18.4% nga i planifikuari. Kjo ka ndodhur sepse sipas AN ka patur rishikim të buxhetit, i cili ka sjell rritje të planit të të ardhurave nga kontributet (ndikuar nga rritja e pagave) dhe uljen e transfertës nga buxheti i shtetit.

Transferta nga buxheti i shtetit – për buxhetin e ISSH-së, miratuar sipas ligjit 84/2022, realizohet sipas rregullave të përcaktuara të thesarit, deri në limitet e programuara dhe me miratim të Drejtorisë së Thesarit në Ministrinë e Financave për financimet ditore dhe në total. Marrëdhëniet ndërmjet ISSH dhe Buxhetit të shtetit, lidhur me transfertat e programuara janë mbajtur nëpërmjet Degës së Thesarit Tiranë, sipas akt rakordimeve. Transferimi i kontributeve të paguara nga subjektet për llogari të ISSH, ndjek skemën: subjekt-Banka të nivelit II-TSA-Llogari e Unifikuar e kontributeve (në Bankën e Shqipërisë për Fondin e Sigurimeve Shoqërore).

Tabela nr.3.9 “Të dhëna analitike mbi financimin nga buxheti i shtetit, viti 2023”

Në lekë

Llog.	Përshkrimi	Shuma
755	Kontribute të buxhetit për:	4,771,702,486
	Sig.shoq. Per ushtaret	0
	Sig.shoq.per te papunet	919,632,000
	Sig.shoq.per ushtarake ne reforme e pension te parakohshem	201,607,954
	Sig.shoq.per police ne ref dhe pension te parakohshem	122,062,464
	Sig.shoq.per ish-funksionaret	27,118,058
	Sig.shoq.per ushtarake ne reforme e pension te parakohshem	2,682,101,000
	Sig. Shoq. Per gra te pensionuara	794,945,810
	Sig.shoq.per punonj. E industrise ushtarake+sigurime per punonjesit e minierave	24,235,200
720	Grante nga buxheti per pagesa te posacme	16,055,514,000
	Grante per komps. E rritjes se cmimit nga pens. Te ardh. Per pens.(+energji elek)	4,793,871,000
	Shperblimi i pensionisteve Prill 2023	3,536,735,000
	Bonusi pensionisteve	3,530,000,000
	Bonusi invalideve&pensionit familjar	490,500,000
	Kompensim cmimesh dhe te ardhurash	3,523,912,000
	Grante per pensione shteterore te posacme	96,503,000
	Grante per shitesa te parashikuara per veteranet	49,113,000
	Grante per shitesa te parashikuara per invalidet e punes	34,880,000
720	Grante nga buxheti per trajtime te vecanta	5,728,950,000
	Grante per shitesa te parashikuara per pensionet e ushtarakeve te tjere	2,407,944,000
	Sigurim suplementar per ish-ushtaraket	0
	Perfitime per policine e shtetit	249,404,000
	Perfitime per ushtaraket e nendetseve ne pension.	12,890,000
	Grante per pagesa kalimtare e pensione te ish funksionareve	530,254,259
	Grante per pagesa per shitesa te parashikuara per deshmoret	28,449,000
	Grante per pagesa per shitesa te parashikuara per minatoret	1,701,263,000
	Grante per pagesa per shitesa te parashikuara per pilotet	100,591,000
	Grante per pagesa per shitesa te parashikuara per industrine ushtarake	76,782,000
	Per shpenzime varrimi	219,495,741
	Perfitime per statusin e profesorit	169,298,000
	Pensione sociale	232,579,000
720	Grant nga buxheti per mbulimin e deficitit	20,171,068,514
	Diference kontributi per fermeret	5,298,965,880
	Grante per mbulim dificitit	14,872,102,634
	Totali	46,727,235,000

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Krahasuar me vitin 2022 financimi nga buxheti i shtetit është ulur në total në shumën 16,145 milion lekë. Ulja e transfertës nga buxheti i shtetit ka ardhur si rezultat i rritjes së të ardhurave nga kontributet në masën 18%, në krahasim me një vit më parë dhe për shkak të rritjes së pagës minimale dhe pagave në tërësi në sektorin publik dhe atë privat si dhe rritjes së numrit të kontribuesve sipas subjekteve në 700,439 kontribues ose 13,683 kontribues më shumë se viti kaluar dhe rritjes së numrit të kontribuesve të vetëpunësuar në bujqësi në 75,451 kontribues ose 13,381 kontribues më shumë se viti kaluar, dukë bërë që për çdo pensionist të ketë 1.19 nga 1,18 që krahasuar me vitin 2022. Në vitin 2023 morën pensione pleqërie 590,649 persona me një rritje vjetore prej 3.1%. Nga ana tjetër, pensionet e reja të vitit 2023 ishin ndjeshëm më të ulëta se pensioni mesatar mujor në shkallë vendi (18,300 lekë/muaj), kështu pensioni mesatar mujor i pleqërisë në zonat urbane është 18,341 lekë/muaj

nga 17,350 lekë/muaj vitin e kaluar dhe për zonat rurale në 11,051 lekë/muaj nga 10,349 lekë/muaj vitin e kaluar².

Konkluzion: ISSH me Akt rakordim nr. 235, datë 09.01.2024 ka rakorduar në nivel grupi, titulli, artikulli dhe llogari ekonomike me Degën e Thesarit Tiranë, për fondet e alokuara nga buxheti i shtetit në shumën 46,727,235 mijë lekë, referuar Ligjit nr. 84/2022 “Mbi buxhetin e shtetit të vitit 2023” dhe Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. Krahasuar me vitin 2022 financim, i cili ka qenë 62,872 milion lekë, në vitin 2023 është ulur në shumën 16,145 milion lekë, por për shkak të rezultatit fiskal pozitiv, nevoja për përdorimin e këtij financimi ka qenë në shumën 45,620,073 mijë lekë, ose 1,107,162 mijë lekë më pak se financimi i tërhequr. Meqënëse financimi nga buxheti i shtetit për mbulimin e shpenzimeve të disa skemave të pensioneve si dhe ulja e deficitit të degës së pensioneve, në vitin 2023, janë në ulje, kjo tregon pritshmëri, në vitin më pas, në ulje të financimit nga buxheti i shtetit.

Realizimi i të ardhurave, analizë treguesish mbi të ardhurat nga kontributet, realizimi i tyre sipas sektorëve.

Tabela nr.3.10 “Të ardhurat totale”, viti 2023

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Gjithsej		Diferenca	Realizimi në %
		Plan	Fakt		
I (1+2+3)	Të ardhurat (DPT+ISSH)	124,599,000	124,618,101	19,101	100
1	DPT të ardhura	121,256,000	119,979,210	-1,276,790	99
2	ISSH të ardhura	3,343,000	4,607,172	1,264,172	138
3	ISSH kontribute të tjera. (Derdh në llog të ISSH)		31,719	31,719	
II	Financime nga buxheti	46,727,235	46,727,235	-	100
III	Totali të ardhurave (I+II)	171,326,235	171,345,336	19,101	100

Burimi i të dhënave: ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

- Kontribute të mbledhura nga DPT për llogari të ISSH, në shumën 119,979,210 mijë lekë, nga e cila 119, 418,054 mijë lekë janë të ardhura nga derdhja e kontributeve dhe 561,156 mijë lekë, janë të ardhura të tjera, nga gjoba dhe penalitete sipas rakordimit të ISSH me MFE.

- Kontribute të mbledhura nga vetë ISSH (të vetëpunësuar në bujqësi, vullnetarë dhe të tjera), në total janë paraqitur në shumën 4,607,172 mijë lekë, nga e cila 3,613,051 mijë lekë janë kontribute (vullnetarë dhe të vetëpunësuar në bujqësi) dhe 994,121 mijë lekë janë të ardhura jo tatimore që përbëhen nga të ardhura nga interesat në shumën 729,893 mijë lekë, të ardhura nga komisione për shërbime në shumën 825.19 mijë lekë dhe të ardhura të tjera nga arkëtimet nga debitorë e përfitimeve në shumën 263,403 mijë lekë.

- Kontributet e tjera të pa planifikuara në shumën 31,719 mijë lekë, përfaqësojnë të ardhura nga ekzekutim vendim gjykate në shumën 197.04 mijë lekë; kontribute për gratë e diplomatëve në shumën 4,019.68 mijë lekë dhe kontribute për naftëtarët në shumën 27,501.95 mijë lekë, të cilat derdhen në llogari të ISSH.

Tabela nr. 3.11. “Realizimi i të ardhurave nga kontributet 2022/2021 dhe P/F 2022”

Në 000/ lekë

Nr.	Të ardhurat	Fakti 2022	Viti 2023			
			Plan	Fakt	Realizimi në %	
					F2023/F2022 %	F/P 2023
I	Sektori Publik	38,923,062	45,923,832	45,410,885	16,6	99
1	Buxhetore	33,375,606	39,115,038	38,678,142	15,8	99
2	Jo Buxhetore	5,547,456	6,808,794	6,732,743	21,3	99
II	Sektori privat	61,043,426	72,852,569	72,038,841	18	99
1	Biznes i madh	57,635,135	68,935,237	68,165,264	18,2	99
2	Biznesi i Vogël	3,408,291	3,917,332	3,873,577	13,6	99
III	Sigurim Suplementar	1,639,271	2,480,000	1,968,328	20	79
IV	Të tjera DPT	428,797		561,156	30,8	
	DPT (I+II+III+IV)	102,034,556	121,256,000	119,979,210	17,5	99
IV	Vullnetar	573,359	600,000	711,898	24,1	119
V	Të vetpunësuar në bujqësi	2,364,956	2,393,000	2,901,153	22,6	121

² Të dhëna të marrë nga Sektori Statistikës dhe Drejtoria e Financës ISSH.

VI	Të tjera ISSH	637,391	350,000	994,121	55,9	284
VII	Derdh në llog e sig	46,250		31,719	(31,5)	
	ISSH (IV+V+VI+VII)	3,621,956	3,343,000	4,638,891	28	139
	Gjithsej Sigurime shoqërore	105,656,512	124,599,000	124,618,101	17,9	100

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

- Të ardhurat nga skema e sigurimit të detyrueshëm për sektorin publik dhe privat nga subjektet në përgjegjësi të DPT-së janë realizuar në masën 99%, krahasuar me një vit më parë ka një rritje në masën 17%.

- Të ardhurat nga skema suplementare janë realizuar në masën 79%, krahasuar me një vit më parë ka një rritje në masën 20%, çka tregon një planifikim jo të bazuar në tregues realë, pasi realizimi është pothuajse në të njëjta nivele me vitin e kaluar.

- Të ardhurat e mbledhura në ISSH janë realizuar në masën 139%, krahasuar me një vit më parë ka një rritje në masën 28%.

Analizë mbi faktorët që kanë ndikuar në realizimin faktik të të ardhurave Rritja e të ardhurave dhe numrit të kontribuesve të subjekteve në përgjegjësi të DPT, në krahasim me periudhën e mëparshme.

Tabela 3.12. "Të ardhura dhe kontribues nga DPT 2023/2022"

Në milionë lekë

Përshkrimi	Të ardhura		Kontribues		Diferenca		Ndryshimi në %	
					2023/2022		2023/2022	
	2022	2023	2022	2023	Të ardhura	Kontribues	Të ardhura	Kontribues
Institucione buxhetore	33,376	38,678	143,254	143,958	5,302	704	15,8	0.5
Institucione jo buxhetore	5,547	6,733	22,876	21,616	1,186	-1,260	21,3	-6
Firma private	57,635	68,165	385,412	394,746	10,530	9,334	18,2	2.4
Të vetëpunësuar	3,408	3,874	135,215	140,119	466	4,904	13,6	3.6
Totali	99,966	117,450	686,756	700,439	17,484	13,683	17,4	2

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Në krahasim me vitin 2022, numri i kontribuesve sipas subjekteve në përgjegjësi të DPT-së është rritur me 13,683 persona dhe të ardhurat 17,484 milionë lekë më shumë.

Duke u nisur nga kontributi mesatar vjetor për një kontribues në vitin 2023 dhe kontributi mesatar për një kontribues të vitit 2022 (Të ardhura/numër kontribues), kemi një rritje të këtij treguesi në masën 15 %, ndërsa numri i kontribuesve është rritur me 2%.

Tabela nr. 3.13 "Ndikimi i treguesve në rritjen e të ardhurave"

Në milionë lekë

Sipas subjekteve	Numri i kontribuesve 2023	Të ardhurat Kontributi mesatar 2022	Të ardhurat Kontributi mesatar 2023	Diferenca për efekt të Δ kontributit mesatar
Ndërmarrje buxhetore	143,958	33,539	38,678	5,139
Institucione jo buxhetore	21,616	5,241	6,733	1,491
Firma private	394,746	59,030	68,165	9,135
Të vetëpunësuar	140,119	3,532	3,874	342
Totali	700,439	101,342	117,450	16,107
	Përlllogaritjet (Ndikimi)			
	Diferenca nga efekti i Δ kontributit		(16,107)	
	Rritja e të ardhurave total		17,484	
	Nga rritja e numrit të kontribuesve		1,377	

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme rezulton se: rritja e të ardhurave në shumën 17,484 milion lekë, ka ardhur kryesisht nga rritja e kontributit mesatar për shumën 16,107 milion lekë ose 92% dhe nga rritja e numrit të kontribuesve për shumën 1,377 milion lekë ose 8%.

Tabela nr. 3.14 Ndikimi nga rritja e numrit të kontribuesve

Në lekë

Subjekte	Kontribues	Kontributi mesatar vjetor në lekë		Të ardhura		Diferenca
	2023	2022	2023	Kontribues 2023*mesatare 2022	Kontribues 2023*mesatare 2023	Δ e kontributit mesatar
Buxhetore	143,958	232,978	268,676	33,539,046,924	38,678,000,000	5,138,953,076
Jo Buxhetore	21,616	242,481	311,482	5,241,469,296	6,733,000,000	1,491,530,704
Firma private	394,746	149,541	172,681	59,030,711,586	68,165,000,000	9,134,288,414
Të vetëpunësuar	140,119	25,204	27,648	3,531,559,276	3,874,000,000	342,440,724
Total	700,439	650,205	780,486	101,342,787,082	117,450,000,000	16,107,212,918

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Për të përlogaritur ndikimin e treguesve në rritjen e të ardhurave është mbajtur parasysh treguesi “numër kontribuesish” dhe treguesi i ndryshueshëm “kontributi mesatar vjetor/një kontribues”, duke nxjerrë efektin në rritjen e të ardhurave si rezultati i rritjes së kontributit mesatar 2023/2022, e cila rezulton më shumë për 16,107,212 mijë lekë. Rritja e numrit të kontribuesve në 13,683 persona ka sjellë ndikim në rritjen e kontributit mesatar vjetor në total për 130,281 lekë ose në masën 20% më shumë ndaj vitit 2022. Rritje më të lartë ka sektori jo buxhetor me 28% e më pas sektori buxhetor dhe firmat private me 15%.

Faktorë që kanë ndikuar në rritjen e të ardhurave të mbledhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore për kategoritë e mëposhtme në raport me një vit më parë janë:

-Realizimi dhe tejkalimi i detyrave të programuara nga inspektorët e sektorit Të vetëpunësuarve në Bujqësi dhe të Sigurimit Vullnetar, nëpërmjet:

-Publicitetit të vazhdueshëm të opinionit publik, në drejtim të njohjes së kuadrit ligjor mbi përfitimet e kategorisë së personave të vetëpunësuar në bujqësi, veçanërisht mbi mundësinë dhe rëndësinë e mbulimit me sigurim edhe të periudhave të kaluara për plotësimin e vjetërsisë së punës.

- Rritja e interesit tek grup moshat në prag të mbushjes së moshës për pension, për të plotësuar periudhën minimale prej 15 vite, për përfitimin e një pensioni pleqërie.

- Interesi i shtuar i nënave të reja për t'u siguruar në skemën e të vetëpunësuarve në bujqësi, për efekt përfitimi të raporteve të barrëlindjes.

- Interes i shtuar për këtë kategori edhe për të përfituar shërbimin shëndetësor falas.

- Publiciteti i vazhdueshëm i opinionit publik, në drejtim të njohjes së kuadrit ligjor mbi përfitimet që rrjedhin nga skema e sigurimit vullnetar, ndërgjegjësimi dhe sensibilizimi i qytetarëve mbi rëndësinë për plotësimin dhe mbulimin me sigurim vullnetar të periudhave boshe që ata kanë në historikun e tyre kontributiv, qofshin këto periudhave të kaluara apo edhe për rritjen e nivelit të kontributeve të paguara me qëllim përfitimin e një pensioni më të lartë.

- Kuotat e subvencionuara nga buxheti i shtetit, ka shtuar interesin në përfshirjen dhe qëndrueshmërinë në skemën e kontribuesve fermerë (subvencioni për zonat fushore është 65% dhe për zonat malore është 73%).

- Përfshirja e kontribuesve të rinj në skemën e sigurimit të personave të vetëpunësuar në bujqësi.

Sipas treguesit “Hyrës të rinj” në skemën e sigurimit të të vetëpunësuarve në bujqësi për periudhën Janar - Dhjetor 2023, rezultojnë 7,512 kontribues të rinj, ose 1,012 kontribues të rinj më shumë se kontribuesit e rinj të realizuar në vitin 2022.

- Rritja e pagës minimale, e cila ka efekt në kontributin mesatar për një kontribues në skemën e Sigurimit Vullnetar (21.6% të pagës minimale vetëm për efekt vjetërsie) dhe rritja e numrit të kontribuesve, krahasuar me periudhën e mëparshme.

Të ardhurat nga kontributet të mbledhura nga DPT, të rakorduara, të raportuara dhe të kontabilizuara. Sipas aktrakordimit me DPT.

Në lidhje me realizimin e të ardhurave nga kontributet me shkresën nr. 345, datë 10.01.2024 të DPT, protokolluar në ISSH me nr. 419, datë 12.01.2024, janë dërguar treguesit e sigurimeve shoqërore për periudhën Janar - Dhjetor 2023, të cilët përputhen me Treguesit e Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit dhe që paraqiten si më poshtë:

Kontribute shoqërorë në shumën 119,419,349 mijë lekë (të ardhura tatimore)

Gjoha dhe kamatë vonesa në shumën 561,156 mijë lekë (të ardhura jo tatimore)

Totali: 119,980,504 mijë lekë.

Tabela nr.3.15 “Të ardhura të realizuara për ISSH, sipas DPT ”

Në 000/ lekë

Nr.	Përshkrimi	Treguesit sipas DPT
I	Kontribute shoqërore	119,419,349
1	Sektori Buxhetor	38,679,436
2	Sektori jo buxhetor	6,732,743
3	Sektori Privat	68,165,264
4	Të vetë punësuarit	3,873,577
5	Kontributi suplementar	1,968,328
	Totali I = (1+2+3+4+5)	119,419,349
II	Kontribute kujdes shëndetësor	18,787,612
III	Total kontribute I+II	138,206,961
IV	Të ardhura jo tatimore (shoqërore)	561,156
1	Gjoha sig. Shoqërore	385,458
2	Kamatëvonesa sig. Shoqërore	175,697
	Totali kontribute sig. shoqërore	119,480,504
II	Kontribut kujdes shëndetësor	18,787,612
III	Totali kontribute III= (I+II)	138,206,961

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Për periudhën janar – dhjetor 2023 sipas raportimit nga DPT, të ardhurat e realizuara në skemën e detyrueshme (Sigurime Shoqërore) rezultojnë në total 119,419, 349 mijë lekë ose krahasuar me vitin 2022, ato janë realizuar më shumë në vlerën 17,813,501 mijë lekë ose në masën 17,5% më shumë. Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe marrëdhëniet e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore me Drejtoritë Rajonale Tatimore janë ndërtuar dhe mbështeten në VKM nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”. Bazuar në këto dispozita, këtë vit vijon të zbatohen procedura e bashkëpunimit institucional ndërmjet ISSH-së dhe DPT-së, të mbështetura në Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr.11422, datë 19.05.2017 dhe nr. 4473/1, datë 23.05.2017.

DPT dërgon në ISSH të gjithë të dhënat statistikore dhe të kontributeve të paguara, bazuar në procedurën e komunikimit “on-line”, midis sistemeve informatike, të ngritura nga institucionet.

Tabela nr. 3.16 “Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas rakordimeve”

Në 000/ lekë

Nr.	Përshkrimi	Treguesit sipas DPT	Treguesit sipas ISSH	Treguesit e Buxhetit të Shtetit në Llogarinë e Unifikuar (TSA)	Diferenca
I	Kontribute shoqërore				
1	Sektori Buxhetor	38,679,436	38,678,142		1,294
2	Sektori jo buxhetor	6,732,743	6,732,743		0
3	Sektori Privat	68,165,264	68,165,264		0
4	Të vetë punësuarit	3,873,577	3,873,577		0
5	Kontributi suplementar	1,968,328	1,968,328		0
	Totali	119,419,349	119,418,054	119,418,054	1,294
II	Të ardhura jo tatimore (shoqërore)	561,156	561,156	561,156	0
1	Gjoha sig shoqërore	385,459	385,459	385,459	0
2	Kamatëvonesa sigurime shoqërore	175,697	175,697	175,697	0
	Totali (I+II)	119,980,504	119,979,210	119,979,210	1,294

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Konkluzion: Referuar shkresës së MFE nr. 950/1, datë 25.01.2024 dhe të ISSH nr. 235/1, datë 12.01.2024, “Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga kontributet për sigurimet Shoqërore nga DPT për vitin 2023” midis të dhënave të DPT-së dhe të dhënave të rakorduara midis ISSH me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbi të ardhurat nga kontributet për sigurimet shoqërore, rezulton një diferencë në shumën 1,294,289 në lekë, që është pakësim i të ardhurave në debi të llog.75. Ky sistemim i rakorduar midis ISSH dhe MFE, nuk është i reflektuar në të dhënat e DPT-së. Sipas shpjegimit të dhënë nga MFE, dërguar në adresë elektronike ISSH-së, kjo vlerë nuk i përket të ardhurave nga kontributet për sigurime shoqërore.

Sa më sipër, të ardhurat nga kontributet nga DPT janë në shumën 119,418,054 mijë lekë dhe të ardhura të tjera jo tatimore (gjoha, kamatë vonesa) në shumën 561,156 mijë lekë.

Listë pagesat e formatit elektronik të periudhës 2012 e në vazhdim.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve deri në datë 31.12.2023, për të gjithë periudhën 2012 – 2023 ka dërguar në ISSH, gjithsej 15,173,028 listë pagesa të formatit elektronik që i përkasin periudhës kohore 2012 - 2023. Janë plotësuar gjatë vitit 2023 gjithsej 1,384,460 listëpagesa, krahasuar me vitin 2022, që kanë qenë 12,414,490 listë pagesa.

Tabelë nr. 3.17 Ecuria e transmetimit numrit të Listëpagesave sipas formatit elektronik përgjatë viteve 2012 – 2023

Nr.	Viti	Listëpagesat elektronike deri më 31.12.2023	Listëpagesat elektronike deri më 31.12.2022	Diferenca e Listëpagesave të plotësuara gjatë vitit 2023
1	2012	859,701	713,418	146,283
2	2013	1,040,491	818,318	222,173
3	2014	962,745	909,599	53,146
4	2015	1,196,744	1,098,263	98,481
5	2016	1,390,510	1,267,765	122,745
6	2017	1,343,531	1,236,633	106,898
7	2018	1,358,772	1,257,731	101,041
8	2019	1,365,552	1,259,504	106,048
9	2020	1,395,807	1,267,106	128,701
10	2021	1,432,806	1,298,420	134,386
11	2022	1,452,291	1,287,733	164,558
12	2023	1,374,078		
Gjithsej		15,173,028	12,414,490	1,384,460

Burimi i të dhënave: ISSH Drejtoria e Kontributeve, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga DPT dërgohen listë pagesat për çdo Nipt me të dhënat sipas rubrikave, për çdo subjekt tatimpagues dhe person me numrin e identifikimit dhe shumat e derdhura plotësisht. Pas marrjes zyrtarisht të dhënave përmbledhëse në mënyrë koherente on line të listëpagesave dhe kontributeve të likuiduara i transferon ato në regjistrin elektronik të historikut individual kontributiv, duke i pozicionuar ato në kartelën individuale për çdo kontributpagues.

Pavarësisht bashkëpunimit midis ISSH dhe DPT, referuar Kreut të II-të të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017, sipas raportimit nga ISSH, ende evidentohen problematika në lidhje me transmetimin e listë pagesave, të evidentuara nga ISSH, si:

- Raste të evidentimit të vendosjes gabim të Numrit Personal NID, gjë e cila ka sjellë një problematikë, pasi pavarësisht rregullimit të gabimit pas konstatimit të tij dhe reflektimit për periudhat në vazhdim, ka mbetur problem i pazgjidhur reflektimi për periudhat përpara konstatimit të NID të gabuar, duke mos vërtetuar kështu identitetin e personit për periudhën para konstatimit dhe si rrjedhim edhe të shumë kontributeve përkatësisht sipas periudhave dhe viteve.
- Në sistemin CMIS nuk shfaqen ende listë pagesat e periudhave të personave gjyq fitues.
- Në sistemin CMIS nuk shfaqen muaj të veçantë, për periudhën korrik-gusht 2013 dhe gusht-tetor 2014 për dy subjekte (Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës dhe Fier) dhe individë të ndryshëm, në vite të ndryshme, periudha të cilat ndërkohë shfaqen në sistemin tatimor, problematikë kjo në vazhdim.

Në rastet kur subjektet kryejnë korrigjimin e deklaratës tatimore listë pagesat ESIG-25 në sistemin CMIS nuk shfaqet data kur është kryer korrigjimi, çka krijon probleme të mundshme lidhur me kushtet e përfitimeve afat shkurtra dhe afat gjata.

-Në rastet kur subjektet kryejnë pagesa pjesore dhe për punëmarrës të veçantë, të dhënat e kontributeve të paguara nuk shfaqen në sistemin CMIS.

Listë pagesat e munguara të formatit letër 2006-2012

Në drejtim të administrimit të listëpagesave të subjekteve paguese, Sektori i Marrëdhënieve me Tatimet dhe Administrimit të të Dhënave ka trajtuar problemin e mungesave të listëpagesave, në formatin letër, për periudhat kohore 2006-2012.

Për rajonin e Tiranës nuk ka përfunduar akoma procesi i sistemimit të të dhënave të ardhura nga DPT, lidhur me pagesat e të vetëpunësuarve të vetëm, çka do të thotë se të dhënat e mungesave për listëpagesat e subjekteve fizike në rajonin Tiranë nuk janë të dhëna përfundimtare.

Të dhënat e mungesave të listëpagesave të formatit letër, për periudhën 2006 – 2012, deri në 31.12.2023 paraqiten si më poshtë:

- Listëpagesa të munguara gjithsej 1,482,748, nga këto:
 - 5,977 mungesa në subjektet publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë)
 - 72,830 mungesa në subjektet juridike
 - 1,403,941 mungesa në subjektet e biznesit të vogël, nga të cilat 1,230,687 ose 88% rezultojnë nga biznesi vogël Tiranë.

Të ndara sipas drejtorive rajonale të Sigurimeve Shoqërore, situata e mungesave të listëpagesave, format letër të periudhës 2006-2012, paraqitet, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabelë nr. 3.18. Listëpagesa të munguara të formatit letër, për periudhën 2006-2012, sipas rajoneve, deri në 31.12.2023.

Nr.	RAJONET	Listëpagesa të munguara gjithsej	Nga këto:		
			Listëpagesa të subjekteve publike buxh dhe jobuxhetorë	Listëpagesa – Firma Biznes madh	Listëpagesa – Person Fizik
1	BERAT	543	-	41	502
2	DIBËR	57,709	317	2,798	54,594
3	DURRËS	17,753	367	2,499	14,887
4	ELBASAN	9,645	365	2,203	7,077
5	FIER	13,862	102	3,137	10,623
6	GJIROKASTËR	24,372	817	3,496	20,059
7	KORÇË	6,761	237	1,408	5,116
8	KUKËS	9,615	426	1,792	7,397
9	LEZHË	3,592	53	873	2,603
10	SHKODËR	3,869	214	1,460	2,195
11	TIRANË	1,275,223	2,605	41,931	1,230,687
12	VLORË	59,867	474	11,192	48,201
	SHUMA	1,482,748	5,977	72,830	1,403,941

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Në fund të vitit 2023 rezultojnë gjithsej 1,482,748 listëpagesa të munguara, nga të cilat 1,403,941 ose rreth 95% janë listëpagesa të munguara të të vetëpunësuarve (Biznes i Vogël); 72,830 ose 5% janë listëpagesa të munguara të Biznesit të Madh (Firma private) dhe 5,977 apo 0.4% janë listëpagesa të munguara të subjekteve publike (Buxhetorë dhe Jo Buxhetorë).

Nga grupi i auditimit nuk është marrë evidencë mbi ecurinë e marrjes në dorëzim nga ana e ISSH të listëpagesave të munguara format letër të periudhës para vitit 2006. Mungesa e listëpagesave dhe e arkivimit të tyre përmban në vetvete risqe financiare dhe sociale, pasi në përmbajtje të tyre janë një numër të konsiderueshëm personash, të punësuar në këto subjekte, të cilët nuk mund të përfitojnë njohjen e periudhës kontributive dhe përfitimit nga skema e sigurimeve shoqërore për pensione.

Kontributet e sigurimeve shoqërore të mbledhura nga ISSH

Për realizimin e të ardhurave në përgjegjësi të organeve të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), evidentimin dhe kontabilizimin e tyre, janë të organizuara dhe të ndara:

- Kontribute të vetëpunësuarve në bujqësi
- Kontribute të siguruarve vullnetarë
- Të ardhura dhe kontribute të tjera.

Tabela nr.3.19 “Realizimi i të ardhurave nga ISSH të vitit 2023”

Në 000/ lekë

Nr	Burimi	Plan	Fakt	Diferenca (F/PL)	Realizimi në %
I	Kontribute të vetëpunësuarve në bujqësi shoqërore	2,393,000	2,715,504	322,504	113
II	Kontribute të siguruarve vullnetarë; ska kamate	600,000	711,898	111,898	119
II	Të ardhura nga kamata dhe kontribute të tjera. Bono etj interesa	350,000	1,179,770	829,770	
	Totali (ISSH)	3,343,000	4,607,172	1,264,172	138

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Të ardhurat nga strukturat e sigurimeve shoqërore janë realizuar 4,607,172 mijë lekë, kundrejt 3,343,000 në mijë lekë të planifikuara, pra me tejkalim në shumën 1,264,172 në mijë lekë, ose realizuar në masën 138 % e ndarë në:

- Të ardhurat nga **Të Vetëpunësuarit në Bujqësi** janë realizuar në shumën 2,715,504 mijë lekë nga 2,393,000 mijë lekë të planifikuara, pra me tejkalim në shumën 322,504 mijë lekë ose realizuar në masën 113 %.

- Të ardhurat nga **Sigurimi Shoqëror Vullnetar** janë realizuar në shumën 711,898 mijë lekë, nga 600,000 mijë lekë të planifikuara, pra me tejkalim në shumën 111,898 mijë lekë ose realizuar në masën 119 %.

- Të ardhura nga kamata dhe kontribute **Të Tjera**, janë realizuar në shumën 1,179,770 mijë lekë, nga të cilat: 185,649 mijë lekë janë kamata nga sigurimi i të vetë punësuarve në bujqësi, dhe 994,121 mijë lekë janë të ardhura të tjera që janë realizuar nga Drejtoria e Financës.

Kontributet e të vetë punësuarve në bujqësi

Në zbatim të pikës 4, të kreut V, të VKM nr.77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” dhe të shkresës së ISSH nr.3838, datë 04.05.2015 “Për evidentimin e detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe kamatë vonesave, për personat e vetëpunësuar në bujqësi”, Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore kanë evidentuar, për çdo tremujor, numrin dhe detyrimet e debitorëve, të vetëpunësuar në bujqësi për vitin 2023, të krijuara në zbatim të: I/e vetëpunësuarit/a në bujqësi, që banon në zonat fushore, mbështetur ne VKM nr. 653, date 22.07.2015, duke filluar nga data 01.08.2015 e në vazhdim, duhet të derdhë kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 38,400 lekësh.

Në zonat fushore përfshihen të vetë punësuarit në bujqësi, që banojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në rrethet Berat, Kuçovë, Durrës, Krujë, Elbasan, Peqin, Fier, Lushnjë, Mallakastër, Gjirokastrë, Përmet, Korçë, Pogradec, Devoll, Lezhë, Laç, Shkodër, Tiranë, Kavajë, Vlorë, Sarandë dhe Delvinë. I/e vetëpunësuarit/a në bujqësi, që banon në zonat malore, mbështetur ne VKM nr. 653, datë 22.07.2015, nga data 01.01.2015 e në vazhdim, duhet t’i derdhë kontributet për sigurimet shoqërore, kundrejt detyrimit tremujor, të llogaritur mbi bazën e masës vjetore prej 29,400 lekësh.

Në zonat malore përfshihen të vetë punësuarit në bujqësi, që banojnë dhe ushtrojnë aktivitetin e tyre në Bulqizë, Dibër, Gramsh, Has, Kolonjë, Kukës, Librazhd, Malësi e Madhe, Mat, Mirditë, Pukë, Skrapar, Tepelenë dhe Tropojë.

Tabela nr.3.20 “Realizimi i të ardhurave (sig shoq+ kamata) nga të vetëpunësuarit Në 000/ lekë

Nr.	Rajonet	VITI 2023			
		Plan	Fakt	Në %	Diferenca
	Totali	2,393,000	2,901,153	121	508,153

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Sipas rakordimit të të ardhurave të realizuara dhe rakorduara me DRSSH ka rezultuar se, për vitin 2023, të ardhurat nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi janë realizuar gjithsej në shumën 2,901,153 në mijë lekë, nga 2,393,000 mijë lekë të planifikuara, me një tejkalim në shumën 508,153 në mijë lekë ose në masën 121 % kundrejt planit.

Tabela nr. 3.21 “Realizimi i të ardhurave dhe numrit të kontribuesve për të vetëpunësuarit në bujqësi sipas rajoneve të ISSH” Në 000/ lekë

Nr.	Rajonet	Vlera e kontributeve nga të vetë punësuarit në bujqësi (sig shoq+ kamate)							
		Realizimi (numër/vlerë për vitet 2023/2022)							
		2022		2023		Diferenca		Në %	
		Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
1	Berat	4,020	155,858	5,284	207,698	1,264	51,840	31,4	33,2
2	Dibër	4,622	145,103	5,595	177,593	973	32,490	21	22,3
3	Durrës	3,099	126,947	3,375	139,516	276	12,569	9	9,9
4	Elbasan	8,456	305,435	10,432	379,686	1,976	74,251	23,3	24,3
5	Fier	9,372	380,672	12,382	505,284	3,010	124,612	32	32,7
6	Gjirokastrë	3,479	128,130	3,875	141,778	396	13,648	11,3	10,6
7	Korçë	6,117	238,709	7,486	294,435	1,369	55,726	22,3	23,3
8	Kukës	1,992	62,310	2,399	75,747	407	13,437	20,4	21,5
9	Lezhë	4,064	158,193	4,392	173,043	328	14,850	8	9,3
10	Shkodër	5,446	200,914	6,053	225,861	607	24,947	11	12,4

11	Tiranë	5,002	203,334	6,485	265,865	1,483	62,531	30	30,7
12	Vlorë	6,401	259,351	7,693	314,647	1,292	55,296	25	21,3
	Totali	62,070	2,364,956	75,451	2,901,153	13,381	536,197	22	22,6

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Në vitin 2023 treguesit e planit në nivel rajonal dhe total, janë 1.18 % më shumë se realizimi faktik në vitin 2022 (2,393,000 mijë lekë/plan 2023 dhe 2,364,956 mijë lekë/fakt 2022).

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme, të gjitha rajonet rezultojnë me tejkallim në realizimin e këtyre të ardhurave si në vlerë dhe në numër kontribuesish dhe në total me 121 % realizim, gjë e cila tregon një planifikim me rezervë të këtyre të ardhurave.

Në krahasim me vitin 2022, numri i kontribuesve është rritur me 13,381 persona dhe 536,197 në mijë lekë më shumë.

Në shumën e të ardhurave të realizuara nga të vetë punësuarit në bujqësi përfshihen edhe pagesa për periudha të mëparshme.

Duke u nisur nga kontributi mesatar vjetor për një kontribues në vitin 2022, i cili është 38,100 lekë (2,364,956 mijë/62,070 kontribues) dhe kontributit mesatar për një kontribues të vitit 2023, i cili rezulton 38,450 lekë (2,901,153 mijë/75,451 kontribues), kemi me një rritje të kontributit mesatar/për kontribues në masën 1.01 %, ndërsa numri i kontribuesve është rritur me 22 %.

Sipas këtyre të dhënave rezulton se, rritja e të ardhurave në shumën 536,197,000 lekë, ka ardhur kryesisht nga të ardhurat nga rritja e numrit të kontribuesve për shumën 509,789,150 lekë ose në masën 95% dhe nga rritja e efektit të kontributit mesatar për shumën 26,407,850 lekë ose në masën 5%.

Tabela nr. 3.22 "Ndikimi i treguesve në realizimin e të ardhurave"

Në lekë

Nr.	Numri i kontribuesve 2022	Kontributi mesatar	Të ardhurat
	a	b	c (a*b)
1	75451	38,100 viti 2022	2,874,683,100
2	75451	38,450 Viti 2023	2,901,090,950
	Përlogaritjet (Ndikimi)		
3	Diferenca nga efekti i Δ kontributit		(26,407,850)
4	Rritja e të ardhurave total bujk		536,197,000
5	Të ardhura nga rritja e numrit të kontribuesve		509,789,150

Burimi i të dhënave: ISSH, të përpunuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Të ardhurat e kontributeve nga Sigurimi vullnetar

Nga auditimi i realizimit së të ardhurave nga sigurimi vullnetar për vitin 2023, rezultoi se, të ardhurat të programuara janë realizuar në masën 119 % ose tejkalluar me 111,898 mijë lekë.

Të dhënat për skemën e sigurimit vullnetar, janë regjistruar në programin informatik CMIS për gjithë periudhën 2023. Procedurat janë informatizuar dhe kryhen në kohë reale si pritja e dokumentacionit, përpunimi i të dhënave dhe pajisja e kontribuesve me dokumentet e parashikuara e të kërkuara prej tyre.

Në tabelën e mëposhtme paraqitet realizimi i të ardhurave nga sigurimi vullnetar, sipas DRSSH duke e krahasuar edhe me vitin 2022.

Tabela nr.3.23 "Realizimi i të ardhurave nga kontributet vullnetare sipas rajoneve fakt/plan"

Në 000/ lekë

Nr.	RAJONI	Viti 2023			
		Plan	Fakt	Në %	Diferenca
1	Berat	28,000	32,532	116	4,532
2	Dibër	2,500	2,481	99	(19)
3	Durrës	65,000	76,929	118	11,929
4	Elbasan	37,500	45,434	121	7,934
5	Fier	45,500	54,057	119	8,557
6	Gjirokastër	19,500	19,443	100	(57)
7	Korçe	39,000	46,811	120	7,811
8	Kukës	1,500	2,304	154	804
9	Lezhe	14,000	14,984	107	984
10	Shkodër	29,000	30,510	105	1,510
11	Tirane	260,000	317,192	122	57,192

12	Vlore	58,500	69,221	118	10,721
	Totali	600,000	71,898	119	111,898

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Tabela nr. 3.24. "Realizimi i të ardhurave nga kontributet vullnetare 2023/2022"

Në 000/ lekë

Nr.	Rajonet	2022		2023		Diferenca	
		Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
1	Berat	299	24,925	335	32,532	36	7,607
2	Dibër	17	1,413	25	2,481	8	1,068
3	Durrës	759	62,816	791	76,929	32	14,113
4	Elbasan	322	26,902	465	45,434	143	18,532
5	Fier	503	41,938	556	54,057	53	12,119
6	Gjirokastrë	197	16,511	200	19,443	3	2,932
7	Korçë	485	40,120	483	46,811	(2)	6,691
8	Kukës	14	1,151	24	2,304	10	1,153
9	Lezhë	190	15,891	154	14,984	(36)	(907)
10	Shkodër	260	21,674	310	30,510	50	8,836
11	Tiranë	3,055	252,749	3,307	317,192	252	64,443
12	Vlorë	803	67,269	712	69,221	(91)	1,952
	Totali	6,904	573,359	7,362	711,898	458	138,539

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Të ardhurat e tjera të realizuara në ISSH

Të ardhurat e tjera të realizuara nga ISSH, përfshijnë të ardhurat nga interesat e depozitave në shumën 272,040 mijë lekë, të blerjes së titujve të qeverisë në shumën 457,853 mijë lekë, si dhe të ardhura të tjera jo tatimore, gjithsej 729,893 mijë lekë.

Tabela nr.3.25 "Të ardhura të tjera ISSH"

Në 000/ lekë

Nr.	Përshkrimi	Shuma
1	Të ardhura nga interesat	729,893
2	Të ardhura nga komisione për shërbime	825
3	Të tjera të ardhura	263,403
	Totali	994,121

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Sa më sipër, konstatojmë që peshën më të madhe të ardhurave e zënë të ardhurat nga interesat në masën 73.4% , dhe të ardhurat e tjera në masën 26.6%.

Kontributet nga interesat dhe nga ankandet e titujve:

Politikat e investimit të Fondit Rezervë të Sigurimeve Shoqërore janë bazuar mbi parimin e sigurisë dhe kujdesit. Asetet e këtij fondi janë investuar në instrumente financiar publik të cilët paraqesin siguri dhe kthim të përshtatshëm nga investimi duke ruajtur një raport optimal ndërmjet riskut të marrë përsipër dhe kthimit nga investimi. Politika e investimit të Fondit Rezervë të Sigurimeve Shoqërore ka krijuar një strategji të shpërndarjes së aseteve të fondit duke krijuar një portofol investimesh të përbërë nga tituj shtetërorë të emetuara ose të garantuara nga Banka e Shqipërisë. Portofoli përbëhet nga:

- Bono Thesari me maturitet 3,6 dhe 12 muaj - Obligacione me maturitet 2 dhe 3 vjeçare

Tabela 3.26.: Portofoli i inventarizimit të Fondit Rezervë të ISSH-së, viti 2023

Në 000/lekë

Periudha	Portofoli i investimit / mijë lekë		Totali
	Bono Thesari	Obligacion	
2021	9,527,740	3,200,900	12,728,640
2022	13,662,830	5,700,900	19,363,730
2023	8,593,780	6,652,900	15,246,680

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Për vitin 2023 janë bërë 8 transfertat nga Banka e Shqipërisë për pjesëmarrje në blerjen e titujve të qeverisë, ku është investuar shuma 15,246,680 mijë lekë, duke përfituar një interes neto pas zbritjes së vlerës së tatimit mbi të ardhurat, në shumën 457,853 mijë lekë.

Gjendja e vlerës monetare (cash në Bankën e Shqipërisë) në fund të periudhës 2023 është 4,076,544.26 mijë lekë e konfirmuar sipas të dhënave të bilancit të konsoliduar në llogarinë kontabël 532 "Vlera të tjera", siç është përcaktuar në Rregulloren Financiare të ISSH nr. 5/2008, Kreu II "Fondi

rezervë i Sigurimeve Shoqërore”. Të ardhurat e krijuara nga investimi i ISSH në blerjen e titujve financiarë (bono thesari dhe obligacione) përbëjnë fondin rezervë, i cili në bazë të Rregullores Financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore nr. 5, datë 25.05.2009, Kreu II.

Portofoli i investuar i fondit rezervë ka pësuar ndryshime dhe rritje nga vitit 2015-2022. Ndërsa sa i përket vitit 2023 ky portofol në krahasim me vitin 2022 ka pësuar ndryshim në ulje të tij në total vlerën 4,117,050 mijë lekë.

Megjithatë, niveli i fondit rezervë është në nivelin e shumës së përcaktuar sipas nenin nr. 70 “Fondi rezervë”, të ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, ku përcaktohet: Instituti i Sigurimeve Shoqërore krijon një fond rezervë që të mbulojë të paktën një muaj shpenzimet për pensione.

Titujt e maturuar të investimit gjatë vitin 2023 në vlerën 4,0117,050 mijë lekë nuk janë ri-investuar, por janë transferuar përsëri në llogari të posaçme bankare të Fondit Rezervë për t’u investuar në depozita bankare me afat të shkurtër dhe për t’u përdorur në një moment të dytë sipas destinacionit që përcaktohet nga MFE me shkresë zyrtare.

Në vitin 2024 me shkresë nr. 5158 datë 17.04.2024 “Mbi derdhjen e rezultatit financiar pozitiv të vitit 2023” është përcaktuar që rezultati pozitiv në fund të vitit buxhetor derdhet në të ardhura të buxhetit të shtetit, pra në llogarinë kryesore të Qeverisë. Kjo ka impaktuar në zvogëlim të rezultatit të mbartur të ISSH në vlerën 7,916,259,945 lekë, që sipas Drejtorisë së Financës i përket rezultatit të vitit 2021 shumë 3,502,042,170 lekë miratuar me KA nr. 18, datë 27.12.2022” Për rezultatit të vitit 2021” dhe vitit 2022 në shumën 4,414,217,775 lekë sipas VKA nr. 4 datë 30.06.2023” Për rezultatit të vitit 2022”.

Tendenca e portofolit të investuar në tërësinë e tij ka trend në rritje, e cila ka ardhur si pasojë e rritjes së nivelit të shpenzimeve, e cila rrit detyrimin për plotësimin e fondit rezervë. Gjithashtu kanë ndikuar ndryshimet ndër vite të ligjit të Sigurimeve Shoqërore, dhe si rezultat i indeksimit të përvitshëm pensioneve.

Për sa është trajtuar në lidhje me këtë pikë në PRA, është paraqitur observacioni nr. 263/5 prot, datë 04.09.2024, protokolluar në KLSH me nr. 476/7, datë 06.09.2024, për të cilin japim sqarimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit të audituar:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar sqarojmë se: nuk është pranuar fakti se në realizimin e të ardhurave nga të vetëpunësuarit në bujqësi në shumën 2,901,153 mijë lekë, ka përfshirë të ardhurat nga gjobat në shumën 185,640 mijë lekë. Në rastin konkret “të ardhurat nga gjobat” janë “të ardhura nga kamatëvonesat”, të cilat nuk planifikohen, por realizohen nga kryerjes e pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore jashtë afateve të përcaktuara dhe si të tilla konsiderohet “kontribut shtesë” dhe se Drejtoria e Kontributeve nuk i ka përfshirë asnjëherë të ardhurat nga kamatëvonesat në “të ardhura të tjera”.

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Realizimi i të ardhurave ju referohet të ardhurave të mbledhura nga kontributet duke u referuar dy strukturave mbledhëse të tyre, DPT dhe ISSH, të cilat kanë të bëjnë me të ardhura për Kontribute për Sigurimeve Shoqërore. Të ardhurat e tjera duhet të trajtohen veçmas si të ardhura jo tatimore.

- Kontribute të mbledhura nga vetë ISSH (të vetëpunësuar në bujqësi, vullnetarë dhe të tjera), në total janë paraqitur në shumën 4,638,891 mijë lekë, nga e cila 711,898 mijë lekë janë kontribute vullnetare; shuma 2,715,513 mijë lekë kontribute të vetëpunësuar në bujqësi, shuma 31,719 mijë lekë kontribute të derdhura në llog. e ISSH, si dhe shuma 1,179,761 mijë lekë përbën të ardhura jo nga kontribute për sigurime shoqërore, nga e cila 994,121 mijë lekë të ardhura të tjera dhe 185,640 mijë lekë kamatëvonesë, (sipas evidencës, nga Drejtoria e Kontributeve, të rakordimit të të ardhurave për të vetë punësuarit në bujqësi), ku janë realizuar në total 2,901,153 mijë lekë, nga e cila të ardhura për kontribute në shumën 2,715,153 mijë lekë dhe kamatëvonesa në shumën 185,640 mijë lekë. Shuma 2,715,153 mijë lekë përbën Kontribute për Sigurime Shoqërore nga fermerët (Ilogaria 753) dhe shuma 185,640 mijë lekë përbën të ardhura jo tatimore/kamatëvonesa (Ilogaria 7115500), të paraqitura edhe në Pasqyrat Financiare të vitit 2023. Merret në konsideratë korigjimi tek gjetja nga auditimi që shuma 185,640 mijë lekë e paraqitur si “të ardhurat nga gjobat”, ndërsa duhet të jetë “të ardhura nga

kamatëvonesat”, dhe si e tillë do të pasqyrohet në Raportin Përfundimtar, ndërsa paraqitja si “kontribut shtesë” e të ardhurave nga kamatëvonesat nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Programimi dhe realizimi i shpenzimeve, në nivel ISSH dhe struktura rajonale.

Nga ana e ISSH, financimi i shpenzimeve të buxhetit të sigurimeve shoqërore për vitin 2023 është planifikuar të mbulohet nga kontributet e sigurimeve shoqërore në shumën 124,599 milion lekë dhe nga buxheti të shtetit në shumën 46,727 milion lekë, në total në shumën 171,326 milion lekë. Për shkak se realizimi faktik i shpenzimeve për vitin 2023, është në shumën 170,238 milion lekë, ose 1,088 milion lekë më pak se plani dhe të ardhurat e realizuara janë në shumën 171,345 milion lekë, ose 19 milion lekë më shumë se plani, financimi i shpenzimeve është mbuluar në shumën 124,618 milion lekë nga kontributet dhe 45,620 milion lekë me financim nga buxheti i shtetit, **ose 1,107 milion lekë më pak se planifikimi.**

Tabela nr. 3.27 “Plani dhe fakti i shpenzimeve për vitin 2023”

Në 000/ lekë

Nr.	Shpenzimet	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
I	Transferta për buxhetet familjare e individët	167,775,962	166,940,791	-834,560	100%
1	Shpenzime për përfitime	144,010,027	144,059,900	50,484	100%
2	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	16,207,276	16,107,171	-100,106	99%
3	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,558,659	6,773,720	-784,938	90%
II	Shpenzime administrative	3,550,680	3,297,383	-253,423	93%
	Totali (I+II)	171,326,641	170,238,174	-1,087,983	99%

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme ka rezultuar se gjatë vitit 2023, nuk janë tejkaluar shpenzimet në krahasim me ato të planifikuara. Programi që paraqet më shumë mos realizim është “Shpenzime për programe e skema suplementare” në vlerën 784,938 mijë lekë, nëse e krahasojmë me vitin 2022 që është në vlerën 6,725,441 mijë lekë rezulton që realizimi në fakt në vitin 2023 paraqitet në të njëjtat nivele, çka tregon se programimi i tyre nga Drejtoria e Financës nuk është bazuar në nivelin faktik të tyre. Po ashtu, edhe zëri “Shpenzime administrative” paraqitet me mos realizim shpenzimesh në vlerën 253,423 mijë lekë, krahasuar me faktin e vitit 2022 që është në vlerën 2,824,916 mijë lekë ka rritje në vlerë 472,467 mijë lekë, e cila është ndikuar nga rritja e pagave të personelit të ISSH.

Tabela nr.3.28 “Plan/fakt shpenzime sipas MFE & ISSH”

Në milionë lekë

Nr.	Përshkrimi	MFE		ISSH		Diferenca	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
I	Gjithsej	167,315	170,237	171,326	170,237	4,011	0
1	Të ardhura nga kontributet			124,599			
2	Financimi i buxhetit			46,727			
II	Diferenca sipas vendimeve					4,011	
1	VKM 187 dt 31.03.20223					3,536.74	
	VKM nr. 553, datë 28.09.2023(AN 3,200mln-VKM 3.184mln)					-16	
4	VKM 819, dt 28.12.2023					490.5	

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Përsa i përket planit, midis dy institucioneve ka një mos rakordim në shumën **4,011 milion lekë**, shtesa në buxhet me VKM jashtë ligjit të buxhetit, dhe nga fondet buxhetore të ISSH-së. Sipas të dhënave të ISSH, referuar gjithë akteve ligjore dhe nënligjore mbi alokimin e fondeve, plani i shpenzimeve është në shumën 171,326 milion lekë referuar AN dhe VKM-ve, ndërsa nga MFE është raportuar në shumën 167,315 milion lekë.

Përsa i përket faktit të shpenzimet të paraqitura nga ISSH, janë të rakorduara me të dhënat e MFE, referuar tabelës “Treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit”, Kapitulli I.5 Shpenzimet për shumën 170,328 milion lekë dhe të Pasqyrave Financiare të ISSH për vitin 2023.

Konkluzion: Nga rakordimi i të dhënave planin dhe faktin e shpenzimeve për ISSH, në raport me treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, Kapitulli I.5 Shpenzimet, të raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është evidentuar se: Planin i shpenzimeve nga MFE është

raportuar më pak për 4,011 milion lekë. ISSH ka rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë për fondet e alokuara nga buxheti i shtetit në shumën 46,727 milionë lekë, për periudhën 12 mujore të vitit 2023.

Tabela nr.3.29 "Realizimi i shpenzimeve analitike, viti 2023".

Në 000/ lekë

	SHPENZIMET	Plan	Fakt	Diferenca	%
A	Transferta për buxhetet familjare e individët (I+II+III)	167,775,962	166,940,791	-835,171	100%
I	Shpenzime për përfitime	144,010,027	144,059,900	49,873	100%
1	Kompensim për paaftesi të perkohshme për shkak të semundjes	589,611	684,730	95,119	116%
2	Kompensim për leje lindje	281,545	299,655	18,109	106%
	Barre lindje qytet	3,600,738	4,161,843	561,105	116%
	Barre lindje fshat	475,453	426,491	-48,962	90%
3	Totali shpenzimeve për pensione	139,039,624	138,464,123	-575,501	2
	Pensione qyteti	126,367,490	125,889,280	-478,210	100%
	Pensione fshati	12,672,134	12,574,844	-97,291	99%
4	Kompensim për paaftesi t. Për shkak të demtimit në punë	23,055	23,058	2	100%
II	Shpenzime për programe të vecanta shtetërore	16,207,276	16,107,171	-100,106	99%
1	Kompensim supl. Për çmimet për pensionistët	15,806,853	15,652,834	-154,018	99%
	Kompensim supl. Për çmimet për pensionistët qytet	14,980,723	14,889,267	-91,456	99%
	Kompensim supl. Për çmimet për pensionistët fshat	826,130	763,567	-62,563	92%
2	Pensione të vecanta shtetërore	91,827	179,839	88,012	196%
3	Pensione sociale (ishtje-kompensim për ish të persekutuariat)	227,248	187,633	-39,615	83%
4	Kompensim për veteranët e luftës	48,051	40,458	-7,593	84%
5	Kompensim suplementar për çmimin e karburantit	33,297	46,407	13,110	139%
III	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,558,659	6,773,720	-784,938	90%
1	Sigurim suplementar për ish-ushtarakët	3,831,659	4,006,898	175,239	105%
2	Përfitime për policinë e shtetit		18,910	18,910	
3	Trajtime të vecanta për pilotët	98,398	78,151	-20,247	79%
4	Përfitime për ushtarakët e nendetjeve në pension.	12,590	12,492	-99	99%
5	Shpenzime për statusin e deshmor i atdheut	27,306	34,986	7,681	128%
6	Trajtime të vecanta për punonjësit e industrisë ushtarake	74,921	69,814	-5,106	93%
7	Transferta të tjera tek individët (shpenzime për statusin e profesorit)	231,676	215,155	-16,521	93%
8	Sigurim suplementar shtetëror për ish funksionarët	1,156,324	1,001,051	-155,273	87%
9	Pagesa të parakohshme për minatorët	1,244,649	600,043	-644,606	48%
10	Pagesa të parakohshme për naftëtarin	559,474	510,612	-48,862	91%
11	Pagesa të parakohshme për metalurgun	101,970	75,337	-26,633	74%
12	Transferta të tjera tek individët (shpenzime funerali)	219,691	150,272	-69,420	68%
B	Shpenzime administrative	3,550,680	3,297,383	-253,296	93%
1	Paga, shpërblime, dhe shpenz. tjera personeli	1,451,639	1,427,645	-23,994	98%
2	Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore	241,504	241,505	241,506	94%
3	Mallra dhe shërbime të tjera	1,434,537	1,307,216	-127,321	91%
4	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qendrueshme të trupezuara	423,000	423,001	423,002	79%
	Totali (A+B)	171,326,641	170,238,174	-1,088,467	99%
C	Rezultati fiskal (Fakt-Plan)		1,107,162		
D	Financimi i planifikuar dhe terhequr	46,727,235	46,727,235	0	100%
E	Financimi i nevojshëm (D-C)		45,620,073		

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Analizë e treguesve të realizimit të shpenzimeve:

Transfertat në buxhetet familjare janë planifikuar në shumën 167,776 milion lekë dhe zënë 98 % të totalit të shpenzimeve. Realizimi i tyre në vitin 2023 është në masën 99.5 % kundrejt planit dhe për të tre programet, ndahet si më poshtë:

Shpenzimet për përfitime janë planifikuar në shumën 144,010 milionë lekë dhe zënë 86 % të totalit të transfertave në buxhetet familjare. Realizimi i tij në vitin 2023, është në shumën 144,060 milion lekë, ose në masën 99.5 % kundrejt planit. Sigurimi i detyrueshëm financohet nga kontributet e drejtpërdrejta të personave juridik dhe fizik që parashikohen si dhe nga financimet e shtetit për ushtarakët, asistentët e paraplegjikëve, diferenca e kontributit të fermerëve, periudha e njohur e sigurimit për gratë që kanë kryer shkollën e lartë, si dhe nga financimet për mbulimin e deficitit të degës së pensioneëve.

Shpenzimet për programet e vecanta shtetërore, janë planifikuar në shumën 16,207 milion lekë dhe zënë 9.6 % të totalit të transfertave në buxhetet familjare. Realizimi i tyre në vitin 2023 paraqitet në shumën 16,107 milion lekë, ose në masën 99 % kundrejt planit. Financimi i tyre kryhet nga buxheti i shtetit.

Sigurimi suplementar dhe trajtimet e vecanta janë planifikuar në shumën 7,559 milion lekë dhe zënë 4.5 % të totalit të transfertave në buxhetet familjare. Shpenzimet për skemat suplementare

përgjithësisht financohen nga buxheti i shtetit dhe një pjesë e tyre nga kontributet suplementare të punonjësve të lartë të shtetit, personave që kryejnë funksione kushtetuese, ushtarakët, policia dhe struktura të tjera në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Shpenzimet administrative, janë planifikuar në shumën 3,551 milion lekë dhe zë 2 % të totalit të shpenzimeve të ISSH. Realizimi i tyre paraqitet në shumën 3.297 milion lekë ose në masën 93. % kundrejt planit.

Detajimi i realizimit të shpenzimeve për përfitime, në vitin 2023 paraqitet më poshtë:

Tabela nr.3.30 Realizimi i shpenzimeve për përfitime

Në 000/ lekë

Nr.	Përshkrimi	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
I	Shpenzime per perfitime	144,010,027	144,059,900	49,873	100%
1	Kompensim per paaftesi te perkohshme per shkak te semundjes	589,611	684,730	95,119	116%
2	Kompensim per leje lindje	281,545	299,655	18,109	106%
	Barre lindje qytet	3,600,738	4,161,843	561,105	116%
	Barre lindje fshat	475,453	426,491	-48,962	89,7%
3	Totali shpenzimeve per pensione	139,039,624	138,464,123	-575,501	99,6%
	Pensione qyteti	126,367,490	125,889,280	-478,210	99,6%
	Pensione fshati	12,672,134	12,574,844	-97,291	99,2%
4	Kompensim per paaftesi t. Per shkak te demtimit ne pune	23,055	23,058	2	100%

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Administrimi i Përfitimeve dhe Transfertave në Buxhetet Familjeve (shpenzimet për përfitime) për vitin 2023, konsiston në pagesa për pensione, sëmundje, barrë lindje, aksidente, programeve të veçanta të qeverisë etj. Administrimi i buxhetit dhe mbajtja e shpenzimeve në limitet e programuara ka qenë një nga detyrat e punës së administratës së ISSH. Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se brenda zërave të shpenzimeve për përfitime kemi tejkalim të planit për shpenzime për kompensim për paaftesi të përkohshme për shkak të sëmundjes me 16 % më shumë se plani dhe të shpenzimeve për barrë lindje në qytet me 6 % më shumë se plani, ndërsa shpenzimet për pensione të cilat zënë dhe peshën specifike më të lartë kundrejt totalit të shpenzimeve për përfitime, janë realizuar në masën 99.6 % ose gati 100% kundrejt planit.

Administrimi i shpenzimeve për përfitime në vitin 2023 është realizuar në masën 100 %.

Tabela nr. 3.31 Realizimi i shpenzimeve për programet e veçanta

Në 000/ lekë

Nr.	Përshkrimi	Plani	Fakti	Diferenca	Në %
II	Shpenzime per programe te vecanta shtetore	16,207,276	16,107,171	-100,106	99%
1	Kompensim supl. Per çmimet per pensionistet	15,806,853	15,652,834	-154,018	99%
	Kompensim supl. Për çmimet per pensionistet qytet	14,980,723	14,889,267	-91,456	99%
	Kompensim supl. Për çmimet per pensionistet fshat	826,130	763,567	-62,563	92%
2	Pensione të vecanta shtetërore	91,827	179,839	88,012	196%
3	Pensione sociale (ishte-kompensim për ish të persekutuarit)	227,248	187,633	-39,615	83%
4	Kompensim për veteranët e luftës	48,051	40,458	-7,593	84%
5	Kompensim suplementar për çmimin e karburantit	33,297	46,407	13,110	139%

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se brenda zërave të shpenzimeve për programe të veçanta kemi tejkalim të planit për shpenzime për pensione të posaçme shtetërore me 96 % si rezultat i zbatimit të VKM-së nr. 374, datë 21.06.2023 “Për një ndryshim në Vendimin nr.429, datë 12.09.2002 të Këshillit të Ministrave, “Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore”, të ndryshuar, efekti financiar i së cilës përballohet nga buxheti i sigurimeve shoqërore, të miratuar të vitit 2023. Gjithashtu zëri për kompensim suplementar për çmimin e karburantit, rezulton 39% më shumë se plani, ndërsa gjithë treguesit e tjerë janë nën shpenzimet e planifikuara. Një ndikim të konsiderueshëm në uljen e shpenzimeve ka patur zëri “Kompensim suplementar për çmimet për pensionistët në qytet, në shumën 91,456 mijë lekë më pak. Administrimi i shpenzimeve për programe të veçanta në vitin 2023 është realizuar në masën 99 %.

Tabela nr. 3.32 Realizimi i shpenzimeve për skemën suplementare.

Në 000/ lekë

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nr.	Përshkrimi	Plani	Fakti	Diferenca	Në %
III	Shpenzime per programe e skema suplementare	7,558,659	6,773,720	-784,938	90%
1	Sigurim suplementar per ish-ushtaraket	3,794,650	4,006,898	212,248	106%
2	Perfitime per policine e shtetit	37,009	18,910	-18,099	51%
3	Trajtime te vecanta per pilotet	98,398	78,151	-20,247	79%
4	Perfitime per ushtaraket e nendetseve ne pension.	12,590	12,492	-99	99%
5	Shpenzime per statusin e deshmor i atdheut	27,306	34,986	7,681	128%
6	Trajtime te vecanta per punonjesit e industrise ushtarake	74,921	69,814	-5,106	93%
7	Transferta te tjera tek individet (shpenzime per statusin e profesorit)	231,676	215,155	-16,521	93%
8	Sigurim suplementar shtetror per ish funksionaret	1,156,324	1,001,051	-155,273	87%
9	Pagesa te parakohshme per minaret	1,244,649	600,043	-644,606	48%
10	Pagesa te parakohshme per naftetarin	559,474	510,612	-48,862	91%
11	Pagesa te parakohshme per metalurgun	101,970	75,337	-26,633	74%
12	Transferta te tjera tek individet (shpenzime funerali)	219,691	150,272	-69,420	68%
	Shpenzime administrative	3,550,680	3,297,383	-253,296	93%

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se shpenzimet për këtë kategori janë realizuar në masën 90 % kundrejt planit, ose në shumën 784,938 mijë lekë më pak. Brenda zërave të shpenzimeve për programe e skema suplementare në të gjithë zërat me peshë specifike më të lartë kundrejt totali nuk kemi tejkalim të shpenzimeve. Në këtë kategori të shpenzimeve rezultojnë me tejkalim zëri “Sigurimi suplementar për ish ushtarakët” me 5 % dhe “shpenzime për statusin dëshmor i atdheut”, me 2.8 %. Administrimi i shpenzimeve për programe e skema suplementare në vitin 2023 është realizuar në masën 90 %.

Rezultati fiskal vjetor, deficitit dhe mbulimi i tij:

A. Rezultati fiskal vjetor

Politikat buxhetore të sistemit të sigurimit shoqëror zbatohen nëpërmjet 3 (tre) programeve kryesore: “Sigurimi Shoqëror i Detyrueshëm” që zë 84.6 % të fondit të përgjithshëm, “Sigurimi Suplementar” zë 4% dhe “Programet Kompensuese të Shtetit dhe Trajtimet e Veçanta” që zë 9.4% të fondit të përgjithshëm të sigurimit shoqëror, i cili për vitin 2023 ishte 170,238 milion lekë. Në nenin nr. 4 të aktit normativ nr. 5, datë 18.10.2023 “Për disa ndryshime në ligjin nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar përcaktohet: “Për vitin 2023, teprica ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas degëve të sigurimit shoqëror dhe programeve të tjera të veçanta e suplementare, përdoret për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve”.

Rezultati fiskal vjetor përlllogaritet si diferencë midis të ardhurave faktike dhe shpenzimeve faktike dhe për vitin 2023 rezulton në shumën 1,107,162 mijë lekë. Rezultati fiskal për vitin 2023, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 3.33: Të ardhura dhe shpenzime, viti 2023

Në 000/ lekë

Nr.	Emërtimi	Gjithsej		Diferenca	Realizimi në %
		Plan	Fakt		
I.	Të ardhurat	124,599,000	124,618,101	19,101	100%
1	DPT të ardhura	121,256,000	119,979,210	(1,276,790)	99%
2	ISSH kontribute të tjera		31,719	31,719	
3	ISSH të ardhura	3,343,000	4,607,172	1,264,172	138%
II.	Financime nga buxheti	46,727,235	46,727,235	-	100%
III.	Totali të ardhurave (I+II)	171,326,235	171,345,336	19,101	100%
	Shpenzimet				
I.	Transferta për buxhetet familjare e individët	167,775,962	166,940,791	(835,171)	100%
1	Shpenzime për përfitime	144,010,027	144,059,900	49,873	100%
2	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	16,207,276	16,107,171	(100,106)	99%
3	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,558,659	6,773,720	(784,938)	90%
II.	Shpenzime administrative	3,550,680	3,297,383	(253,296)	93%
III.	Totali i Shpenzimeve (I+II)	171,326,641	170,238,174	(1,088,467)	99%
	Rezultati fiskal		1,107,162		
F	Financimi i nevojshem (E-D)		45,620,073		

Burimi i të dhënave: ISSH. të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga tabela e mësipërme konstatojmë se, nevojat për financimin e shpenzimeve të vitit, janë ulur në vlerën 1,088 milion lekë. Gjatë vitit 2023 nuk ka rezultuar tejkalim i shpenzimeve sipas programeve, dhe se në total ato paraqiten me një realizim në masën 99 %.

Gjithashtu gjatë vitit 2023, kemi tejkalim të realizimit të të ardhurave nga kontributet, të cilat ishin planifikuar në shumën 124,599 milion lekë dhe u realizuan në shumën 124,618 milion lekë, me një tejkalim në shumën 19 milion lekë më shumë.

Konkluzion: Tejkalmi i realizimit i të ardhurave në shumën 19 milion lekë dhe mosrealizimi i shpenzimeve në shumën 1,088 milion lekë, japin rezultatin fiskal të sistemit për vitin 2023 në shumën 1,107 milion lekë.

Sipas të dhënave dhe analizave të Drejtorisë së Financës nga rezultati financiar i vitit 2023, vlera prej 757,214,912.34 lekë do të shkojë për plotësim të normativës së fondit rezervë. Miratimi i normativës së fondit rezervë në fund të vitit 2023 është në vlerën 14,059,078,373.43 lekë, bazuar në nenin 70 të ligjit 7703 datë 11.05.1993, i ndryshuar me ligjin 1014/2014, datë 31.07.2024 për mbulimin e pagesave për përfitime të paktën një muaj. Përcaktimi i normativës është përlogaritur nga realizimi faktik i shpenzimeve të vitit 2023. Megjithatë, destinacioni i rezultatit nuk është miratuar ende, pasi nuk është mbledhur KA.

B. Deficiti i sigurimit të detyrueshëm dhe degës së pensioneve për vitin 2023.

Bazuar në raportet financiare të ISSH-së për vitin 2023, kontributet e drejtpërdrejta në total paraqiten si më poshtë:

Tabelë nr.3.34 Të ardhura për kontributeve dhe të tjera

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Gjithsej		Diferenca	Realizimi në %
		Plan	Fakt		
I.	Të ardhurat	124,599,000	124,618,101	19,101	100%
1	DPT të ardhura	121,256,000	119,979,210	(1,276,790)	99%
2	ISSH kontribute të tjera		31,719	31,719	
3	ISSH të ardhura	3,343,000	4,607,172	1,264,172	138%

Burimi i të dhënave: ISSH, të punuara nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga shqyrtimi i të dhënave rezulton se të ardhurat e drejtpërdrejta janë realizuar në masën 100%. Bazuar në raportin më sipër dhe në normën e kontributeve sipas degëve të sigurimit, kontributi për degën e pensioneve dhe degët e tjera, për vitin 2023, paraqitet si më poshtë:

Kontributet sipas skemave, viti 2023

000/lekë

	Norma %	Sëmundje 0.3	Barrë lindje 1.4	Pensione 21.6	Aksidente 0.3	Papunësi 0.9	Pens Supl
A Sigurimi Shoqëror	122,649,773	1,391,117	6,892,953	108,801,236	1,391,117	4,173,350	
buxhetorë	38,678,142	473,610	2,210,180	34,099,913	473,610	1,420,830	
jobuxhetorë	6,764,462	82,830	386,541	5,963,770	82,830	248,490	
firma	68,165,264	834,677	3,895,158	60,096,723	834,677	2,504,030	
individë	3,873,577		235,783	3,637,794			
të ardhura të tjera	1,740,926			1,740,926			
të siguruar vullnetarisht	711,898			711,898			
të vetëpunësuar në bujqësi	2,715,504		165,292	2,550,213			
B Kontribute të Buxhetit të Shtetit	4,771,702	0	240,413	4,531,290	0	0	
për të papunët	919,632		55,978	863,654			
për ushtarakët në reformë	201,608		12,272	189,336			
për policët në reformë	122,062		7,430	114,633			
për ish funksionarët	27,118			27,118			
për ushtarakët në reformë të pensioneve të parakoshme	2,682,101		163,258	2,518,843			
gra të pensionuara në vitin planifikues	794,946			794,946			
punonjësit e industrisë ushtarake dhe minierave	24,235		1,475	22,760			
C Diferencë kontributi për të vetëpunësuarit në bujqësi	5,298,966		322,546	4,976,420			
Totali i të Ardhurave për Sigurimin e Detyrueshëm	132,720,441	1,391,117	7,455,911	118,308,946	1,391,117	4,173,350	
E Kontribute për sigurimin Suplementar	1,968,328						1,968,328
TOTALI	134,688,769	1,391,117	7,455,911	118,308,946	1,391,117	4,173,350	1,968,328

Bazuar në nenin 8 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), periudhë e mbrojtjes nga sigurimet shoqërore për efekt të pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe të pensionit familjar është edhe periudha kur personi përfiton të ardhura nga sigurimet shoqërore për shkak të sëmundjes, barrë lindjes, aksidentit në punë ose sëmundjeve profesionale dhe për papunësinë. Mbi bazën e kontributeve të paguara, Sigurimi Shoqëror i Detyrueshëm jep përfitime për 5 degë: sëmundje, barrë lindje, pensione (pleqërie, invaliditeti dhe familjare) dhe aksidente në punë e sëmundje profesionale, si dhe papunësia, e cila jepet nëpërmjet Shërbimit Kombëtar të Punës. Për arsye se buxheti i sigurimeve shoqërore subvencionohet nga buxheti i shtetit, për deficitin e planifikuar të degës së pensioneve, kontributi i mbledhur për sigurimin e papunësisë mbetet në buxhetin e ISSH, ndërkohë shpenzimet për përfitimet e papunësisë financohen nga buxheti dhe disbursohen për shërbimin kombëtar të punës.

Në nenin 9 të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 (i ndryshuar) “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet: Buxheti i Shtetit paguan kontribute për kategori të veçanta personash, përcaktuar me ligje dhe VKM, duke bërë të mundur që kjo periudhë për këta persona të quhet periudhë sigurimi. Këtu përfshihen shtetasit të papunët në pagesë papunësie, personat në pagesë kalimtare, ushtarakët në reformë, punonjësit e nëntokës, punonjësit e industrisë ushtarake, gratë që dalin në pension në vitin respektiv, personat që u shërbejnë paraplegjikëve etj. Gjithashtu, Buxheti i Shtetit paguan diferencë për kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi (të cilët nga ana e tyre paguajnë më pak se të vetëpunësuarit e tjerë, në kuota fikse të përcaktuara me VKM çdo vit), me qëllim që kontributi i tyre të plotësohet deri tek kontributi minimal që paguan çdo i vetëpunësuar në qytet, aktualisht, bazuar në VKM nr. 77, datë 28.1.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor” i ndryshuar. Kontributet me destinacion transferohen në buxhetin e sigurimeve shoqërore nga buxheti i shtetit, si program i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe disbursohen çdo muaj nga dega e thesarit Tiranë. Ato evidentohen në raportin mujor dhe progresiv të ISSH dhe në bilancin financiar.

Të dhënat për numrin e kontribuesve nxirren nga evidenca e përfituesve nga këto programe dhe janë të evidentuara në raportin statistikor përmbledhës sipas raporteve dhe përfituesve të evidentuar në çdo njësi rajonale.

Rezultati financiar i skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror.

1) Shpenzimet sipas degëve të sigurimit dhe aktiviteteve të skemës së detyrueshme, si një skemë e cila principalisht duhet të mbulohet me kontribute.

Llogaritjet analitike e deficitit të skemës së sigurimit të detyrueshëm shoqëror dhe në veçanti të skemës së pensioneve të ndara qytet fshat, do të evidentohen në vijim.

B.1 Skema e qytetit

Kontributet në total, kontributet sipas degëve të sigurimit dhe shpenzimet për skemën e sigurimit të detyrueshëm të qytetit paraqiten në tre tabelat në vijim:

Tabelë nr. 3.35: Kontributet në total

Në 000/lekë

Emertimi	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023-2022
I. Kontribute të personave juridikë dhe fizikë	88,042,357	98,228,246	115,760,918	17,532,672
II. Kontribute me destinacion nga buxheti i shtetit	4,925,957	4,411,815	4,771,702	359,887
Gjithsej	92,968,314	102,640,062	120,532,620	17,892,558

Burimi i të dhënave: Drejtoria Financës ISSH, punuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Tabelë nr. 3.35.1: Kontributet në total, sipas degëve të sigurimit
000/lekë

Në

Emertimi	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023-2022
Kontribute sipas degëve	92,968,314	102,640,062	120,532,620	17,892,558
Sëmundje	1,059,780	1,182,837	1,391,117	208,280
barrë lindje qytet	5,370,617	5,948,819	6,968,074	1,019,255
pensione qytet	85,478,138	94,325,569	110,782,313	16,456,744

Aksidente	1,059,780	1,182,837	1,391,117	208,280
Papunësi	3,179,339	3,548,511	4,173,350	624,839
Totali	89,788,975	99,091,551	116,359,270	17,267,719

Burimi i të dhënave: Drejtoria Financës ISSH, punuar nga Grupi auditimit KLSH

Në total kontributet e skemës së qytetit për vitin 2023 rezultojnë 120,533 milion lekë, por të destinuar për mbulimin e shpenzimeve sipas degëve janë 116,359 milion lekë, pasi përjashtohen kontributet e degës së papunësisë për të cilat nuk programohen kontributet, por vetëm realizohen pagesa. Kontributet në total në vitin 2023 janë rritur me 17,268 milion lekë, ose 17,4 % krahasuar me vitin 2022.

Tabelë nr. 3.35.2: Shpenzimet në total, sipas degëve të sigurimit Në 000/lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023-2022
Shpenzime sipas degëve	114,808,670	120,901,769	133,618,806	12,717,037
Sëmundje	537,465	599,829	698,255	98,426
barrë lindje qytet	3,469,130	3,922,930	4,521,217	598,287
pensione qytet	110,781,766	116,355,362	128,375,821	12,020,459
Aksidente	20,308	23,649	23,513	-136

Burimi i të dhënave: Drejtoria Financës ISSH, punuar nga Grupi auditimit KLSH

Shpenzimet në total për degët e sigurimit të detyrueshëm në vitin 2023 janë rritur me 12,717 milion lekë, ose 10.5% krahasuar me vitin 2022.

Tabelë nr. 3.35.3 Deficiti i Degës së pensione qytet Në 000/lekë

Vitet/Degët	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023-
Rezultati financiar sipas degëve	-21,840,356	-18,261,708	-13,086,185	5,175,523
Sëmundje	0	0	0	0
Barrë lindje qytet	0	0	0	0
Pensione qytet	-21,840,356	-18,261,708	-13,086,185	5,175,523
Aksidente	0	0	0	0
Deficiti Qytet/GDP	-1,18	-0.85	-0.57	0.28

Burimi i të dhënave: Drejtoria Financës ISSH, punuar nga Grupi auditimit KLSH

Në lidhje me skemën e qytetit, sa më sipër rezulton se:

Deficiti i skemës së qytetit për vitin 2023 paraqitet në shumën 13 miliard lekë nga 18 miliard lekë që ishte në vitin 2022, pra është ulur në shumën 5,175,523 mijë lekë ose me 0.28% ndaj PBB.

B. 2. Skema e fshatit

Tabelë nr.3.36.1: Kontributet total sipas degëve të sigurimit 000/lekë

Emërtimi	2021	2022	2,023	Ndryshimi 2023-2022
Kontribute per fshatin	4,365,274	5,510,392	8,014,470	2,504,078
Barrë lindje fshat	265,712	335,415	487,837	152,422
Pensione fshat	4,099,562	5,174,977	7,526,633	2,351,656

Burimi i të dhënave: Drejtoria Financës ISSH, punuar nga Grupi auditimit KLSH

Tabelë nr.3.36.2: Shpenzimet sipas degëve të sigurimit 000/lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023-2022
Shpenzime për fshatin	13,408,530	13,287,475	13,286,538	(937)
Barrë lindje fshat	736,549	600,237	463,319	(136,918)
Pensione fshat	12,671,981	12,687,237	12,823,220	135,983

Burimi i të dhënave: Drejtoria Financës ISSH, punuar nga Grupi auditimit KLSH

Tabelë nr. 3.36.3: Bilanci i Skemës së fshatit 000/lekë

Bilanci Fshatit	2021	2022	2,023	Ndryshimi 2023-2022
Barrë lindje fshat	-470,836	-264,822	24,519	289,341
Pensione fshat	-8,572,419	-7,512,260	-5,296,587	2,215,673
Deficiti i fshatit	-9,043,256	-7,777,082	-5,296,587	2,480,495
Deficiti si % ndaj PBB	-0.49	-0.36	-0.23	0.13

Burimi i të dhënave: Drejtoria Financës ISSH, punuar nga Grupi auditimit KLSH

Në lidhje me skemën e fshatit, sa më sipër rezulton se:

Deficiti i skemës së fshatit për vitin 2023 paraqitet në shumën 5,3 miliard lekë nga 7,5 miliard lekë që ishte në vitin 2022, pra është ulur në shumën 2,5 miliard lekë ose me 0.13% ndaj PBB.

- Krahas degës së pensioneve, mjaft me rëndësi është përmirësimi dhe balancimi i degës së barrë lindjes në fshat, e cila rezultoi me fitim 24,5 milion lekë. Kjo është pasojë e rritjes së financimit të shtetit për shkak të rritjes së pagës minimale, kufiri nga i cili subvencionon të vetëpunësuarit në fshat.
- Në vite deficiti i skemës së pensioneve të fshatit ka ardhur duke u ulur, dhe se për vitin 2023 kjo ulje rezultoi 0.13% ndaj PBB.

Tabelë nr. 3.37 Deficiti në total për të dy skemat, qytet dhe fshat 000/lekë

Emërtimi	2021	2022	2023	Ndryshimi 2023-
PBB (në milionë lekë)	1,856,200	2,138,300	2,311,700	173,400
Deficiti i PENSIONEVE në qytet në mijë lekë	-21,840,356	-18,261,708	-13,086,185	5,175,523
Në % ndaj PBB	-1.18	-0.85	-0.57	0.13
Deficiti i PENSIONEVE në fshat në mijë lekë	-9,043,256	-7,777,082	-5,272,068	2,505,014
Në % ndaj PBB	-0.49	-0.36	-0.23	0
Deficiti gjithsej i SKEMËS SË DETYRUESHME	-30,883,612	-26,038,790	-18,358,253	7,680,537
Në % ndaj PBB	-1.66	-1.22	-0.79	0.43

Burimi i të dhënave: Drejtoria Financës ISSH, punuar nga Grupi auditimit KLSH

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme rezultoi se të ardhurat nga kontributet nuk kanë qenë të mjaftueshme për mbulimin e shpenzimeve të skemës së pensioneve qytet dhe fshat, duke pasur deficit të vazhdueshëm në vijim.

Deficiti financiar i sistemit, pavarësisht rezultatit vjetor dhe mbulimit të planifikuar të tij, rezultoi të jetë 18,358 milion lekë ose 0.79% i PBB, duke reflektuar një përmirësim të ndjeshëm të rezultatit financiar të sistemit. I rëndësishëm dhe me efekt është edhe **reduktimi i deficitit në vlerë, ku nga 26,038 milion lekë në vitin 2022, ka zbritur për këtë vit në 18,358 milion lekë, me një përmirësim prej 7,680.5 milion lekë ose 0,43% të PBB.** Përmirësimi i ndjeshëm i deficitit për vitin 2023 ka qenë si rezultat i rritjes së të ardhurave për shkak të rritjes së pagave mesatare, si dhe i rritjes së numrit të kontribuesve. Me gjithë përmirësimet në rezultatit e vitit 2023, skema mbetet deficiente dhe kërkon nevojën për reformim dhe rregullim të mëtejshëm.

Detyrimet e papaguara.

A. Detyrimet e papaguara për subjektet në përgjegjësi të DPT.

Një subjekt identifikohet si debitor nga mospagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore në momentin *kur* pagesa e kryer është më e vogël në vlerë se vlera e përcaktuar në Deklaratën e Listëpagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe të ardhurave nga TAP, ku afati ligjor i pagesës së tyre është data 20 e muajit pasardhës. Nga analiza e të dhënave të debitorëve rezultoi se trendi i mospagesës së detyrimeve për kontribute të sig. shoq. është në rritje si në numër dhe në vlerë. Vlera, lloji i detyrimit dhe numri i subjekteve që rezultojnë debitorë ndaj sigurimeve shoqërore sipas të dhënave nga drejtoria e kontributeve datë 26.01.2024, paraqitet në vijim.

Tabela nr.3.38: Gjendja e debitorëve që ndiqen nga DPT, sipas sektorëve Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2022		Viti 2023		Diferenca 2022/2023	
		Numër	Debia	Numër	Debia	Numër	Debia
I	Sektori publik	668	772,684,988	823	794,665,260	155	21,980,272
1	Buxhetorë	370	382,592,470	511	410,906,855	141	28,314,385
2	Jo buxhetorë	298	390,092,518	312	383,758,405	14	6,334,113
II	Sektori privat	108,442	16,355,848,628	109,306	17,661,585,774	864	1,305,737,146
1	Biznes i madh	26,669	9,930,047,677	26,854	10,680,249,131	185	750,201,454
2	Biznes i vogël	81,773	6,425,800,951	82,452	6,981,336,643	679	555,535,692
III	Totali (I+II)	109,110	17,128,533,616	110,129	18,456,251,034	1,019	1,327,717,418

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Kontributeve ISSH, punuar nga Grupi auditimit KLSH

Tabela nr.3.39. Detyrimet e sigurimeve shoqërore të papaguara, sipas llojit të detyrimit Në lekë

Nr.	Subjektet	Numri i subjekteve sipas NIPT	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Debia	Në %
1	Buxhetoret	511	131,179,667	100,782,721	178,944,467	410,906,855	2%
2	Jo buxhetorët	312	271,361,166	76,667,521	34,729,718	383,758,405	2%
3	Subjekte juridike	26,854	9,000,075,717	1,121,460,705	558,712,709	10,680,249,131	58%

4	Biznes i Vogël	82,452	6,145,988,266	687,886,556	147,461,821	6,981,336,643	38%
	TOTAL	110,129	15,548,604,816	1,986,797,503	920,848,715	18,456,251,034	100%

Burimi i të dhënave: Sektori i Marrëdhënieve me Tatimet dhe Administrimit të të Dhënave ISSH, punuar nga Grupi i auditimit KLSH.

Numri i lartë i subjekteve me detyrime të papaguara, përmban në vetvete dy risqe, atë financiar dhe social pasi:

- Detyrimet e papaguara nga subjektet debitorë në lidhje me shumën e papaguara të kontributeve, përfaqësojnë një numër të konsiderueshëm personash, të punësuar në këto subjekte, të cilët nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore (pensione, leje barrëindje, raporte mjekësore etj.).
- Deri në 31.12.2023, fondit të sigurimeve shoqërore nuk i janë vënë në dispozicion rreth 18,456,251 mijë lekë detyrime të prapambetura që u përkasin 110,129 subjekteve debitorë.
- Shuma vetëm e detyrimit rezulton 15,548,604,816 lekë ose në masën 84% të totalit të detyrimit dhe së bashku me interesa, gjoba totali i detyrimeve rezulton 18,456,251,034 lekë.
- Deri në 31.12.2023 rezulton rritje e konsiderueshme e numrit të subjekteve debitorë prej 1,019 subjekte si dhe një rritje të detyrimeve të prapambetura me 1,327,717 mijë lekë. Peshën më të madhe të detyrimeve e zënë subjektet juridike, biznes i madh me 58% dhe subjektet biznes i vogël zënë 38% të vlerës totale të detyrimit (detyrim+gjobë+interesa).

Detyrimet e papaguara nga subjektet nën përgjegjësi të DPT-së, janë progresive dhe dërgohen nga DPT çdo 3 muaj, sipas akt marrëveshjes midis dy institucioneve, për të cilat ISSH nuk ka tagër në mbledhjen e tyre.

Tabela nr.3.28.2 Të dhënat për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për **subjektet aktive** buxhetore, jo buxhetore, subjekte private - biznes i madh dhe biznes i vogël për vitin 2023, sipas drejtorisë së kontributeve, në datë 26.01.2024 (datë e cila ka përfunduar afati i ligjshëm i listë pagesave të muajit dhjetor 2023), paraqiten si më poshtë:

Në lekë

Nr.	Subjektet	Nr. i Subjekteve Aktive sipas NIPT	Detyrimi	Gjoba	Interesa	Debia	Në %
1	Buxhetoret	257	77,805,342	48,612,601	90,041,883	216,459,826	2.52
2	Jo buxhetoret	189	207,523,479	48,972,533	24,704,983	281,200,995	3.27
3	Subjekte juridike	11,468	4,043,295,113	368,134,947	149,338,745	4,560,768,805	53.06
4	Biznes i Vogël	33,066	3,284,723,146	215,832,459	36,915,481	3,537,471,086	41.2
	TOTAL	44,980	7,613,347,080	681,552,540	301,001,092	8,595,900,712	

Burimi i të dhënave: Sektori i Marrëdhënieve me Tatimet dhe Administrimit të të Dhënave ISSH, punuar nga Grupi i auditimit KLSH

Referuar të dhënave të detajuara mbi debitorët nga subjektet aktive rezulton se:

- **Subjektet aktive debitorë rezultojnë në numër 44,980 ose zënë rreth 41%** të numrit gjithsej të subjekteve debitorë dhe në vlerë 8,595,901 mijë lekë ose 47% të të gjithë shumës të detyrimit (detyrim+gjobë+interesa=18,456,251,034 lekë).
- Vetëm për nga vlera e detyrimit (pa gjobë, interesa) subjektet aktive debitorë zënë 49% të shumës gjithsej të detyrimit (7,613,347,080/15,548,604,816).
- Peshën specifike më të lartë kundrejt totalit të detyrimeve të subjekteve aktive e kanë Subjektet juridike prej 53%, e më pas biznesi i vogël me 41% dhe subjektet publike mesatarisht me 6%.

Tabelë nr.3.40. Të dhënat për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore, të papaguara në afat për subjektet ShPK aktive sipas kategorisë buxhetorë, jobuxhetorë, subjekte private.

Në lekë

Nr.	Subjektet	Numri i subjekteve sipas NIPT-it	Detyrimi	Gjoba	Interesa	Debia
1	ShPK BUXHETORË	5	1	595,924	4,071,767	4,667,692
2	ShPK JOBUXHETORË	2	1	19,184	7,113	26,298
3	ShPK Subjekte PRIVATE	114	171,188,886	20,825,517	6,537,417	198,551,820
	TOTAL	121	171,188,888	21,440,625	10,616,297	203,245,810

Nga auditimi i të dhënave të debitorëve, subjekte buxhetorë, për vitin 2023 rezulton se: Në total vlera për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore, të papaguara në afat për subjektet ShPK sipas kategorisë buxhetorë, jobuxhetorë, subjekte private është 203,245,810 lekë ose 2.4% e totalit të detyrimeve të subjekteve aktive.

- Nga 121 subjekte ShPK debitorë për sigurimet shoqërore, 29 subjekte ose 24% të tyre e kanë principalin 0 lekë, që do të thotë, se këto subjekte nuk kanë punëmarrës të pasiguar (kanë gjoba 3,030,031 lekë+ interesa 4,389,112 lekë).

- Nga 121 subjekte ShPK debitorë për sigurimet shoqërore, 13 subjekte ose 11% të tyre e kanë principalin deri 1,000 lekë (detyrim 0+ gjoba 0 lekë+ interesa 62 lekë).

Në trajtimin nivel makro që i bëhet kësaj kategorie biznesi në lidhje me detyrimet kontributive trajtohen si detyrime ndaj shtetit.

Më poshtë paraqiten subjektet debitore me formë ligjore, ShPK me status aktiv dhe me vlerë të detyrimeve më të larta se 2,000,000 lekë.

Tabelë nr.3.41: Subjekte debitore me formë ligjore-ShPK me status aktiv në 26.01.2024 Në lekë

Nr	Subjekti	Detyrimi	Gjoba	Interesa	Debia	Forma Ligjore	Pronesia
1	G. L	2,104,729	-	-	2,104,729	ShPK	Shqiptare
2	R. S	2,399,679	-	-	2,399,679	ShPK	E përbashkët (shqiptare - e huaj)
3	C. PH	2,431,757	7,858	3,083	2,442,698	ShPK	Shqiptare
4	N.	2,597,558	-	-	2,597,558	ShPK	E huaj
5	A	2,673,872	-	-	2,673,872	ShPK	Shqiptare
6	F	2,879,135	-	-	2,879,135	ShPK	E huaj
7	E	3,092,144	-	-	3,092,144	ShPK	Shqiptare
8	A	3,216,617	-	-	3,216,617	ShPK	Shqiptare
9	M.V	3,374,544	16,325	4,041	3,394,910	ShPK	E përbashkët (shqiptare - e huaj)
10	Sh.Tr	3,687,966	3,435,696	293,355	7,417,017	ShPK	Shqiptare
11	R	3,791,942	-	-	3,791,942	ShPK	Shqiptare
12	A	3,792,503	182,365	50,639	4,025,507	ShPK	Shqiptare
13	I.T. W.T.F	3,995,662	592,339	178,618	4,766,619	ShPK	Shqiptare
14	S.T	4,226,689	-	-	4,226,689	ShPK	E përbashkët (shqiptare - e huaj)
15	G.F.F.A	4,625,667	-	-	4,625,667	ShPK	E huaj
16	I.T	5,034,672	286,937	62,773	5,384,382	ShPK	Shqiptare
17	A.A	6,448,014	-	-	6,448,014	ShPK	E përbashkët (shqiptare - e huaj)
18	B. T	7,469,813	9,017,278	4,039,557	20,526,648	ShPK	Shqiptare
19	P.A	7,662,473	-	-	7,662,473	ShPK	Shqiptare
20	E	8,775,911	-	-	8,775,911	ShPK	Shqiptare
21	R. I. C.T	9,025,321	-	-	9,025,321	ShPK	E përbashkët (shqiptare - e huaj)
22	A.SH.G	10,651,131	-	-	10,651,131	ShPK	E përbashkët (shqiptare - e huaj)
23	T.C	10,841,057	-	-	10,841,057	ShPK	Shqiptare
24	D.G	14,842,393	4,143,905	1,240,294	20,226,592	ShPK	Shqiptare
	SHUMA	129,641,249	17,682,703	5,872,360	153,196,312		

Burimi i të dhënave: Sektori i Marrëdhënieve me Tatimet dhe Administrimit të të Dhënave ISSH, punuar nga Grupi i auditimit KLSH

Detyrimet e papaguara nga 24 subjektet Biznesi i madh ShPK, me status aktiv, deri në 26.01.2024 rezultojnë në vlerën 153,196,712 lekë dhe përbëjnë 75% të totalit të detyrimit të kësaj kategorie tatim paguesi.

Mbështetur në Ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, sipas përcaktimeve të nenit 3 “Përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme” përcaktohet se:

“Kontributet mbledhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore” dhe në nenin 14 “Masat shtrënguese” përcaktohet se: “Nëse kontributet nuk paguhet në kohë, organi përkatës ka të drejtë të marrë masa shtrënguese, në

përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nen 6 pika 2,3 “Punëdhënësi është përgjegjës për mbajtjen e kontributeve të punëmarrësit dhe për pagesën në organet tatimore, së bashku me kontributet e punëdhënësit. Personi i vetëpunësuar është përgjegjës për pagesën e kontributit edhe për punonjësit e papaguar të familjes”.

Gjithashtu që në Marrëveshjen e datës 23.06.1993, të lidhur mes ISSH, MFE, BKT e Bankës Bujqësore të Zhvillimit, është përcaktuar detyrimi që kanë këto banka në zbatim të VKM-së nr.261, datë 07.06.1993 “Për derdhjen e detyrimit ndaj sigurimeve shoqërore” ku është miratuar që: Ndërmarrjet, institucionet, organizatat dhe personat juridikë dhe fizikë privatë që bëjnë pagesën e punonjësve të tyre me listëpagesa të rregullta, bashkë me paraqitjen e çekut për tërheqjen e pagave të punonjësve për 15-ditëshin e dytë të muajit, do të bëjnë njëkohësisht dorëzimin e urdhërshirimit për derdhjen e detyrimit mujor ndaj sigurimeve shoqërore. Detyrimi i pagesës për sigurime shoqërore dhe shëndetësore dhe paraqitja e listë pagesës ka qenë në vijimësi i përcaktuar në nenet 13,15 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”; nenet 8, 9 e 11 të ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” ku punëdhënësi detyrohet të paguajë dhe të paraqesë çdo muaj në agjencitë e sigurimeve shoqërore të rrethit listën emërore, pagën mujore, pagën mbi të cilën është derdhur kontributi, masa e derdhur për çdo punonjës.

❖ ISSH ka trajtuar në mënyrë analitike situatën lidhur me detyrimet e prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore, shifër e konsiderueshme në numër subjektsh debitor, por dhe në vlerë debie, në total për të katër kategoritë e biznesit, ku me anë të shkresës nr. 9552 prot; datë 14.11.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm së ISSH-së i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me objekt problematikat që lindin nga detyrimet e prapambetura përsa i përket kontributeve të sigurimeve shoqërore.

❖ Në përgjigje të saj, DPT me shkresë nr. 18211/1 prot; datë 01.12.2023 ka paraqitur situatën konkrete deri në fund të muajit shtator 2023, e cila krahasuar me fillimin e vitit 2022 rezultonte me 13% rritje detyrimesh ndaj vlerës së detyrimeve për sigurime të papaguara dhe krahasuar me fillimin e vitit 2023 ka rritje me 4%. Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar rezulton rënie detyrimeve dhe se numrin më të lartë të detyrimit e zënë subjektet e vogla ku dhe masat shtrënguese janë më pak efektive. Gjithashtu silltet në vëmendje se ndjekja e detyrimeve në zërin “Kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” ndiqet me prioritet nga Drejtoria përgjegjëse e Mbledhjes së Detyrimeve Tatimore të Papaguara në rajone duke marrë masa konkrete me qëllim arkëtimin e tyre.

B. Debitorët e mbetur në organet e sigurimeve shoqërore ISSH. Nga të dhënat e ISSH gjendja e detyrimeve në 31.12.2023, rezulton në shumën totale 5,882,737,710.5 lekë, e cila zë 38 % të totalit të detyrimit (pa kamatë, gjobë) të të gjithë subjekteve debitore në përgjegjësi të DPT-së, vlerë e cila rezulton e kuadruar me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara në llog. ek. 470 “Të tjera kërkesa debitore”. Gjatë vitit 2023 ndryshimi i shtesave dhe pakësimeve të debitorëve (për pensione dhe për kontributet e vetëpunësuarit në bujqësi) ka zvogëluar gjendjen e debitorëve në shumën 184,682,563. Vlera e debitorëve përbëhet nga:

1. Debitorë për të vetëpunësuar në bujqësi (bujku) gjithsej 889,909,469 lekë
 2. Debitorë për pensione gjithsej 4,992,828,242 lekë
- Total 5,882,737,711 lekë

Tabela nr.3.42: “Debitorët për kontribute pranë ISSH”

Në lekë

Përshkrimi	Shuma
Gjendje në fillim të periudhës	6,067,420,274
Shtesa	505,067,232
Pakësimi	-689,749,795
Gjendja në fund të vitit	5,882,737,711
Pakësimi	184,682,563

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Kontributeve ISSH, punuar nga Grupi i auditimit KLSH

Nga të dhënat e tabelës më sipër rezulton se gjendja e debitorëve vijon të mbetet pothuajse në të njëjtat shifra.

Tabela nr.3.43 “Debitorët për kontribute për të vetpunësuar në bujqësi (bujku) sipas DRS

Në lekë

Gjendja progresive deri ne 31.12.2023				
Nr.	Rajoni	Shuma	Shuma e k/vonesës	Total
1	Berat	49,835,945	435,123	50,271,068
2	Dibër	10,564,815	822,179	11,386,994
3	Durrës	3,419,680	19,988	3,439,668
4	Elbasan	153,044,713	1,595,102	154,639,815
5	Fier	446,738,108	4,731,931	451,470,039
6	Gjirokastrë	201,283	32,215	233,498
7	Korçë	16,322,620	163,758	16,486,378
8	Kukës	3,001,572	83,038	3,084,610
9	Lezhë	23,611,800	263,500	23,875,300
10	Shkodër	19,347,000	128,574	19,475,574
11	Tiranë	13,452,146	529,728	13,981,874
12	Vlorë	140,521,147	1,043,504	141,564,651
	Totali	880,060,829	9,848,640	889,909,469

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Kontributeve ISSH, punuar nga Grupi i auditimit KLSH

Nga informacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se pakësimi i debitorëve në shumën 184,682,563 lekë ka ardhur si rezultat:

- Mbajtjes së debisë nga sistemi;
 - Pakësuar me vendim gjykate;
 - Pakësuar me vendim të ISSH-së, Auditit dhe Kontrolleve;
 - Arkëtimeve;
 - Faljes nga Ligji (konkretisht në lidhje me këtë vijojnë te veprojnë: “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të personave në pension, sipas ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”; dhe Ligji 46/2017 “Për faljen e detyrimeve që kanë ish-ushtarakët në skemën e pensioneve suplementare, nga rilogaritja e pensioneve, në zbatim të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”;
 - Sistemimeve nga financa;
 - Rishqyrtimeve nga dega e përfitimeve;
- Ndërsa shtesat e debitorëve kanë ardhur kryesisht nga:

- Rritja e numrit të punësuarve e shoqëruar me rritjen e rasteve të subjekteve të cilët nuk paguajnë kontributet;
 - Rishqyrtim nga kontrollet e Auditit të Certifikimit, me efekt në rritjen e gjendjes kreditore të përfituesve.
- Në vitin 2023, shtesa e detyrimeve nga pensionet ishte 225,014,906 lekë. Rreth 46% e kësaj vlere vjen nga llogaritjet jo të drejta sipas ligjit për përkatësinë e përfitimeve dhe 54% nga mosrespektimi i rregullave për punësim. Shtesa e debisë ka ardhur:
- Nga përfitimi jo i drejtë për shkak të punësimit në shumën 121,547,257 lekë ose në masën 54% të shtesës gjithsej të detyrimit.
 - Rishqyrtimi nga kontrollet e Auditit dhe Certifikimit në shumën 62,222,586 lekë ose në masën 28% të shtesës gjithsej të detyrimit.
 - Shtuar për shkak të ardhjes së dosjeve me debi nga rajonet e tjera në shumën 1,307,817 lekë ose në masën 1% të shtesës gjithsej të detyrimit.
 - Shtuar për shkak të transferimit të dosjeve nga rajonet e tjera në shumën 19,674,160 lekë ose në masën 9 % të shtesës gjithsej të detyrimit.

- Për shkak të pagesave të tepërta nga degët e përfitimeve në drejtoritë rajonale në shumën 20,263,086 lekë ose 9 % të shtesës gjithsej të detyrimit.
- Debitorët për pensionet e pleqërisë zënë pjesën më të madhe, rreth 64%, ndërsa trajtimet speciale zënë rreth 13% dhe të vetëpunësuarit në bujqësi zënë 15% të totalit të detyrimeve të mbetura në organet e sigurimeve shoqërore.

Detyrimet si rezultat i përfitimeve në mënyrë të detajuar paraqiten më poshtë:

Tabela nr. 3.44: "Të dhëna mbi gjendjen debitorë për përfitime në 31.12.2023, sipas llojit të përfitimeve" Në lekë

Nr.	Lloji i Përfitimit	Gjendja fillim te vitit		Shtuar gjate vitit		Pakësuar gjate vitit		Gjendja fund te vitit	
		Nr	Shuma	Nr	Shuma	Nr	Shuma	Nr	Shuma
1	Pensione Pleqërie	6,551	3,862,446,661	1,056	128,144,810	1,231	250,546,807	6,376	3,740,044,664
2	Pensione Invaliditeti	932	160,682,395	279	13,203,603	323	24,746,179	888	149,139,819
3	Pensione familjare	1,054	321,354,848	409	24,473,563	359	22,816,683	1,104	323,011,728
4	Trajtime të veçanta	2,800	778,950,255	904	55,887,512	956	98,540,925	2,748	736,296,843
5	Kompensime	96	24,633,760	49	2,682,544	38	5,163,150	107	22,153,154
6	Të tjera	744	22,224,854	22	622,874	31	665,693	735	22,182,035
	Shuma	12,177	5,170,292,773	2,719	225,014,906	2,938	402,479,437	11,958	4,992,828,242

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Kontributeve ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH.

Tabela nr.3.4:5 "Të dhëna mbi gjendjen debitorë për përfitime sipas DRSSH-ve"

Në lekë

Nr	Rajoni	Gjendja progresive deri ne 31.12.2023	
		Nr	Shuma
1	Berat	157	47,549,205
2	Dibër	533	260,251,522
3	Durrës	477	240,529,203
4	Elbasan	354	78,550,953
5	Fier	632	119,412,333
6	Gjirokastrë	157	27,696,164
7	Korçë	379	126,053,041
8	Kukës	947	617,041,351
9	Lezhë	331	109,555,240
10	Shkodër	798	387,330,054
11	Tiranë	6,980	2,917,457,120
12	Vlorë	213	61,402,056
	Totali	11,958	4,992,828,242

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Kontributeve ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit KLSH

Konkluzion: Për vitin 2023, gjendja e debitorëve vijon të mbetet shqetësuese për Institutin e Sigurimeve Shoqërore, pasi krahasuar me vitin 2022 rezulton se:

a) numri i debitorëve të krijuar nga subjektet buxhetore, jo buxhetore, Biznesi i Madh, Biznesi i vogël dhe të vetë punësuarit, të cilët derdhin kontributet e tyre në DPT, në total është **18,456,251,034 lekë**, rritur në mënyrë të konsiderueshme me 1,019 raste dhe në vlerën 1,327,717 mijë lekë.

b) detyrimet kontributive të cilat ndiqen nga ISSH, janë në total **5,882,737,711 lekë**, nga e cila debitorë për përfitime zënë 85% dhe debitorë për të vetëpunësuar në bujqësi zënë 15%, ndërsa në krahasim me një vit më parë, në total janë rritur në shumën 225,014,906 lekë. Gjendja e debitorëve për kontributet krijon probleme, pasi mos shlyerja e detyrimeve mund të ndërpritet për shkak të moshës, e cila bën edhe likuidimin e tyre të vështirë, prandaj ISSH duhet të fokusohet në llogaritjen e saktë të përfitimeve dhe monitorimin e rregullt të pagesave, për të mbrojtur sigurinë financiare të pensionistëve dhe për funksionim të qëndrueshëm të sistemit të sigurimeve shoqërore. Sipas evidencës së gjendjes së debitorëve në 31.12.2023 nga Drejtoria e Financës rezulton se debitorë të mbetur ndër vite (ndërruar jetë) rezulton në shumën 441,607 mijë lekë, të paidentifikuar në shumën 13,201 mijë lekë.

Përsa më sipër mbajtur Akt konstatim nr.5 datë 19.07.2024 protokolluar në ISSH me nr.8024 prot; datë 19.07.2024, për të cilën nuk ka observacion.

2.4. Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.

Në zbatim të drejtimin nr.4, të programit auditimit, mbi auditimin e funksionimit të strukturave të kontrollit në drejtim të inspektimit të pensioneve, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Evidenca dhe statistika të proceseve të inspektimit për vitin 2023;
- Dokumentat e punës të mbajtura nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve për inspektimet e kryera;
- Plani vjetor i vitit 2023;
- Raporti vjetor (analiza vjetore), viti 2023;
- Gjendja e dosjeve të pa inspektuara.

Drejtorja e Inspektimit të Përfitimeve është krijuar si strukturë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në zbatim të Vendimit të Këshillit Administrativ nr.6, datë 20.07.2010, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr.146, datë 01.12.2010. Objekti i veprimtarisë është kontrolli i përfitimeve të caktuara në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të përfitimeve suplementare të caktuara në zbatim të ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e përfitimeve suplementare.

Me ndryshimet strukturore të miratuara, sipas Vendimit nr. 2, datë 18.03.2022 të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, si dhe urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr.4540 prot; datë 30.06.2022, Drejtorja e Inspektimit të Përfitimeve, gjatë vitit 2023 ka funksionuar sipas strukturës së mëposhtme:

➤ *Drejtor i Drejtorisë*

- *Përgjegjësi i sektorit të inspektimit të pensioneve të pleqërisë; 11 specialistë*
- *Përgjegjësi i sektorit të inspektimit të pensioneve të invaliditetit, familjare dhe sociale; 2 specialistë*
- *Përgjegjësi i sektorit të inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta. 2 specialistë*

Sa më sipër, konstatohet se: gjatë vitit 2023 DIP është plotësuar me kapacitetet inspektuese, pra ka funksionuar me strukturë të plotë.

Bazuar në informacionin dhe të dhënat e kërkuara dhe të vëna në dispozicion nga Drejtorja e Inspektimit të Përfitimeve, rezulton se:

Me Vendimin nr.5, datë 25.07.2022 të Këshillit Administrativ të ISSH-së është miratuar Rregullorja “Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve”.

Planifikimi vjetor i punës së DIP për vitin 2023, është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm me shkresën nr.450.prot, datë 19.01.2023. Planifikimi është hartuar duke patur parasysh kapacitetet inspektuese në burime njerëzore dhe rregullin ku sipas të cilit çdo specialist inspektimi në çdo ditë pune të inspektojë 15 dosje përfitimi. Secili nga specialistët e njësisë, pasi bën kontrollin e dosjes së përfitimit, kushtet ligjore të përfitimit, dokumentacionin mbi të cilin është caktuar përfitimi, mënyrën e llogaritjes, bën edhe ballafaqimin me të dhënat e sistemit PCAMS për çdo dosje përfitimi, si dhe në rubrikën “Komente të auditit” bën komentin përkatës. Përfitimet të cilat rezultojnë të caktuara në përputhje me dispozitat ligjore, certifikohen, ndërsa për përfitimet, në të cilat konstatohen gabime dhe moszbatim të dispozitave ligjore mban akt konstatimin për secilin rast.

▪ **Inspektimi i përfitimeve afatgjata dhe të invaliditetit, familjare dhe sociale nga skema e detyrueshme.**

Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata gjatë vitit 2023, përveç programeve të inspektimit të planifikuara, ka përfunduar programin e inspektimit në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Shkodër dhe Berat, inspektimi për të cilat është planifikuar në programin vjetor të vitit 2022 dhe afati i inspektimit ishte 01.11.2022-03.02.2023. Rezultatet e inspektimit për këtë DRSSH nuk janë raportuar në të dhënat e vitit 2022, prandaj bëhen pjesë e raportimeve për vitin 2023. Sipas programit vjetor, Sektori i Inspektimit të Përfitimeve afatgjata dhe të invaliditetit, familjare dhe sociale, ka planifikuar inspektimet në 5 DRSSH, Shkodër, Berat, Tiranë, Elbasan dhe Durrës.

Sipas programit vjetor është planifikuar edhe inspektimi i përfitimeve afatgjata të caktuara nga DRSSH Elbasan dhe Durrës, inspektim i cili ka filluar në Shtator 2023 dhe është planifikuar të përfundojë në Shkurt 2024, rezultatet e të cilave do të paraqiten për vitin 2024, me përjashtim të

rezultateve të DRSSH Elbasan, për pjesën e përfitimeve të invaliditetit, familjare dhe sociale.

Kontrollet e kryera për vitin 2023, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata dhe të invaliditetit, familjare dhe sociale, paraqiten në tabelën ndodhur në aneksin nr.2.4.1.

Sipas auditimit rezulton se dosje për t'u kontrolluar gjatë vitit 2023, janë gjithsej 34,119 prej të cilave të certifikuar 31,043 dosje apo 90.98 % të dosjeve të kontrolluara. Janë evidentuar me probleme 1,840 dosje, ose 5,92% e totalit të dosjeve të kontrolluara. Nga 1,840 dosje të evidentuara me problem, 677 dosje rezultojnë me efekte financiare, ose 36.8 % e totalit. Në total kanë rezultuar 289 dosje debitor, me efekt financiar në shumën 15,240,685lekë dhe 388 dosje kreditor, me efekt financiar në shumën 11,381,950 lekë.

Gjithashtu, në programet e inspektimit, si pikë e veçantë e programit ka qenë edhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna në programet e mëparshme të inspektimit.

Rezultatet e kontrollit të zbatimit të rekomandimeve të paraqitura në raportet e inspektimit në përfundim të programeve të mëparshme të inspektimit, për DRSSH-të ku është kryer inspektimi gjatë vitit 2023, paraqiten në tabelën ndodhur në aneksin nr.2.4.2.

Nga dosjet e kontrolluara, për të cilat ishin zbatuar rekomandimet e paraqitura, për 203 prej tyre, si rezultat i rishqyrtimit kanë rezultuar me efekte financiare debitore dhe kreditore. Nga këto, 85 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar debitor në shumën 5,967,635 lekë, ndërsa 118 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar kreditor në shumën 6,117,713 lekë.

Ndërkohë, nga zbatimi i rekomandimit për 563 përfitime (plotësim me dokumentacion) ka rezultuar pa efekt financiar.

Nga 1587 dosje përfitimi të kontrolluara, ishin realizuar rekomandimet e lëna gjatë kontrolleve të mëparshme.

Nga dosjet e kontrolluara, për të cilat ishin zbatuar rekomandimet e paraqitura, për 398 prej tyre, si rezultat i rishqyrtimit kanë rezultuar me efekte financiare debitore dhe kreditore. Nga këto, 215 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar debitor në shumën 16,661,708 lekë, ndërsa 183 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar kreditor në shumën 8,292,686 lekë.

Sipas të dhënave të administruara rezulton se në përfundim të vitit 2023 janë kontrolluar 32,883 dosje të përfitimeve afatgjata, si dhe janë rikontrolluar 1,912 dosje përfitimi. Në total janë kontrolluar 34,795 dosje të përfitimeve afatgjata, në krahasim me vitin 2022 janë kontrolluar më shumë, pasi në vitin 2022 në total janë kontrolluar 33,457 ose 3.9% më shumë nga viti 2022.

▪ **Spektori i Inspektimit të Përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta.**

Spektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe trajtimeve të veçanta, bazuar në planin vjetor me nr.450 prot; datë 19.01.2023, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, gjatë vitit 2023 përveç programeve të inspektimit të planifikuara, ka përfunduar edhe programin e inspektimit në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Korçë për të cilën, inspektimi është planifikuar në programin vjetor të vitit 2022 dhe afati i kryerjes së inspektimit ishte 26.09.2022-10.02.2023. Rezultatet e inspektimit për këtë DRSSH nuk janë raportuar në të dhënat e vitit 2022, prandaj bëhen pjesë e raportimeve për vitin 2023.

Sipas programit vjetor të vitit 2023, si dhe në vijim të programit vjetor të vitit 2022, Spektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta, ka planifikuar/përfunduar inspektimet në DRSSH-të Korçë, Shkodër, Lezhë, Durrës, Kukës, Tropojë dhe Fier.

Inspektimet e kryera për vitin 2023, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta, paraqiten në tabelën ndodhur në aneksin nr.2.4.3.

Sipas tabelës nr. 2.4.3, rezulton se nga 9920 dosje për kontroll, janë paraqitur/inspektuar 9880 (pasi 120 dosje janë transferuar ose mbyllur), janë certifikuar 9655 dosje ose 97.7% e totalit të dosjeve të inspektuara. Nga 9880 dosje të inspektuara vetëm 239 dosje rezultojnë me efekte financiare, ose 2.4% e totalit të dosjeve të inspektuara nga të cilat 165 dosje kanë rezultuar debitore me efekt financiar në shumën 11,164,677 lekë dhe 74 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 1,739,160 lekë.

Gjatë vitit 2023 kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuar 125 dosje nga 357 dosjet të rishqyrtuara gjatë kontrollit.

Në total për vitin 2023 nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve janë inspektuar 42,763 dosje, në krahasim me vitin 2022 (ku janë kryer 38,232), kjo drejtori ka kryer 4,531 inspektime më shumë. Nga këto në total ka rezultuar një efekt financiar debitor në shumën 27,826,385 lekë dhe një efekt financiar kreditor në shumën 7,856,873 lekë.

Gjatë vitit 2022 në total, kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuara 839 dosje.

Si konkluzion:

- Nga auditimi rezulton se nga DIP janë 9,614 dosje të pa inspektuara dhe të pa certifikuara, nga të cilat 8,775 dosje pensioni të pa inspektuara, që i përkasin vitit 2020, si dhe 839 dosje që i përkasin viteve 2019-2021, për rishqyrtim. Në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, neni 62, pika 3 përcaktohet se *“Pensionet e njohura, por të pa tërhequra do të paguhen në çdo kohë, por jo më shumë se për 3 vjet. Pensionet e caktuara, por të paguara më pak, jepen në çdo kohë, por jo më shumë se për tre vjet. E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se 6 muaj nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20 për qind e këstit mujor të pensionit”*. Sipas përcaktimeve të këtij neni, duhej të ishin marrë masa, me qëllim shmangien e efekteve financiare për ISSH-në dhe buxhetin e shtetit për shkak të tejkalimit të afatit ligjor 3 vjeçar për kërkimin e tepërcave të përfituara padrejtësisht nga përfituesit. Për këtë, nga ana e grupit të auditimit vihet re një mungesë vullneti për të arritur qëllimet e përcaktuara brenda afateve, në aktet ligjore dhe nënligjore të ISSH-së.

- Nga ana e grupit të auditimit është kërkuar evidenca e debitorëve të nxjerrë për shkak të punësimit, e cila paraqitet në tabelën ndodhur në aneksin nr.2.4.4.

Sipas të dhënave, DIP ka konstatuar të paktën 78 raste të tërheqjes së kësteve të përfitimit në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, duke kërkuar shumat e përfituara padrejtësisht nëpërmjet ndalesës së pensionit në masën 50% të tij deri në shlyerjen e plotë të detyrimit. Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se masat e marra si dhe rekomandimet e lëna nga ana e DIP për DRSSH-të, nuk janë të plota ashtu siç parashikohet në nenin 62, pika 3, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, ku ndër të tjera citohet se: *“Personi, që ka përfituar pension ose të ardhura të tjera nga sigurimet shoqërore, me mënyra e mjete në kundërshtim me ligjin, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër, të cilën e shlyen duke iu mbajtur çdo muaj 50 për qind e këstit mujor të përfitimit. Gjithashtu, personi dënohet me gjobë në **masën katërfish të dëmit të shkaktuar**”*. - Është konstatuar se në disa raste ndalesa e pensionit është bërë nga ana e DRSSH-ve në masën 20% dhe jo në masën 50% ashtu siç përcaktohet në Nenin 62 sipërcituar, si pasojë dëmi i shkaktuar buxhetit të shtetit nga përfitimi i paligjshëm i masës së pensionit do të dojë një kohë më të gjatë për tu kthyer, ose në rastin më të keq nuk mund të mblidhet më.

Gjithashtu, nga debitorët progresiv rezulton se ndalesa e masës së pensionit nuk është sipas, nenit 62, pika 3, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, ku ndër të tjera citohet se masa e ndalesës së pensionit duhet të jetë në masën 50%. Bazuar në informacionet/dokumentacionet të cilat janë vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se ndalesa e masës së pensionit, në pjesën më të madhe të debitorëve (sidomos përpara vitit 2022) të jetë 30-40% të saj dhe jo në masën 50%, ashtu siç përcaktohet në nenin 62, pika 3.

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi, për ndalesat me 20% të masës së pensionit (kur vjen si shkak i mos deklarimit të përfituesit), Titullari sipas Drejtorive Rajonale si dhe drejtuesit e Degëve të Përfitimeve të atakuar më sipër.

Nga auditimi i 78 dosjeve të debitorëve të nxjerrë për shkak të punësimit, grupi i auditimit referuar sistemit CMIS dhe PCAMS, ka konstatuar se:

- Përfituesit e pensionit kanë rezultuar njëkohësisht edhe ekonomikisht aktiv në administratën publike/institucione shtetërore;
- Në 10 raste ka patur diferenca në vlerë nga përllogaritja e grupit të auditimit, krahasuar me vlerën e nxjerr nga Njësit e Përfitimeve dhe Drejtoria e Inspektimit;
- Të paktën në tre raste lidhja e pensionit, nga Degët e Përfitimeve Rajonale është kryer edhe pse përfituesi ka qenë ekonomikisht aktiv që në lidhjen e pensionit (dosja me nr.282853, nr.113409 dhe nr.112426);
- Në një rast është konstatuar se përfituesi ka kaluar ekonomikisht aktiv, pas certifikimit të dosjes;

Më të detajuara, dosjet e rezultuara me shkelje, paraqiten në tabelën ndodhur në aneksin 2.4.5 Sa më sipër, për veprimet dhe mos veprimet, mbajnë përgjegjësi specialistët e DIP dhe inspektorët e përfitimeve sipas rajoneve përkatëse: znj. A.V; dhe specialisti DIP, i cili ka inspektuar dosjen nr. 281536-37.

Znj. A.C; znj. J. S; znj. I.A; z. V.A; z. O.A; znj. A.M; znj. E.L; z. V.S; z. K.G; z. G.M; znj. B.C; znj. A.N; z. E. Sh; znj. M.C; znj. E.D.

Grupi i auditimit shqyrtoi për vlerësim, 6 programe me zgjedhje të rastësishme nga 12 programe inspektimi të përfunduara në vitin 2023, ose 50%. Nga të cilat 3 praktika të përfunduara nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata nga 5 të realizuara, dhe 3 nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare nga 7 të realizuara.

DIP ka funksionuar në bazë të vendimit nr.5 të datës 05.07.2022, ku është miratuar Rregullorja “Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve”. Në kreu VIII të kësaj rregullore përcaktohet dokumentacioni i cili administrohet në dosjen e inspektimit, të subjektit të inspektuar ku më pas arkivohet. Nga auditimi i dosjeve rezultojë se praktikat janë të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në rregulloren e miratuar për funksionimin e DIP, kreu VIII.

Një ndër pikat me rëndësi të programeve të inspektimit të realizuara nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve është edhe kontrolli i zbatimit të rekomandimeve të paraqitura në Raportet Përfundimtare në zbatim të programeve të mëparshme të inspektimit.

Sipas rekomandimeve të DIP janë kontrolluar 1,856 dosje përfitimi (të lëna nga rekomandimet e mëparshme), nga të cilat 1394 dosje përfitimi (ose 75%) janë certifikuar si rezultat i zbatimit të rekomandimeve të lëna, ndërsa **462 dosje përfitimi (ose 25%)** janë të porealizuara.

Nga 1394 dosjet e certifikuara, për të cilat ishin zbatuar rekomandimet e lëna, 627 (45%) prej tyre, si rezultat i rishqyrtimit kanë rezultuar me efekte financiare debitore dhe kreditore si më poshtë:

- 295 dosje (47%) përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar debitor në shumën 21,997,069 lekë.
- 332 dosje (53%) përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar kreditor në shumën 13,761,124 lekë.

Ndërkohë, nga zbatimi i rekomandimit për 767 dosje (55%) përfitime (plotësim me dokumentacion) ka rezultuar pa efekt financiar.

Rezultatet e kontrollit të zbatimit të rekomandimeve, në DRSSH-të sipas programeve respektive po i paraqesim në tabelën si më poshtë:

Tabela nr.2.4.6: Rezultatet e kontrollit të zbatimit të rekomandimeve:

Kontrolli Detyrave	DRSSH Tiranë	DRSSH Gjirokastrë	DRSSH Korçë	DRSSH Lezhë	DSSH Tropojë	DRSSH Fier	DRSSH H Kukës	DRSSH Berat	DRSSH H Shkodër	DRSSH Elbasan	TOTALI
Dosje gjithsej	919	33	10	245	43	345	82	103	50	367	2,197
Paraqitur	802	31	10	243	42	234	76	95	50	273	1,856
Pa realizuar	292	4	2	3	1	111	6	5	9	29	462
Nr. Dosje	83	14	2	63	11	59	12	40	1	10	295
Debitore leke	5,906,620	876,505	120,019	5,405,909	808,263	4,183,358	751,925	2,250,803	536,811	1,156,856	21,997,069
Nr. Dosje	132	6		80	14	62	15	13	6	4	332
Kreditore/leke	7,070,078	192,789		3,176,464	503,709	1,743,001	591,238	250,389	172,280	61,176	13,761,124

Burimi të dhënave: DIP në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Sa më sipër, grupi i auditimit ka konstatuar se DRSSH/DSSH-të nuk kanë zbatuar afatet e përcaktuara sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, neni 62, pika 2, ku ndër të tjera citohet se: “E drejta për të kërkuar shumat e marra tepër gjatë një viti, ushtrohet jo më vonë se 3 vjet nga marrja e tyre, por jo më vonë se **6 muaj** nga data e konstatimit dhe masa e ndalesës për çdo muaj është 20% e kështit mujor të pensionit”. Nga tabela e mësipërme rezulton se të paktën 462 dosje përfitimi janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipërcituara. Nga verifikimet e mëtejshme, grupi i auditimit konstatoi se dhe nga rishqyrtimet e dosjeve të përfitimeve për të cilat ishin zbatuar rekomandimet e

lëna, rezultuan të ishin në tejkalim të afatit 6 mujor.

Auditimi i zbatimit të afateve në procedurat e inspektimit, bazuar në rregulloren e funksionimit të Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve:

Sipas përcaktimeve të kreut VI të rregullores përcaktohet qartë se:

- pas përfundimit të inspektimit përgatitet projekt raporti jo më vonë se 45 ditë;
- kopja e konfirmuar e projektit dërgohet në ISSH brenda 15 ditëve nga subjekti inspektuar;
- zhvillohet takimi ballafaques brenda 15 ditëve nga konfirmimi i projektit;
- pas takimit brenda afatit 14 ditor dërgohet raporti përfundimtar në subjekt.

Tabela nr.2.4.7: Të dhëna mbi programet dhe afatet:

Dozjet e auditimit sipas subjekteve	Programi nr/datë	Afati i Inspektimit	Projekt raporti nr/datë	Kthimi i observacio neve pas PRA	Takimi ballafaques	Raportit Përfundimtar nr/datë	Afati nga mbajtja e aktit në terren deri në dërgimin e Projektit	Afati nga takimi ballafaques në dërgimin e Rap.Përfundimtar
SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE AFATGJATA								
DRSSH Tiranë	Nr. 916;	08.02.2023	Nr. 916/3	Datë	Datë	Nr. 916/5	62 ditë	26 ditë
	Datë 03.02.2023 ;	-	Datë 17.11.2023	06.12.2023	19.12.2023	Datë 15.01.2024	kalendarike ose 17 ditë vonesë	kalendarike ose 11 ditë vonesë
DRSSH Berat	Nr. 6952;	01.11.2022	Nr. 6952/2	Datë	Datë	Nr. 6952/4	34 ditë	37 ditë
	Datë 18.10.2022 ;	-	Datë 07.03.2023	31.03.2023	14.04.2023	Datë 22.05.2023	kalendarike	kalendarike ose 23 ditë vonesë
DRSSH Shkodër	Nr. 6983;	01.11.2022	Nr. 6983/2	Datë	Datë	Nr. 6983/4	23 ditë	27 ditë
	Datë; 19.10.2022 ;	-	Datë 27.02.2023	23.03.2023	14.04.2023	Datë 11.05.2023	kalendarike	kalendarike ose 13 ditë vonesë
SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE SUPLEMENTARE DHE TRAJTIMEVE TE VECANTA								
DRSSH Fier	Nr. 5646;	04.07.2023	Nr. 5646/2	Datë	Datë	Nr. 5646/4	41 ditë	10 ditë
	Datë 26.06.2023;	-	Datë 11.01.2024	29.01.2024	05.02.2024	Datë 15.02.2024	kalendarike	kalendarike
DRSSH Durrës	Nr. 2312;	11.04.2023	Nr. 2312/2	Datë	Datë	Nr. 2312/4	62 ditë	16 ditë
	Datë 21.03.2023;	-	Datë 15.08.2023	07.09.2023	19.09.2023	Datë 04.10.2023	kalendarike ose 17 ditë vonesë	kalendarike ose 2 ditë vonesë
DRSSH Korçë	Nr. 6393;	26.09.2022	Nr. 6393/2	Datë	Datë	Nr. 6393/4	28 ditë	30 ditë
	Datë 23.09.2023;	-10.02.203	Datë 09.03.2023	03.04.2023	19.04.2023	Datë 19.05.2023	kalendarike	kalendarike ose 15 ditë vonesë

Burimi të dhënave: DIP në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Konstatim: sipas të dhënave në tabelën më sipër rezulton se afatet nga përfundimi i inspektimit në terren deri në mbajtjen e Raportit Paraprak dhe të Raportit Përfundimtar vonesë, kjo jo sipas përcaktimeve të Rregullores së miratuar të DIP në kreun VI të saj.

2.5. Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023

Në bazë të Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023” si dhe aktet nënligjore të dalë gjatë vitit mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit të shtetit, u shqyrtua dokumentacioni më poshtë:

- 1.Çelja e buxhetit të vitit 2023, si dhe detajimi i shpenzimeve administrative sipas programeve dhe produkteve.
- 2.Shkresat për rishikimet e buxhetit (ri alokime, shtesa /pakësime) gjatë vitit 2023.
- 3.Urdhri i titullarit për hartimin e projekt buxhetit për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.
- 4.Programi Buxhetor Afatmesëm i miratuar për periudhën 2023-2025, me ndryshimet përkatëse dhe shkresat përcjellëse për periudhën 01.01.2023-31.12.2023.
- 5.Raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2023.

6. Urdhrrat për ngritjen e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore etj.

2.5.1. Programimi PBA 2023-2025 (faza I dhe II), si dhe programimi i buxhetit të vitit 2023 nga ISSH

Përgatitja e buxhetit të ISSH-së ka kaluar në dy faza:

1. Faza I- strategjike
2. Faza II- teknike

Faza I – Strategjike

Faza e parë PBA 2023-2025, për programimin e përgjithshëm të të ardhurave si dhe ngarkesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore të subjekteve të mbledhura nga DPT, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ISSH harton programimin brenda limitit të përcaktuar nga MFE. Programimi sipas kësaj faze është përfunduar brenda afateve ligjore dhe është dërguar për shqyrtim dhe diskutim të mëtejshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, me shkresë nr. 1894/1, datë 27.4.2022 “Dërgohet programi i Sigurimeve Shoqërore për vitet 2023-2025 (Faza e parë)”.

Me shkresë nr.2301/1 prot; datë 06.04.2022 të Drejtorit të Përgjithshëm janë ngritur ekipet e menaxhimit të programeve buxhetore (EMP) sipas programit 10220 “Sigurimi Shoqëror” dhe 10270 “Sigurimet Suplementare të ushtarakëve”.

Programimi Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2023-2025, është bazuar në VKM nr.119, datë 09.03.2022 “Për miratimin e tavanave përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2023–2025”, si dhe në udhëzimin e MFE nr. 9, datë 28.02.2022 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025”.

Në hartimin e programit buxhetor të ISSH-së për periudhën 2023-2025, evidentohen shpenzimet e programit “Sigurime Shoqërore” në variantin pasiv për vitet 2023, 2024, 2025, duke marrë parasysh edhe efektet mbetëse të rritjes së pensioneve për çdo vit në nivelet e inflacionit të vendosura nga qeveria nga data 1 prill për secilin vit, si për qytetin ashtu edhe për fshatin.

Me shkresë nr. 3442/3, datë 29.03.2022 të MFE “Dërgohen për njohje dhe zbatim tavanet përgatitore të PBA 2023-2025”, ku përcaktohen shpenzimet e programit “Sigurime Shoqërore”, përkatësisht sipas viteve janë si më poshtë:

Tabela nr. 2.5.1 Tavanet e programit “Sigurime Shoqërore” sipas MFE Në milionë lekë

	2023	2024	2025
Shpenzimet e Programit	155,865	164,498	173,298

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH

Tavanet e propozuara nga ISSH për shpenzimet e programit “Sigurime Shoqërore” përkatësisht sipas viteve janë si më poshtë:

Tabela nr. 2.5.2. Shpenzimet e programit “Sigurime Shoqërore” në variantin pasiv, sipas ISSH-së Në milionë lekë

	Emërtimi	2023	2024	2025
I	Shpenzimet	156,450	164,498	173,561
II	Politika të reja pensionesh (Indeksi i pensioneve)	2,670	3,253	3,703

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga krahasimi i shpenzimeve të llogaritura me tavanet, konstatohet se për vitin 2023 tavanet e shpenzimeve janë 585 milion lekë më pak se sa shpenzimet e planifikuara nga ISSH dhe për vitin 2025 janë 263 milion lekë më pak se sa shpenzimet e planifikuara nga ISSH, çka tregon nga MFE për një planifikim jo të mirë studiuar dhe të bërë mbi analiza treguesish realë.

Faza II – Faza Teknike Në vijim të shkresës së MFE nr. 13308/1, datë 09.08.2022 “Dërgohen tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA-së 2023-2025” të miratuara me VKM nr. 535, datë 29.07.2022 dhe për zbatim Udhëzimi plotësues nr. 22, datë 08.07.2022 “Për Përgatitjen e programimit Buxhetor Afatmesëm 2023-2025”, dërguar nga MFE me shkresë nr. 13308/2 prot; datë 22.07.2022 dhe është përgatitur programi PBA 2023-2025.

Me shkresë nr.5299/1 prot; datë 26.08.2022 të ISSH dërguar MFE-së, janë dërguar treguesit financiar të programimit “Sigurime Shoqërore” për vitet 2023-2025 sipas produkteve dhe programeve si dhe relacioni i procesit të programimit të fazës së II sipas formatit standard të sistemit AFMIS e shoqëruar me relacion shpjegues, të cilat janë reflektuar në variantin pasiv, pra pa efektin financiar vjetor të politikave të rritjes së pensioneve.

Për fazën e dytë të përgatitjes së PBA-së, janë marrë në konsideratë të dhënat faktike të gjashtëmuajorit të parë të vitit 2022 dhe realizimi i pritshëm i vitit 2022.

Për hartimin e treguesve të programit të të ardhurave dhe shpenzimeve 2023-2025 janë përfshirë strukturat e 15 njësive shpenzuese sipas ekipeve të punës.

Programimi i financimeve të sigurimeve shoqërore të ISSH-së për vitet 2023-2025 (faza II) në variantin pasiv, duke marrë parasysh edhe efektet rritëse të pensioneve për çdo vit në nivelin e inflacionit të çdo viti, si për qytetin e fshatin, është si më poshtë:

Tabela nr.2.5.3. Shpenzimet dhe të ardhurat e programit në variantin pasiv Në milionë lekë

Përshkrimi	2023	2024	2025
I.Shpenzimet e Programit	155,871	164,507	175,305
1.Të ardhurat nga kontributet	102,070	108,127	117,045
2.Transferta nga Buxheti i Shtetit	53,801	56,380	58,260

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH

Gjatë hartimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, janë parashikuar rritja e numrit të përfituesve të pensioneve të pleqërisë, suplementare shtetërore, suplementare të ushtarakëve, si dhe reduktimi i numrit të pensionisteve femra për shkak të rritjes graduale të moshës së pensionimit etj., krahasuar me vitet e mëparshme.

Me miratimin e buxhetit vjetor nga KA me shkresë nr. 21 prot; datë 04.01.2023, ISSH shpërndan të gjitha njësive shpenzuese fondin e shpenzimeve për përfitime dhe shpenzimeve administrative në nivel llogarie (artikulli) dhe të ndarë në muaj.

Në variantin aktiv tavanet për shpenzimet e vitit 2023 janë në shumën **167,315 milion lekë**, prej së cilës është parashikuar indeksimi i pensioneve dhe kontigjenca për bonusin e fund vitit, ndërsa totali i të ardhurave është i ndarë në:

Shuma e transfertës buxhetore (604) në vlerën **57,292 milion lekë**

- Transfertë nga buxheti 51,562 milion lekë
- Indeksimi i pensioneve 2,200 milion lekë
- Shpërblimi i fund vitit 3,530 milion lekë

Të ardhura nga sigurimet shoqërore, në vlerën **110,023 milion lekë**.

Shqyrtimi dhe miratimi i PBA 2023-2025 nga ISSH, nuk ka ndjekur gjithë hapat e procedurës së duhur ligjore, pasi nuk ka kaluar për shqyrtim dhe miratim në Këshillin Administrativ, në kundërshtim me nenin 75 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se Këshilli Administrativ “Miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin vjetor, buxhetin vjetor dhe perspektivat 3-vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore dhe Statutin e ISSH, neni 11, ku përcaktohet se ISSH përgatit raportin vjetor dhe programin e veprimtarisë së ardhshme financiare, të cilat miratohen nga Këshilli Administrativ i ISSH dhe i paraqiten çdo vit Këshillit të Ministrave.

Shpenzimet administrative të ISSH dhe DRSSH-ve në rrethe.

Shpenzimet administrative të ISSH-së, për periudhën Janar-Dhjetor 2023, paraqiten në mënyrë analitike sipas çeljes, ndryshimeve si dhe realizimi e tyre, në vijim.

Konstatohet se të gjitha DRSSH-të kanë mbajtur nën kontroll kryerjen e shpenzimeve administrative, brenda kufijve të planifikuar (të ndryshuar) për vitin 2023.

2.5.2. Çelja e Buxhetit 2023

Referuar ligjit nr.84/2022, datë 24.11.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023” programi i skemës së sigurimeve shoqërore për të ardhurat dhe shpenzimet i miratuar me VKA nr.19, datë 27.12.2022 “Për buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023” si dhe aktet normative që kanë ndryshuar gjatë vitit, është si më poshtë:

Tabela nr.2.5.4. Çelja dhe ndryshimet e shpenzimeve administrative sipas zërave, viti 2023

Në mijë lekë

Analiza sipas llog.ek.	Emërtimi	Plani Fillestar 2023/ligji 84/2022	Ndryshime Vkm nr 187 datë 31.03.2023	Ndryshime Vkm nr 553 datë indeksimi 28.09.2023	Ndryshime Vkm nr 654,dt 31.11.2023 dhe 819 dt 28.12.2023	Plan Perfundimtar 2023
Shpenzime administrative		3,450,000	3,478,070	3,518,070	3,550,680	3,550,680
600	Paga, shpërblime dhe shpenz. të tjera personeli	1,151,639	1,151,639	1,451,639	1,451,639	1,451,639
601	Kontribute për sig. Shoqërore dhe shëndetësore	211,504	211,504	241,504	241,504	241,504
602	Mallra dhe shërbime të tjera	1,333,857	1,361,927	1,401,927	1,434,537	1,434,537
230+231	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të patrupëzuara	753,000	753,000	423,000	423,000	423,000

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme rezulton se buxheti i shpenzimeve administrative ka pësuar ndryshime sipas AN nr.5, datë 25.10.2023 VKM-ve dhe rishikimeve të buxhetit gjatë vitit nga ISSH, të miratuara me KA nr. 2, datë 23.06.2023. Çelja e planit fillestar të shpenzimeve administrative është 3,450,000 mijë lekë dhe ndryshimet gjatë vitit kanë ndikuar në rritjen e planit fillestar në shumën 100,680 mijë lekë ose në masën 2.9%, konkretisht sipas artikujve paraqiten si më poshtë:

○ Shpenzimet për pagat (600) janë rritur në shumën 300,000 mijë lekë ose në masën 26%, e cila ka ardhur si rezultat i rritjes së pagave për kategoritë e caktuara (specialistë) të miratuara me vendim të KA nr. 2, datë 23.06.2023, “Për disa ndryshime në rregulloren nr. 3/2 datë 26.02.2008, “Për personelin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore, rritjen e pagave, caktimin e klasave, shkallëve të karrierës dhe koeficientët sipas klasave dhe shkallëve”. Efekti financiar i rritjes së pagave nuk ka tejkaluar tavanin e shpenzimeve të planifikuara për vitin 2023.

○ Shpenzimet për sigurimet shoqërore shëndetësore (601) janë rritur në shumën 30,000 mijë lekë ose në masën 14%, e ndikuar nga rritja e fondit të pagave.

Shpenzimet për mallra dhe shërbime të tjera (602) në shumën 100,680 mijë lekë ose në masën 8%, si pasojë e rritjes së shpenzimeve për kryerjen e pagesave të përfitimeve për Postën dhe Bankat e Nivelit të dytë. Gjithashtu janë parashikuar shpenzimet e pjeshme të vitit për përmirësimet në Sistemin IT të ISSH, sipas VKM-së nr.673 datë 22.11.2021 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, i ndryshuar.

○ Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara (230) rezulton me mosrealizim në shumën 323,221 mijë lekë ose në masën 55%, krahasuar me planin fillestar si pasojë e mos realizimit të shpenzimeve të parashikuar për përmirësimin e Sistemit të IT në ISSH (parashikuar nga zbatimi i VKM-së nr.673 datë 22.11.2021).

○ Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara (231) janë zvogëluar në shumën 6,779 mijë lekë ose në masën 4%, si pasojë e mbetjes së investimeve në proces (rikonstruksion dhe mobilim në Berat, Dibër, Aparati i ISSH).

Plani për realizimin e shpenzimeve për investime në fillim të vitit është mbajtur në llogarinë e Buxhetit të përgjithshëm dhe në bazë të kërkesave të argumentuara për shtesë fondi, e më pas të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm, është bërë rialokim i fondeve përkatësisht në drejtoritë rajonale.

Tabela nr.2.5.5. Shpenzimet administrative për ISSH, viti 2023

Në mijë lekë

Nr.	EMËRTIMI	Fakt 2022	Plan fillestar 2023	Plan përfundimtar 2023	Fakt 2023	Ndryshimi	Në %
1	Totali i Shpenzimeve Administrative	2,824,916	3,450,000	3,550,680	3,297,383	(253,296)	93%
1	Paga, Shpërblime dhe Shpenzime të tjera personeli (600)	1,075,597	1,151,639	1,451,639	1,427,645	(23,994)	98%
2	Kontribute për sigurimet shoqërore shëndetësore (601)	168,510	211,504	241,504	226,880	(14,624)	94%
3	Mallra dhe shërbime të tjera (602)	1,265,627	1,331,257	1,431,937	1,305,363	(126,574)	91%

4	Shpenzime për org. ndërkombëtare dhe të tjera (605)	1,828	2,600	2,600	1,853	(747)	71%
5	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara (230)	238,118	586,834	263,613	259,639	(3,974)	98%
6	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara (231)	75,237	166,166	159,387	76,003	(83,384)	48%

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH

Plani fillestar i shpenzimeve administrative është parashikuar në shumën 3,450 milionë lekë, ose rreth 550 milionë lekë më shumë se plani fillestar i vitit 2022 (ka qenë 2,900 milionë lekë), të cilat zënë 2.1 % të totalit të shpenzimeve, nga 5% të shpenzimeve që parashikohet si limit në pikën 3, të nenit 67, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH” i ndryshuar. Plani fillestar i shpenzimeve administrative rezulton 625,084 mijë lekë më shumë se fakti i vitit 2022 ose 22% më shumë. Realizimi i vitit 2023 rezulton më shumë se realizimi i vitit 2022 në masën 16.7% ose në vlerë 472,467 mijë lekë.

Konstatohet se ndryshimet në program nuk janë bazuar në analiza të thelluara për çdo zë shpenzimesh, dhe se në disa raste kanë qenë të pa argumentuar, pasi realizimi është më pak se plani fillestar, kështu:

- Shpenzimet për Mallra dhe shërbime të tjera (602) ka mosrealizim nga plani përfundimtar për 126,574 mijë lekë dhe për 25,894 mijë lekë nga plani fillestar.

-Shpenzimet për org. ndërkombëtare dhe të tjera (605) rezulton me mosrealizim për 747 mijë lekë ose 29% më pak se plani fillestar ose atij përfundimtar, çka tregon se nuk ka qenë i studiuar e argumentuar që në planifikim dhe duke mos marrë parasysh edhe realizimin faktik nga viti i mëparshëm.

- Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara (231) ka mosrealizim nga plani përfundimtar për 83,384 mijë lekë dhe për 90,163 mijë lekë nga plani fillestar.

Shpenzimet administrative të ISSH-së për vitin 2023 janë realizuar më pak se plani i ndryshuar me 253,296 mijë lekë ose 7% më pak. Realizimi i tyre është mbajtur nën kontroll, por ndryshimet e bëra gjatë vitit në shumën 100,680 mijë lekë tregon për një realizim jo real të tyre.

2.5.3. Zbatimi i Buxheti

Realizimi i shpenzimeve administrative sipas rajoneve, paraqitet tek tabela më poshtë:

Tabela nr.2.5.6. Realizimi i shpenzimeve administrative sipas DRSSH-ve, viti 2023

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakt 2022	Plan fillestar 2023	Plan përfundimtar 2023	Fakt 2023	Ndryshimi	Në %
	Totali ISSH	2,824,916	3,450,000	3,550,680	3,297,383	(253,296)	93%
1	Berat	130,546	107,762	190,912	169,788	(21,124)	89%
2	Dibër	103,810	105,083	138,117	132,898	(5,219)	96%
3	Durrës	202,522	158,839	200,377	199,130	(1,248)	99%
4	Elbasan	208,919	214,681	259,416	253,562	(5,854)	98%
5	Fier	219,098	226,036	264,018	259,286	(4,732)	98%
6	Gjirokastrë	99,833	96,283	117,813	117,267	(546)	100%
7	Korçë	188,189	189,207	230,145	225,776	(4,369)	98%
8	Kukës	77,208	81,648	96,713	94,954	(1,759)	98%
9	Lezhë	101,649	107,161	127,453	121,014	(6,439)	95%
10	Shkodër	137,822	147,167	166,403	160,195	(6,208)	96%
11	Tiranë	430,139	439,980	521,445	516,911	(4,535)	99%
12	Vlorë	193,997	182,642	234,801	232,703	(2,098)	99%
13	DAQ	134,734	135,826	185,186	172,153	(13,033)	93%
14	Brendshëm	596,143	347,755	730,486	641,609	(88,877)	88%
15	B.Përgjithshëm	307	909,929	87,394	138	(87,256)	0.2%

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH

Nga çdo drejtori rajonale janë ndjekur dhe respektuar treguesit e programuar të shpenzimeve dhe në total rezultojnë me mosrealizim në vlerën 253,296 mijë lekë. Me mosrealizim më të lartë shpenzimesh rezulton Buxheti i brendshëm, e më pas Drejtoria Rajonale Berat.

2.5.4. Aparati i ISSH

Aparati i ISSH si njësi varësie e këtij institucioni, harton dhe ndjek treguesit buxhetor vjetor të përcaktuar sipas dispozitave ligjore dhe nënligjore për hartimin e buxhetit të ISSH-së dhe udhëzimeve të Drejtorisë së Përgjithshme, të miratuar nga Këshilli Administrativ.

Programimi i zërave buxhetorë, bëhet nga Përgjegjësi i Sektorit të Buxhetit të Brendshëm, bazuar në realizimin e faktit të shpenzimeve të vitit paraardhës.

Për buxhetin e brendshëm të Aparatit, plani fillestar, ndryshimet gjatë vitit 2023, realizimi i zërave të shpenzimeve, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.2.5.7. Realizimi i shpenzimeve administrative të Aparatit të ISSH, viti 2023

Në mijë lekë

Nr.	EMËRTIMI	Fakt 2022	Plan fillestar 2023	Plan përfundimtar 2023	Fakt 2023	Ndryshimi Plan-Fakt	Ndryshimi në %
I	Totali i Shpenzimeve Administrative	596,143	347,755	730,486	641,609	(88,877)	88%
1	Paga, Shpërblime dhe Shpenzime të tjera personeli (600)	168,718	169,332	228,792	228,553	(239)	100%
2	Kontribute për sigurimet shoqërore shëndetësore (601)	26,028	28,278	35,278	34,309	(970)	97%
3	Mallra dhe shërbime të tjera (602)	162,521	147,545	150,009	81,136	(68,873)	54%
3.1	Nga këto - Komisione të Pagesës së Përfitimeve	162	200	200	99	(101)	49%
4	Shpenzime për org. ndërkombëtare dhe të tjera (605)	1,828	2,600	2,600	1,853	(747)	71%
5	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara (230)	238,118	-	263,613	259,639	(3,974)	98%
6	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara (231)	758	-	50,194	36,119	(14,075)	72%

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH

Çelja e buxhetit të Aparatit për vitin 2023 në total rezulton në vlerën 347,755 mijë lekë, e miratuar me VKA nr.19, datë 27.12.2022 “Për buxhetin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023”. Gjatë vitit janë bërë ndryshime (shtesa) në buxhetin e shpenzimeve administrative të Aparatit të ISSH, të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm, në vlerën prej 382,731 mijë lekë, ose shtuar në masën 10% të planit fillestar, si më poshtë:

- Paga, Shpërblime dhe Shpenzime të tjera personeli (600) shtuar për 59,460 mijë lekë;
- Kontribute për sigurime shoqërore (601), shtuar për 7,000 mijë lekë;
- Mallra e shërbime të tjera (602), shtuar për 2,464 mijë lekë, ndërsa rezulton me kursim në shumën 69 mijë lekë, që vjen kryesisht nga kursimi i realizimit të procedurave të prokurimeve me vlerë të vogël. Për këtë zë konstatohet se shtesa është e pajustificuar pasi realizimi është më pak se plani fillestar për 66,409 mijë lekë dhe për 68,873 mijë lekë se plani përfundimtar.
- Shpenzimet për rritjen e investimeve (230+231) nuk çelen që në fillim të vitit tek njësia e Aparatit, por ato çelen në Buxhetin e Përgjithshëm (të parashikuara në PBA e njësisë) dhe alokohen gjatë vitit me miratim të Drejtorit të Përgjithshëm, sipas kërkesave të argumentuara.
- Shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (230), edhe pse nuk është parashikuar asnjë fond në planin fillestar (sepse plani i këtij zëri është parashikuar tek Buxheti i Përgjithshëm, përmirësim i Sistemit të IT në ISSH), është realizuar për vlerën 259,639 mijë lekë ose në masën 98%.
- Shpenzimet për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara (231), edhe pse nuk është parashikuar asnjë fond në planin fillestar (sepse plani i këtij zëri është parashikuar tek Buxheti i përgjithshëm), ky zë është realizuar për vlerën 36,119 mijë lekë ose në masën 72 %, si rezultat i kursimit të shpenzimeve rreth 30%, nga procedurat e prokurimeve për investimet.

Nga analiza dhe auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të Aparatit rezultoi se, shpenzimet janë realizuar brenda fondit limit të miratuar në buxhetin e vitit 2023, pra shpenzimet janë realizuar në masën 88% kundrejt planit përfundimtar.

2.5.5. Monitorimi i Buxhetit

Referuar Udhëzimit nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore” ISSH ka hartuar tre raporte të monitorimit të performancës/produkteve të programit Sigurime Shoqërore. Raporti për 4 mujorin e parë i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 4653/1 prot. datë 24.05.2023, raporti për 8-mujorin 2022 është përcjellë me shkresën nr. 7380 prot. datë 12.09.2023 dhe raporti vjetor 2023 është përcjellë me shkresën nr. 3590 prot. datë 12.03.2024. Raportet janë dorëzuar brenda afateve të përcaktuara në udhëzim.

Përsa më sipër mbajtur Akt konstatim nr.5 datë 19.07.2024 protokolluar në ISSH me nr.8025 prot; datë19.07.2024, për të cilën nuk ka observacion.

2.6. Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore.

Në zbatim të pikës mësipërme u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Tiranë, Dosjet e punonjësve të vlerësimet e punës, trajnimet, përkrahjet e punës, rekrutime, Rregullorja e Brendshme e ISSH, Data baza e vendimeve gjyqësore,

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, është një institucion publik, i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është e organizuar në tri nivele drejtimi: Drejtoria Qendrore, 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, dy Degë të Sigurimeve Shoqërore për shkak të largësisë nga qendra, Drejtoria e Arkivit Qendror të Sigurimeve Shoqërore.

Struktura Organizative e Institutit të Sigurimeve Shoqërore është miratuar me VKA nr. 3, datë 26.02.2008 “Për miratimin e Strukturës Organizative të ISSH-së, miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve në ISSH dhe miratimin e Rregullores së Personelit”, VKA nr. 3/1 “Për miratimin e Strukturës Organizative të ISSH-së dhe miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të ISSH-së dhe VKA nr. 3/2 “Për personelin e ISSH” i ndryshuar me VKA nr. 5, datë 14.08.2020.

Me VKA nr.2, datë 18.03.2022 “Për një shtesë në numrin e përgjithshëm të punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe ndryshime në strukturën organizative të ISSH-së”, mbështetur në nenin 74, shkronja b/1 të ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, VKM nr. 618, datë 20.10.2021, “Për krijimin, Organizimin dhe Funksionimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”, numri total i punonjësve në ISSH u bë 1338 punonjës pasi u shtua një pozicion në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së si “Koordinator kundër Korrupsionit”.

Me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.6714 prot, datë 07.10.2022, janë bërë ndryshime në Strukturën Organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH-së ku:

- Pakësohet një vend pune si specialist në sektorin e përfitimeve afatgjata pranë Drejtorisë së Përfitimeve.

- Shtohet një vend pune si specialist në sektorin e menaxhimit të sistemeve HRMIS në sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve pranë Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm.

Struktura organizative Janar- Dhjetor 2023, vijon me strukturën e miratuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.6714 prot, datë 07.10.2022.

Struktura	Nr. i punonjësve viti 2023
Drejtori i Përgjithshëm	1
Koordinator kundër Korrupsionit	1
Zëvendësdrejtor	3
Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm	5

Drejtoria e Burimeve të Informacionit	10
Drejtoria e Financës	19
Drejtoria e Kontributeve	12
Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm	27
Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun	12
Drejtoria e Përfitimeve	21
Njësia e Inspektimit të Përfitimeve	20
Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	9
Drejtoria Juridike	9
Drejtoria e Integritimit	9
Totali	158

Me Vendimin nr. 13, datë 29.12.2023, “Për miratimin e Strukturës Organizative të ISSH-së dhe miratimin e numrit të përgjithshëm të punonjësve të ISSH-së” është vendosur miratimi i Strukturës Organizative të ISSH-së si dhe miratimi i numrit të përgjithshëm të punonjësve të ISSH-së që do të jetë 1271 punonjës.

• **Vendet e lira të punës.**

Nga auditimi u konstatuan se gjatë vitit 2023 ka patur vende të lira, të cilat nuk janë publikuar në faqen ëeb të institucionit, veprime këto në kundërshtim me VKA nr. 3/2 “Për personelin e ISSH” i ndryshuar me VKA nr. 5, datë 14.08.2020, Kreu nr. 4, “Shpallja e konkurrimit”, Pika nr. 4.2, “Publikimi elektronik i të gjithë informacionit që i përket rekrutimit të personelit nëpërmjet konkurrimit të hapur, realizohet në faqen zyrtare të ISSH-së dhe në stendat e informimit publik.”, si më poshtë vijon:

KABINETI I DREJTORIT TE PERGJITHSHEM		
Asistente e Drejtorit te Përgjithshëm	1	VAKANT
DREJTORIA E FINANCËS		
Përgjegjës Sektori	1	VAKANT
DREJTORIA E PËRFTIMEVE		
Specialist/mjek	1	VAKANT
DREJTORIA E INSPEKTIMIT TË PËRFTIMEVE		
Specialist	1	VAKANT
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM		
Auditues	1	VAKANT
Auditues	1	VAKANT
Specialist/Auditues	1	VAKANT
DREJTORIA E INTEGRIMIT, MARRËVESHJEVE, REFORMAVE DHE KËRKIMIT SOCIAL		
Përgjegjës Sektori	1	VAKANT
Specialist për kërkimin social	1	VAKANT
TOTAL	9	VAKANT

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve.

Struktura	Nr. i punonjësve viti 2023
Nr. Total i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH	158
Nr total i vakancave në dhjetor 2023	9

Burimi i të dhënave: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve.

Kontratat e Punës

Marrëdhëniet e punës në këtë institucion rregullohen sipas Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, i ndryshuar. Grupi i auditimit përzgjedhi 20 kontrata individuale të punës të punonjësve pjesë e strukturës së ISSH. U konstatua që Kontratat Individuale të Punës ishin pjesë e dosjeve personale të punonjësve, i përfshijnë elementët e nevojshëm sipas kërkesave ligjore, si dhe ishin të firmosura nga të dyja palët, punëdhënësi e punëmarrësi.

Emërimet

Gjatë vitit 2023 në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së janë kryer 5 emërimet, ndër të cilat 4 punonjës fillimisht janë komanduar në pozicionin vakant dhe më pas i është bërë emërimi në përputhje me kriteret e përcaktuara për secilin pozicion vakant, ndërsa një emërim në pozicionin e “Koordinatorit kundër Korrupsionit” sipas VKM nr. 618, datë 20.10.2021, “Për krijimin,

Organizimin dhe Funksonimin e Rrjetit të Koordinatorëve kundër Korrupsionit”

Tre emërimet në pozicionet vakante janë bërë pas procedurës së konkurrimit ndërsa një emërim me vlerësim dosje pasi pozicioni vakant ishte për shërbimet mbështetëse, (Roje).

Përsa i përket emërimeve të kryera gjatë vitit 2023 u konstatua se për dy vendet vakante Specialist në Sektorin e Inspektimit/ Drejtoria e Inspektimit, fillimisht është bërë komandimi i specialistëve dhe më pas është bërë shpallja e vendeve vakante dhe konkurrimi po nga këto dy specialist. Konkretisht; - H.F, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 105, datë 29.05.2023, është komanduar në pozicionin Specialist në Sektorin e Inspektimit/ Drejtoria e Inspektimit, dhe marrëdhënia me pagën i ka filluar më datë 01.06.2023 Më datë 21.06.2023, Bazuar në Urdhërin nr. 5527 Prot; datë 21.06.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit, nëpërmjet konkurrimit të hapur”, ISSH bën shpalljen e vendit të lirë të punës për pozicionin: Specialist, Sektori i Inspektimit të përfitimeve të invaliditetit dhe familjare. 2 vende pune Testimi me shkrim në ambientet e ISSH-së më datë 11.07.2023.

Intervista me gojë në ambientet e ISSH-së më datë 14.07.2023.

- A.B, me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 105, datë 29.05.2023, është komanduar në pozicionin Specialist në Sektorin e Inspektimit/ Drejtoria e Inspektimit, dhe marrëdhënia me pagën i ka filluar më datë 01.06.2023 Më datë 21.06.2023, Bazuar në Urdhërin nr. 5527 Prot; datë 21.06.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm të Institutit të Sigurimeve Shoqërore “Për hapjen e procedurës së rekrutimit të personelit, nëpërmjet konkurrimit të hapur”, ISSH bën shpalljen e vendit të lirë të punës për pozicionin: Specialist, Sektori i Inspektimit të përfitimeve të invaliditetit dhe familjare. 2 vende pune Testimi me shkrim në ambientet e ISSH-së më datë 11.07.2023.

Intervista me gojë në ambientet e ISSH-së më datë 14.07.2023.

Largimet

Gjatë vitit 2023 janë kryer **6 largime** nga detyra, nga të cilët:

- katër punonjës me dorëheqje,
- një punonjës dalje në pension,
- një punonjës masë disiplinore sipas pikës 6.2 të “Rregullores së Personelit të ISSH-së”, gërma “c”, “Konkludohet paaftësia për të kryer detyrat, të paktën pas dy vlerësimeve negative të njëpasnjëshme të rezultateve të punës”.

Rregullorja

Gjatë vitit 2023, ISSH ka funksionuar mbi bazën e Rregullores për Organizimin dhe Funksonimin e ISSH e marsit të vitit 2018, rregullore kjo e pa miratuar nga Këshilli Administrativ i ISSH-së, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 7303 “Për Sigurimet Shoqërore në republikën e Shqipërisë”, neni nr. 74 “Kompetencat e Këshillit Administrativ”, pika 1/e “Miraton rregulloret e propozuara nga Drejtori i Përgjithshëm, sipas përgjegjësive që përcaktohen nga Ligji dhe statuti, dhe që kanë të bëjnë me çështje financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore”.

Këshilli Administrativ me VKA nr. 13, date 28.12.2023” “Për miratimin e Strukturës Organizative dhe numrin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore” ka miratuar strukturën e re organizative të ISSH-së, shoqëruar me procesin e ristrukturimit të institucionit.

Gjithashtu grupi i auditimit ka konstatuar se në kuadër të ndryshimeve ligjore lidhur me ofrimin e shërbimeve online, mbylljene sporteleve dhe njëkohësisht edhe me ndryshimin e proceseve të punës, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore nuk janë marrë masa për një organizim të brendshëm të ISSH-së dhe ndryshim të strukturave organizative aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorive Rajonale, Degëve të Sigurimeve Shoqërore si dhe Drejtorisë së Arkivit Qëndror të Sigurimeve Shoqërore.

Konkluzion: *Institutit të Sigurimeve Shoqërore duhet të marrë masa për një organizim të brendshëm të ISSH-së dhe ndryshim të strukturave organizative aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorive Rajonale, Degëve të Sigurimeve Shoqërore si dhe Drejtorisë së Arkivit Qëndror të Sigurimeve Shoqërore dhe rrjedhimisht edhe të Rregullores së ISSH-së “Për Organizimin dhe Funksonimin e ISSH-së”.*

Listë prezenca dhe listëpagesat

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se Listë Prezenca nuk

përpilohet dhe firmoset nga Drejtorët e Drejtorive apo përgjegjësat e sektorëve, (Menaxherët e sektorëve përkatës) veprime këto në kundërshtim me *Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika nr. 69*, dhe se formati i listë pagesës së pagave të ISSH, nuk rezulton të jetë plotësisht në përputhje me udhëzimin e përbashkët të MFE dhe DAP nr. 1, datë 21.05.2021, pasi në listë pagesat mujore të audituara, mungojnë kolona e "Të ardhura të tjera", "Kategoritë" dhe "klasat" e punonjësve, etj.

Gjithashtu nga auditimi u konstatua se listë pagesat përgatiten nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm por pas kryerjes të tyre nuk bëhet një kontroll i menjëhershëm nga Drejtoria e Financës, veprime këto që sjellin mosrakordim midis listëpagesës, urdhër shpenzimeve dhe deklarimin e listëpagesës së sigurimeve shoqërore në sistemin elektronik të tatimeve.

Raste të mosrakordimit të veprimeve midis urdhër shpenzimeve dhe deklarimin e listëpagesës së sigurimeve shoqërore në sistemin elektronik të tatimeve të konstatuara nga grupi i auditimit mund të përmendim muajin Janar 2023 ku totali i listëpagesës rezulton 10,815,158 lekë, por totali i transfertave të kryer në bankat e nivelit të dytë në të cilat kryhet paga e punonjësve ishte:

Banka B 10,309,357 lekë, T. B 183,319 lekë, C. B 523,236 lekë për një total 11,015,912 lekë. Pra rezulton një diferencë $11,015,912 - 10,815,158 = 200,754$ lekë. Kjo diferencë rezulton pas sistemimit që është bërë për tatimin mbi të ardhurat i cili nuk u ishte mbajtur punonjësve të Drejtorisë së përgjithshme të ISSH-së për shpërblimin prej 10,000 lekë të përfituara në muajin dhjetor të vitit 2022. Gjithashtu, raste të mosrakordimit të veprimeve midis urdhër shpenzimeve dhe deklarimin e listëpagesës së sigurimeve shoqërore në sistemin elektronik të tatimeve të konstatuara nga grupi i auditimit mund të përmendim listëpagesat për muajin Qershor 2023 në të cilat ka patur shumë pasaktësi të cilat janë sistemuar në listëpagesat e muajit Korrik.

Konkluzion: *Listë Prezenca nuk përpilohet dhe firmoset nga Drejtorët e Drejtorive apo përgjegjësat e sektorëve, (Menaxherët e sektorëve përkatës), veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika nr. 69, "Listëpagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listëprezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij."*

Gjithashtu, formati i listë pagesës së pagave të ISSH nuk rezulton të jetë në përputhje me udhëzimin e përbashkët të MFE dhe DAP nr. 1, datë 21.05.2021.

Gjithashtu, u konstatua se listë pagesat përgatiten nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm dhe mungon një kontroll apo verifikim i menjëhershëm nga Drejtoria e Financës, veprime këto që mund të sjellin mosrakordim midis listëpagesës, urdhër shpenzimeve dhe deklarimin e listëpagesës së sigurimeve shoqërore në sistemin elektronik të tatimeve. Këto veprime gjithashtu janë në kundërshtim me Urdhërin e Brendshëm nr. 1298, datë 16.02.2018, Pika nr. 9, "të gjitha ndalesat si, ndalesë telefoni, ndalesë debitore, sistemin në rast llogaritje page gabim, etj., përpilohen nga dega e financës, nënshkruhet prej tyre dhe dërgohen për tu hedhur si impute të veçanta nga jashtë në kollonat respektive sipas Kodeve nga personeli përgjegjës i degës së Administrimit."

Vlerësimi i performancës së punonjësve

Vlerësimi i punonjësve për vitin 2023 është kryer brenda afatit të caktuar sipas rregullores datë 10.02.2020 dhe është depozituar në dosjet personale të secilit punonjës. Ky vlerësim ka një format tip, në të cilin punonjësit janë vlerësuar me pikë. Shkalla më e lartë e vlerësimit është 100 pikë.

Trajnimet

Trajnimet e realizuara nga stafi i ISSH-së gjatë vitit 2023.

Me Urdhër nr. 232/2, datë 16.01.2023, është miratuar programi vjetor 2023 i trajnimeve për stafin e ISSH-së, nr. 323 prot; datë 16.01.2023 si më poshtë vijon:

Gjatë vitit 2023 është arritur të trajnohen rreth **299 punonjës** të sistemit të Sigurimeve Shoqërore si dhe të gjithë të punësuarit e rinj në sistemin e Sigurimeve Shoqërore. Aktivitetet trajnuese janë kryer në ambientet e ISSH-së me specialistë të degëve të ndryshme nga të gjitha DRSSH-të, sipas temave dhe target grupeve të caktuara në Programin Vjetor 2023.

Ndër aktivitetet trajnuese më të rëndësishme të realizuara gjatë vitit 2023, mund të përmendim:

1. “Njohja dhe zbatimi rregullores së personelit dhe rregullores së përshkrimit të vendit të punës. Mbi Kodin Etik dhe Konfliktin e interesit në ushtrimin e detyrave të punonjësve në sistemin e sigurimeve shoqërore. Njohja dhe zbatimi i ligjit për prokurimet publike. Roli i prokurimit, parimet themelore dhe procedurat e prokurimit publik. Unifikimi i procedurave të prokurimit publik në DRSSH” zhvilluar më datë 28 dhjetor 2023 në ambientet e ISSH-së. Morën pjesë 31 persona.
2. “Upgrade i Sistemit të kontabilitetit (Oracle Financials) për Institutin e Sigurimeve Shoqërore”, zhvilluar më datë 17/21 dhe 22 nëntor 2023 në ambientet e ISSH-së. Morën pjesë 66 persona.
3. “Njohja dhe zbatimi i bazës ligjore dhe nënligjore në fuqi. Njohja dhe zbatimi i Rregullores për të vetëpunësuarit në bujqësi, me ndryshimet përkatëse. “Unifikim i praktikave”, zhvilluar më datë 27.06.2023 në ambientet e ISSH-së. Morën pjesë 31 persona.
4. “Kuptimi dhe zbatimi i ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe të akteve të tjera nënligjore që kanë lidhje me sigurimin vullnetar. Bashkëveprimi i punonjësit të sigurimit vullnetar me inspektorin pritës të përfitimeve. Praktika me probleme të hasura gjatë vitit, procedurat e ndjekura deri në zgjidhjen përfundimtare të problemit, në favor të klientit të skemës vullnetare. Baza e të dhënave”, zhvilluar më datë 27.04.2023 në ambientet e ISSH-së. Morën pjesë 28 persona.
5. “Zbatimi i neneve 12,13 të Normave tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe Rregullores së njehsuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë miratuar me Vendim nr. 4, datë 19.06.2017, në trajtimin e dokumenteve administrative”, zhvilluar më datë 13.03.2023 në ambientet e ISSH-së. Morën pjesë 44 persona.

Konkluzion: Sikurse konstatohet, gjatë vitit 2023 është arritur të trajnohen rreth **299 punonjës** të sistemit të Sigurimeve Shoqërore, nga 995 punonjës specialistë të cilët janë të punësuar në sistemin e ISSH-së, (ISSH në total ka të punësuar 1329 punonjës nga të cilët punonjës të shërbimeve mbështetëse janë 85, inspektor bujku 205 dhe 44 pritës në sportelet e agjencive lokale), veprim në kundërshtim me Rregulloren e Personelit, kapitulli nr. III, “Koha e punës dhe pushimit”, pika nr. 3 “Trajnimet”, gërma b) “Trajnimet profesionale individuale” e cila thotë “sektori përgjegjës në ISSH duhet të sigurojë për çdo punonjës të paktën një trajnim në vit, në përputhje me planin vjetor”.

Vendimet gjyqësore që ndiqen dhe ekzekutohen nga ISSH.

Nga auditimi i vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, u konstatua se ISSH ka ekzekutuar 7 vendime gjyqësore me vlerë 6,015,538 lekë për ish-punonjësit e saj, të cilët kanë qenë të punësuar në ISSH. Shpenzimet përmbartimore për këto procese gjyqësore të likuiduara nga ISSH, për vitin 2023 kanë qenë 91,350 lekë, shumë që konsiderohet si shpenzim pa efektivitet për fondet e buxhetit të shtetit.

Të detajuara paraqiten të dhënat në rubrikën Aneks, Tabela nr. 1: Vendimet gjyqësore me objekt "Dëshmipërblim page" për vitin 2023, pjesë e këtij Raporti.

Për sa më sipër është mbajtur Akt Konstatimi nr.9 , datë 19.07.2024, protokolluar në ISSH me nr.8029 prot; datë 19.07.2024.

2.7. Mbi procedurat e prokurimit me fonde publike dhe zbatimin e kontratave

Në zbatim të pikës mësipërme u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Regjistrat e planifikimit dhe realizimit të prokurimeve për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023.
2. Urdhrat për ngritjen e komisioneve të prokurimeve me vlera të vogla për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023.
3. Procedurat e prokurimeve me vlera të vogla me zgjedhje për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023.
4. Dokumentacion plotësues/justifikues si fatura, transaksione bankare, fletë-hyrje në magazinë etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar dhe aksesit në sistemin e Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) rezultoi se:

Për periudhën 01.01.2023 – 31.12.2023, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka realizuar gjithsej 32 procedura prokurimi me vlera të vogla, me fond limit 10,840,000 lekë pa TVSh dhe me vlerë kontrate realizuar në shumën 7,155,782 lekë pa TVSh, nga të cilat 5 procedura janë blerje nën 100,000 lekë. Nga 32 procedura të realizuara, u përzgjedhën për auditim 16 procedura me fond limit në shumën 6,314,400 lekë pa TVSh ose në masën 58% të vlerës totale të fondit limit, ku rezultoi se:

Për vitin 2023 janë realizuar 2 procedura prokurimi me vlera të vogla me një fond limit total në shumën 1,468,000 lekë pa TVSh, të cilat i përkasin të njëjtit objekt prokurimi “Kërkesë për shtypshkrime”. Pra janë shmangur procedurat normale të prokurimit duke copëzuar fondin limit. Konkretisht, dy procedura prokurimi;

“Blerje Artikuj të Kancelarisë me Logon e ISSH-së për vitin 2024” me urdhër prokurimi nr. 10321/1 datë 11.12.2023 me fond limit 485,000 lekë.

“Shtypshkrime për Drejtorinë e Kontributeve për Sektorin e të Vetëpunësuarve në Bujqësi dhe Sigurimit Vullnetar”, me urdhër prokurimi nr. 4092 datë 10.05.2023 me fond limit 983,000 lekë.

Konkluzion: Për sa më sipër të dy këto procedura i përkasin të njëjtit objekt prokurimi, “Kërkesë për shtypshkrime”, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56;

- pika 1, “Autoriteti/enti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/ shërbime, kur vlera e përlllogaritur është ndërmjet kufijve nga 100,000 (njëqind mijë) lekë deri në 1,000,000 (një milionë) lekë në vit;

- pika 2, “Autoriteti/enti kontraktor planifikon natyrën, sasinë dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi. Për përcaktimin e kufirit monetar për këtë procedurë llogariten grup – mallrash apo shërbimesh të ngjashme, të cilat zakonisht prokurohen njëherësh dhe, në asnjë rast, nuk duhet të ndahen për përdorimin e kësaj procedure.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

- Me Urdhërin nr. 441, datë 19.01.2023 të Drejtorit të përgjithshëm, z. A. H, “Për krijimin e Komisionit të Blerjeve me Vlerë të Vogël”, është krijuar komisioni me përbërje si më poshtë:

1. E. P. Kryetar
2. N. Ç. Anëtar
3. B. D. Anëtar

Ky komision është i njëjtë edhe për sistemin dinamik të biletave të transportit ajror.

Me përzgjedhje u audituan 16 procedura prokurimit me vlerë të vogël si më poshtë:

Viti 2023					
Nr.	Objekt	Fondi limit	Vlera e kontratës	OE i shpallur fitues	Publikuar në APP
1	Shpenzime udhëtimi (Blerje bileta avioni)	2,000,000	94,770	O.T.T	03.03.2023
2	Shpenzime udhëtimi (Blerje bileta avioni)		74,000	E.T.T	17.05.2023
3	Shpenzime udhëtimi (Blerje bileta avioni)		319,200	K.T	19.05.2023
4	Shpenzime udhëtimi (Blerje bileta avioni)		148,400	E.T.T	11.10.2023
5	Shpenzime udhëtimi (Blerje bileta avioni)		70,750	A.T.T	11.10.2023
6	Shpenzime udhëtimi (Blerje bileta avioni)		183,000	A.T.T	03.11.2023
7	Shpenzime udhëtimi (Blerje bileta avioni)		418,482	G.T	20.11.2023
8	Shpenzime udhëtimi (Blerje bileta avioni)		223,492	A.T.H. S	17.11.2023
9	Riparim/Shërbim për automjetet	200,000	189,600	A. SH.A.	25.04.2023
10	Riparim/Shërbim për automjetet	20,900	18,800	L.S ShPK	13.11.2023
11	Blerje Materiale Kancelarie	400,000	321,700	I.O	03.10.2023
12	Blerje Materiale Pastrimi	870,500	560,000	M.V	29.09.2023
13	Shërbim Printimi dhe Fotokopjimi	395,000	385,000	T.E	05.10.2023
14	Blerje Artikuj të Kancelarisë me Logon e ISSH-së	485,000	380,000	E.V.A	15.04.2023
15	Shtypshkrime për Drejtorinë e Kontributeve për Sektorin e të Vetëpunësuarve në Bujqësi dhe Sigurimit Vullnetar	983,000	773,000	K. KH	15.05.2023

16	Blerje Karburanti	960,000	950,000	O	21.02.2023
Totali		6,314,400	5,110,194		

Burimi të dhënave: ISSH përpunuar grupi auditimit KLSH

Grupi i auditimit me përzgjedhje auditoi dosjet e prokurimit të procedurave me vlerë të vogël si më poshtë:

1. Me Urdhër Prokurimi nr. 1738/2, datë 02.03.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar Komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N.Ç. dhe z. B. D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Blerje biletash transporti ajror me sistemin e thjeshtuar dinamik”** me intinerar Tiranë – Bruksel – Tiranë për dy persona, si më poshtë:

Nisja Tiranë – Bruksel datë 08.03.2023

Kthimi Bruksel – Tiranë datë 10.03.2023

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 03.03.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “O.T.T” i renditur i dyti në klasifikim.

Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 03.03.2023 rezulton se operatori i renditur në vendin e parë, “S.T.T” është eliminuar pasi nuk i është përgjigjur autoritetit Kontraktor pas publikimit si fitues në sistem. Operatori “S.T.T” nuk ka dërguar as njoftim për tërheqje.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 944/2023, datë 06.03.2023, në shumën 94,770 lekë, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 09.05.2023.

2. Me Urdhër Prokurimi nr. 4305/2, datë 17.05.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A. H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar Komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar i përbërë nga z. E. P. (kryetar i komisionit), znj. N.Ç. dhe z. B. D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“blerje biletash transporti ajror me sistemin e thjeshtuar dinamik”** me intinerar Tiranë – Bruksel – Tiranë për një person si më poshtë:

Nisja Tiranë – Bruksel datë 22.05.2023

Kthimi Bruksel – Tiranë datë 25.05.2023

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 17.05.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “E.T.T” i renditur i pari në klasifikim.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 530/2023, datë 18.05.2023, në shumën 74,000 lekë, e anuluar nga vetë subjekti me faturën nr. 531/2023, datë 19.05.2023, në shumën -74,000 lekë.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 532/2023, datë 19.05.2023, në shumën 45,200 lekë, e anuluar nga vetë subjekti me faturën nr. 533/2023, datë 19.05.2023, në shumën -45,200 lekë.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 536/2023, datë 25.05.2023, në shumën 61,325 lekë, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 03.08.2023 në shumën 45,200 lekë dhe më datë 08.08.2023 në shumën 16,125 lekë.

3. Me Urdhër Prokurimi nr. 4874/2, datë 02.06.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar Komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar i përbërë nga z. E. P. (kryetar i komisionit), znj. N.Ç. dhe z. B. D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“blerje biletash transporti ajror me sistemin e thjeshtuar dinamik”** me intinerar Tiranë – Luksemburg – Tiranë për tre persona, si më poshtë:

Nisja Tiranë – Luksemburg datë 07.06.2023

Kthimi Luksemburg – Tiranë datë 10.06.2023

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 02.06.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “A.T.T” i renditur i dyti në klasifikim.

Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 02.06.2023 rezulton se operatori i renditur në vendin e parë, “K.T” është tërhequr me kërkesë në sistem.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 620/2023, datë 02.06.2023, në shumën 319,200 lekë, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 03.07.2023.

4. Me Urdhër Prokurimi nr. 8312/2, datë 11.10.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar Komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N.Ç. dhe z. B.D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“blerje biletash transporti ajror me sistemin e thjeshtuar dinamik”** me intinerar Tiranë – Bon – Tiranë për dy persona, Tiranë – Bon për një person si dhe Bon – Beograd për një person si më poshtë;

Nisja Tiranë – Bon datë 15.10.2023 për tre persona

Kthimi Bon – Tiranë datë 18.10.2023 për dy persona

Intinerar Bon – Beograd datë 17.10.2023 për një person

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 11.10.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “E.T.T” i renditur i pari në klasifikim.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 1005/2023, datë 12.10.2023, në shumën 148,400 lekë, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 16.10.2023.

5. Me Urdhër Prokurimi nr. 8318/2, datë 11.10.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar Komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N.Ç. dhe z. B.D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“blerje biletash transporti ajror me sistemin e thjeshtuar dinamik”** me intinerar Tiranë – Beograd – Tiranë për dy persona dhe Beograd – Tiranë për një person si më poshtë:

Nisja Tiranë – Beograd datë 16.10.2023 për dy persona

Kthimi Beograd – Tiranë datë 19.10.2023 për tre persona

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 11.10.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “A.T.T” i renditur i dyti në klasifikim.

Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 11.10.2023 rezulton se operatori i renditur në vendin e parë, “O.T.T” është tërhequr me kërkesë në sistem.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 1049/2023, datë 11.10.2023, në shumën 70,750 lekë, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 16.10.2023.

6. Me Urdhër Prokurimi nr. 9193/2, datë 03.11.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar Komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N.Ç. dhe z. B.D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“blerje biletash transporti ajror me sistemin e thjeshtuar dinamik”** me intinerar Tiranë – Varshavë – Tiranë për katër persona, si më poshtë:

Nisja Tiranë – Varshavë datë 07.11.2023

Kthimi Varshavë – Tiranë datë 10.11.2023

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 03.11.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “A.T.T” i renditur i pari në klasifikim.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 1154/2023, datë 03.11.2023, në shumën 183,000 lekë, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 08.11.2023.

7. Me Urdhër Prokurimi nr. 9619/2, datë 17.11.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar Komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N.Ç. dhe z. B.D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“blerje biletash transporti ajror me sistemin e thjeshtuar dinamik”** me intinerar Tiranë – Mexico City – Tiranë për tre persona, si më poshtë:

Nisja Tiranë – Mexico City datë 02.12.2023

Kthimi Mexico City – Tiranë datë 08.12.2023

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 20.11.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “G.T” i renditur i dyti në klasifikim.

Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 02.06.2023 rezulton se operatori i renditur në vendin e parë, “A” është tërhequr me kërkesë në sistem.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 1087/2023, datë 22.11.2023, në shumën 418,482 lekë, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 06.12.2023.

8. Me Urdhër Prokurimi nr. 9687/1, datë 17.11.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar Komisioni i Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar i përbërë nga z. E. P. (kryetar i komisionit), znj. N.Ç. dhe z. B. D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“blerje biletash transporti ajror me sistemin e thjeshtuar dinamik”** me intinerar Tiranë – Sydney – Tiranë për një person, si më poshtë:

Nisja Tiranë – Sydney datë 24.11.2023

Kthimi Sydney – Tiranë datë 30.11.2023

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 17.11.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “A.T.H.S” i renditur i pari në klasifikim.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 5547/2023, datë 20.11.2023, në shumën 223,492 lekë, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 21.11.2023.

Konkluzion: Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit me anë të Sistemit Dinamik të Biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar rezulton se në të gjitha këto procedura ka mangësi dokumentacioni si më poshtë vijon:

- *Ftesa për pjesëmarrjen në takimin e organizuar është në gjuhën angleze dhe jo në gjuhën shqipe, veprime këto në kundërshtim me VKM 258, “Për miratimin e rregullave të prokurimit”, neni nr. 24, “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët”, pika nr. 2, “Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht”.*

-Në procedurën e prokurimit me nr. 4305/2, datë 17.05.2023, me fitues OE “E.T.T”, rezulton se është shpallur fitues me ofertën 74,000 lekë, por nga ana e Autoritetit Kontraktor (ISSH) është likuiduar vetëm 61,325 lekë pa asnjë argumentim dhe pa asnjë procesverbal ku të sqarohen arsyet e këtij ndryshimi, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 162 “Për Prokurimin Publik” si dhe në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

9. Me Urdhër Prokurimi nr. 3279, datë 14.04.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A. H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N.Ç. dhe z. B.D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Riparim/Shërbim për automjetet me targa AA 165 VX, AA 166 VX, AA 592 PM, AA 593 PM”**.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Sipas procesverbalit të mbajtur datë 12.04.2023 mbi përlllogaritjen e fondit limit janë marrë për bazë çmimet e kontratës së prokurimit të kryer një viti më parë duke mos i shtuar as përqindjen e normës së inflacionit të INSTAT.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 25.04.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “A SH.A.” i renditur i treti në klasifikim me shumën 189,600 lekë pa TVSH.

Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 24.04.2023 rezulton se operatori i renditur në vendin e parë, “T” është tërhequr me kërkesë në sistem.

Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 25.04.2023 rezulton se operatori i renditur në vendin e dytë, “O.M” është tërhequr me kërkesë në sistem.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 678/2023, datë 03.05.2023 për automjetin me targë AA 166 VX, në shumën 50,304 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 02.06.2023.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 669/2023, datë 05.05.2023 për automjetin me targë AA 165 VX, në shumën 32,630 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 02.06.2023.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 668/2023, datë 03.05.2023 për automjetin me targë AA 593 PM, në shumën 48,960 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 06.06.2023.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 808/2023, datë 23.05.2023 për automjetin me targë AA 592 PM, në shumën 47,625 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 06.06.2023.

10. Me Urdhër Prokurimi nr. 9238/1, datë 07.11.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N. Ç. dhe z. B.D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Riparim/Shërbim për automjetin me targa AA 165 VX”**.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 17.11.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “L.S” ShPK i renditur i dyti në klasifikim me shumën 18,800 lekë pa TVSH.

Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 24.04.2023 rezulton se operatori i renditur në vendin e parë, “C” është tërhequr me kërkesë në sistem pasi nuk përmbush specifikimet teknike.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 1/2023, datë 23.11.2023 në shumën 22,560 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 18.01.2024.

11. Me Urdhër Prokurimi nr. 7594/1, datë 02.10.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N. Ç. dhe z. B.D. (anëtarë), i cili ka

filluar procedurën me objekt **“Blerje Materiale Kancelarie”**.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Sipas procesverbalit të mbajtur datë 25.09.2023 mbi përlllogaritjen e fondit limit janë marrë për bazë çmimet e kontratës së prokurimit të kryer një viti më parë duke i shtuar 4% të inflacionit të marrë sipas INSTAT.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 03.10.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “I.O” i renditur i pari në klasifikim me shumën 321,700 pa TVSH.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 14466/2023, datë 11.10.2023 në shumën 386,040 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 26.10.2023.

12. Me Urdhër Prokurimi nr. 7595/1, datë 27.09.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N. Ç. dhe z. B.D. (anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Blerje materiale pastrimi.”**

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Sipas procesverbalit të mbajtur datë 25.09.2023 mbi përlllogaritjen e fondit limit janë marrë për bazë çmimet e kontratës së prokurimit të kryer një viti më parë duke i shtuar 4% të inflacionit të marrë sipas INSTAT.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 29.09.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “M.V” i renditur i dyti në klasifikim me shumën 560,000 lekë pa TVSH.

Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 29.09.2023 rezulton se operatori i renditur në vendin e parë, “XH.N.SH.G” është tërhequr me kërkesë në sistem.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 43/2023, datë 10.10.2023 në shumën 672,000 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 16.10.2023.

13. Me Urdhër Prokurimi nr. 7939/2, datë 04.10.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N. Ç. dhe z. B.D. (anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Shërbim Printimi dhe Fotokopjimi”**.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Sipas procesverbalit të mbajtur datë 03.10.2023 mbi përlllogaritjen e fondit limit janë marrë për bazë çmimet e kontratës së prokurimit të kryer një viti më parë duke i shtuar 4% të inflacionit të marrë sipas INSTAT.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 05.10.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “T.E” i renditur pari në klasifikim me shumën 385,000 lekë pa TVSH.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 8/2024, datë 08.01.2024 në shumën 79,071 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 09.05.2024.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 140/2024, datë 23.02.2024 në shumën 51,340 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 13.05.2024.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 245/2024, datë 25.03.2024 në shumën 54,398 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 13.05.2024.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 350/2024, datë 29.04.2024 në shumën 57,984 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 09.05.2024.

Likuidimi i kësaj procedure prokurimi nuk ka përfunduar pasi nuk është kryer numri total i printimeve apo kopjove të specifikuar në ftesën për ofertë si dhe Kontratës nr. 7939/3, datë 10.10.2023.

14. Me Urdhër Prokurimi nr. 10321/1, datë 11.12.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N. Ç. dhe z. B.D. (anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Blerje Artikuj të Kancelarisë me Logon e ISSH-së për vitin 2024”**.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Sipas procesverbalit të mbajtur datë 08.12.2023 mbi përlogaritjen e fondit limit janë marrë për bazë çmimet e kontratës së prokurimit të kryer një viti më parë duke mos i shtuar as përqindjen e normës së inflacionit të INSTAT.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 12.12.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “E.V.A” i renditur pari në klasifikim me shumën 380,000 lekë pa TVSH.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 371/2023, datë 26.12.2023 në shumën 456,000 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 26.02.2024.

15. Me Urdhër Prokurimi nr. 4092, datë 10.05.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N.Ç. dhe z. B.D. (Anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Shtypshkrime për Drejtorinë e Kontributeve për Sektorin e të Vetëpunësuarve në Bujqësi dhe Sigurimit Vullnetar”**.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 15.05.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “K KH” i renditur dyti në klasifikim me shumën 737,000 lekë pa TVSH.

Sipas Procesverbalit të mbajtur datë 12.05.2023 rezultoi se operatori i renditur në vendin e parë, “F” është tërhequr me kërkesë në sistem.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 67/2023, datë 01.06.2023 në shumën 884,400 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 06.06.2023.

Konkluzion:

Nga auditimi i sa procedurave të prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël rezultoi se në 6 raste pati mungesë në dokumentacion si më poshtë vijon:

Në procedurat me Urdhër Prokurimi nr. 1738/2, datë 02.03.2023, Urdhër Prokurimi nr. 4305/2, datë 17.05.2023, Urdhër Prokurimi nr. 4874/2, datë 02.06.2023, Urdhër Prokurimi nr. 3279, datë 14.04.2023, Urdhër Prokurimi nr. 9238/1, datë 07.11.2023, Urdhër Prokurimi nr. 7939/2, datë 04.10.2023.

- Fatura tatimore nuk është likuiduar brenda afateve të përcaktuara në Ligjin nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare”, neni 7, duke sjell risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël rezultoi se në 5 raste pati mungesë në dokumentacion si më poshtë vijon:

Në procedurat me Urdhër Prokurimi nr. 3279, datë 14.04.2023, Urdhër Prokurimi nr. 7594/1, datë 02.10.2023, Urdhër Prokurimi nr. 7595/1, datë 27.09.2023, Urdhër Prokurimi nr. 7939/2, datë 04.10.2023, Urdhër Prokurimi nr. 10321/1, datë 11.12.2023,- Përcaktimi i fondit limit është bërë bazuar vetëm në një çmim referues, vetëm duke u bazuar në nenin nr. 76 të VKM nr. 285, pika c) “çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore”

dhe jo në mënyra të tjera të përllogaritjes së fondit limit, duke mos qenë kështu koherent me çmimet reale të tregut dhe duke mos iu krijuar mundësi pjesëmarrje më shumë OE, kjo në kundërshtim me Nenin nr. 13, 56 dhe 76 të VKM nr.285 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, datë 09.06.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

16. Me Urdhër Prokurimi nr. 6073/1, datë 15.08.2023, të Drejtorit të Përgjithshëm, z. A.H. në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, është urdhëruar komisioni i prokurimit për procedurat me vlera të vogla i përbërë nga z. E.P. (kryetar i komisionit), znj. N. Ç. dhe z. B.D. (anëtarë), i cili ka filluar procedurën me objekt **“Blerje Karburanti për nevojat e ISSH-së”**.

- Nga dokumentacioni vënë në dispozicion u konstatua se në këtë procedurë është nënshkruar deklarata e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të prokurimit për procedurat me vlera të vogla, veprime këto në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 13, pika 5.

- Në sistemin e prokurimit publik të APP-së më datë 15.05.2023, është shpallur fitues operatori ekonomik “O” i renditur pari në klasifikim me çmimin 158.33 lekë/litër pa TVSH.

- OE i shpallur fitues ka lëshuar faturën tatimore elektronike nr. 5088/2023, datë 12.09.2023 në shumën 570,000 lekë me TVSH, likuidimi e së cilës është bërë me Urdhër Transfertë në B më datë 18.09.2023 për 3000 litra karburant, hyrja e të cilave është bërë me fletë-hyrje nr. 15, datë 12.09.2023.

Konkluzion:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Operatori Ekonomik fitues “O”, nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar sipas Ftesës për Ofertë. Konkretisht:

- Sipas Ftesës për Ofertë OE fitues duhet të paraqesë licencën përkatëse, (të vlefshme), për ushtrim aktiviteti në tregtinë me pakicë të karburanteve për automjetet për përdorim nga konsumatorët fundor, dokument i cili nuk është bashkangjitur në dokumentacionin dorëzuar Autoritetit Kontraktor (ISSH), veprime këto në kundërshtim me Ligjit 162 “Për Prokurimin Publik”, datë 23.12.2020, neni nr. 77, pika nr. 1, Neni nr. 92 pika nr. 3 si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni nr. 56, pika nr. 4.

- Sipas Ftesës për Ofertë OE fitues duhet të paraqesë dokumentin e pronësisë apo kontratë qeraje (të vlefshme), dokument i cili nuk është bashkangjitur në dokumentacionin dorëzuar Autoritetit Kontraktor (ISSH), veprime këto në kundërshtim me Ligjit 162 “Për Prokurimin Publik”, datë 23.12.2020, neni nr. 77, pika nr. 1, Neni nr. 92 pika nr. 3 si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni nr. 56, pika nr. 4.

Konkluzion:

Të gjitha dosjet e procedurave të prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël, 16 dosjet e audituara, kanë mangësi në dokumentacionin e tyre si më poshtë vijon:

- Mungon formulari i vetë deklarimit, veprime këto në kundërshtim me në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni nr. 26.

- Nuk është hartuar Relacioni përmbledhës, veprime këto në kundërshtim me në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni nr. 2 dhe Neni 84.

- Njësia e prokurimit (funksionale) nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit dhe me nenin 74, pika 1 paragrafi 2 e VKM nr.285, datë 9.05.2021.

- Dosja e kësaj procedure nuk është e inventarizuar dhe e arkivuar, veprime këto në kundërshtim me nenin 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

Drejtoria e Përgjithshme e ISSH për vitin 2023, bazuar në të dhënat e Regjistrimit të parashikimeve dhe Regjistrimit të realizimit të ngarkuar në SPE dhe të miratuar nga Titullari, ka realizuar procedurat e prokurimit, si më poshtë:

Tabelë: Realizimi i procedurave të prokurimit viti 2023

Nr.	Procedura sipas Regjistrimit të realizimit	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës pa TVSH	Diferenca	OE Pjesëmarrës	OE kontraktuar
I	Procedura mbi 1,000,000 lekë					
1	Sigurimi i Aseteve të ISSH, DAQ-Lunder, Drejtorive Rajonale dhe Agjencive të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023	7,900,000	7,887,667	12,333	operatore pjesëmarrës 1 kualifikuar 1	Operator Fitues I. V.I. G
2	F/V i sistemit të kondicionimit të ISSH-se	20,950,000	16,323,540	4,626,460	Operatore pjesëmarrës 14 Kualifikuar 13 Skualifikuar 1	Operator fitues A. ShPK
3	Rikonstruksion i godines së ISSH-se	29,710,000	21,997,880	7,712,120	Operatore pjesëmarrës 12 Kualifikuar 12 Skualifikuar 1	A. CO

Nga auditimi ka rezultuar:

1. Procedura e prokurimit “Sigurimi i Aseteve të ISSH, DAQ-Lundër, Drejtorive Rajonale dhe Agjencive të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2023”, me fond limit 7,900,000 pa TVSH, Të dhënat mbi procedurën:

Procedura e prokurimit me objekt: “Sigurimi i asetëve të ISSH”		
1.Urdhër Prokurimi nr. 3563 datë 25.04.2023	3.Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr.3563 datë 25.04.2023 N.Ç, B.D, Jurist Anëtar E.P, Anëtar	4.KVO,Urdhërn.3563/1, datë 25.04.2023 F.F.,Kryetar L.Gj Anëtar F.Sh Anëtar
2.Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapure thjeshtuar		
5.Fondi limit pa TVSH: 7,900,000 lekë	6.O oferta fituese pa TVSH: 7,900,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit pa TVSH: 12,333 lekë
8.Data e hapjes së procedurës:30.05.2023, ora 11:00,30	9.Burimi i financimit: Buxheti i ISSH për vitin 2023	10.Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 1 (një) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S’kualifikuar: -
11.Ankimime: S’ka	12.Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje ankesës nga APP/KPP:
14.Lidhja e kontratës datë 19.09.2023	15.Vlera e kontratës: 7,887,667 lekë	16. Likuiduar brenda 15 ditëve

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga Grupi i auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

Mbi përlllogaritjen e nevojave;

Mbi përcaktimin e fondit limit dhe buxhetimin e tij;

Mbi përcaktimin e kritereve kualifikuese, hartimin dhe miratimin e DT;

Mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit;

Mbi zbatimin e kontratës.

- **Përlllogaritja e nevojave:** Nevoja për sigurimin e asetëve të ISSH cilësuar në dokumentin “Termet e referencës”, paragrafi “Qëllimi i shërbimit”, ku cilësohet: “Menaxhimi i ISSH-së ka vendosur për sigurimin e asetëve për një periudhë 1 (një vjeçare). Termet e referencës kanë për qëllim përcaktimin e kërkesave dhe kritereve që shoqëria përcakton për subjektet që do të konkurrojnë”.

- **Përlllogaritja e fondit limit,** është kryer bazuar në inventarin e asetëve të ISSH të datës 31.12.2022, sipas të cilit vlera e asetëve në total paraqitet si më poshtë:

Ndërtime konstruksione në shumën 576,535,034 lekë;

Instalime teknike, makineri, pajisje në shumën 134,065,633 lekë;

Totali në shumën 710,600,667 lekë (si dhe në analitik për çdo zë të AQT-ve, sipas institucioneve përkatëse në varësi të ISSH).

Vlera totale në shumën 710,600,667 lekë, ka shërbyer si bazë për përlllogaritjen e fondit limit, referuar nenit 34 “Përlllogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, pika 10, germa a, ku cilësohet:

“Për kontratat publike të shërbimit, baza për përlllogaritjen e vlerës së kontratës është si më poshtë, sipas rastit:

a) shërbime sigurimi: *primi që duhet paguar dhe çdo formë tjetër pagese*”.

Për përlllogaritjen e fondit limit është mbajtur procesverbali datë 20.04.2023, bazuar në termate

referencës të përcaktuara në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr. 2541, datë 27.03.2023 “Për krijimin e komisionit për hartimin e termave të referencës për tenderin me objekt “Sigurimi i aseteve”. Gjithashtu, në zbatim të VKM nr.285/2021, neni 13 “Studimi paraprak i tregut”, janë marrë oferta nga:

E, në shumën 8,150,000 lekë

I, në shumën 7,950,000 lekë

A, në shumën 7,900,000 lekë.

Njësia e prokurimit ka përcaktuar fondin limit duke ju referuar ofertës me vlerë më të ulët në shumën 7,900,000 lekë.

- Përcaktimi i kriterëve kualifikuese: Kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhespecifikimet teknike, hartimi dhe miratimi i DT.

Sipas të dhënave në SPE, nga AK janë hedhur DT, ku pjesë përbërëse janë:

Kriteret e përgjithshme

Kriteret e veçanta (kapaciteti ekonomik financiar dhe kapaciteti teknik)

Termet e referencës

Kushtet dhe termet e kontratës

Shtojcat, etj.

Përcaktimi i kriterëve kualifikuese është bërë në përputhje me llojin dhe madhësinë e objektit të prokurimit. Konkretisht:

Kriteret e përgjithshme, sipas VKM nr. 285/2021, neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” dhe neni 26 “Formulari përmbledhës i vetë deklaramit”

Janë vendosur kriteret të thjeshtuara në përputhje me nenin 55 “Procedura e hapur e thjeshtuar” e VKM nr. 285/2021, përsa ju përket kriterëve të veçanta të kualifikimit.

- Kapaciteti financiar: Xhiro vjetore jo më shumë se 40 % e fondit limit dhe Pasqyrat financiare të vitit 2021 dhe 2022.

- Kapaciteti teknik profesional: Dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe OE duhet të jetë kompani sigurimesh e pajisur me leje të vlefshme për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose ri sigurime nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ku të jenë specifikuar qartë grupet /klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender.

- Termet e Referencës Specifikimet Teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm me nr. 2541 prot; datë 27.03.2023m, i përbërë nga: L.Gj (kryetare), E.D, M.Z, E.D, E.C (anëtarë) specialistë të fushës përkatëse, në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, Nga rakordimi i vlerave të aseteve të siguruara (ndërtesa) në këtë procedurë prokurimi me ato të paraqitura në bilancin vjetor u konstatua se: vlerat e zërit “Ndërtesa” në bilancin e vitit 2022 rezulton **për 176.292.568 lekë** më shumë se sa vlerat e paraqitura pranë operatorit për tu siguruar, pra sigurimi i ndërtesave është bërë i pjesshëm dhe jo në vlerën reale të tyre, çka sjell riskun e mos sigurimit të të gjithë vlerës së ndërtesës në rast të ndodhjes së rrezikut.

-Vlerësimi i ofertave: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në SPE dhe ato të paraqitura pranë AK, nga OE “I.G” i vetmi pjesëmarrës në garë, ka rezultuar se ka plotësuar të gjitha kriteret e kualifikimit, si ato të përgjithshme, kapacitetet financiare dhe kapacitetet teknike, të përcaktuara në DT, në përputhje me Ligjin nr.162/2021, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”.

-.Zbatimi i kontratës: Nga titullari i AK, ka dalë Urdhri nr. 4467/3, datë 31.05.2023 për ngritjen e komisionit për ekzekutimin e kontratës me objekt “Sigurimi i aseteve të ISSH etj.”, për një periudhë 1 vjeçare, është hartuar dhe miratuar “Plani i zbatimit të kontratës” nr. 4467/3, datë 31.05.2023, si dhe është prerë “Polica e sigurimit”, datë 11.05.2022 e vlefshme deri më datë 05.05.2023.

2. Procedura e prokurimit “Rikonstruksion i Godinës së ISSH-së”, me fond limit 29,710,000 lekë pa TVSH, është zhvilluar referuar Ligjit 162/2021, neni 42 “Procedurë e hapur pune publike”.

Të dhënat mbi procedurën:

Procedura e prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i Godinës së ISSH –së"		
1.Urdhër Prokurimi nr. 4286 datë 16.05.2023	3.Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 4286 datë 25.04.2023 E.P Anëtar N.Ç. B. D, Anëtar	4.KVO,Urdhërn.3974/1 datë 22.05.2023 E.K Kryetare F.F Anetar L.ShAnetare
2.Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur pune publike:		
5.Fondi limit pa TVSH: 29,710,000 lekë	6. Oferta fituese pa TVSH: 21,997,880 lekë	7. Diferenca me fondin limit pa TVSH:7,712,120 mijë lekë
8. Data e hapjes së procedurës:30.06 2023, ora 11:00. ³⁰	9.Burimi i financimit: Buxheti i ISSH për vitin 2023	10.Operatorët ekonomikë d. Pjesëmarrës në tender: 12 (një) OE e. Kualifikuar:11 (një) OE f. S'kualifikuar: -1
11.Ankimime: S'ka	12.Përgjigje ankesës nga AK:	13.Përgjigje ankesës nga APP/KPP:
14.Lidhja e kontratës datë 19.09.2023	15.Vlera e kontratës: 21,997,880 lekë (pa tvsh)ose 26,375,456 lekë me tvsh	16. Likuiduar deri në datë 27.01.2024

Burimi i të dhënave: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Në procedurë kanë marrë pjesë 13 operatore, s'kualifikuar 1 operatore dhe kualifikuar 12 operatorë, operatori i parë është s'kualifikuar nga kvo, për deklarime të pa saktë lidhur me pozicionet e punës së punonjësve të deklaruar në sistemin e sigurimeve për kryerjen e punimeve objekt prokurimi.

Veprime nuk janë në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore ne RSH" i ndryshuar rezulton se subjekti me nenet 21, të ligjit 7661, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës ne RSH" i ndryshuar, dhe nenit 119 "Mos deklarimi i punonjësve dhe fshehja e pagese ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në RSH", i ndryshuar rezulton se subjekti, operatori i s'kualifikuar është tërhequr dhe nuk është ankimuar, vlerësimi ka vazhduar sipas operatoreve të radhës.

Përlllogaritja e fondit limit, fondi limit është përcaktuar në bazë të procedurës së organizuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, procedure me vlerë të vogël me objekt "Hartimi projekti për Rikonstruksionin e Godinës se ISSH-së". Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës është referuar preventivit të zbatimit te hartuar nga firma fituese e kontratës.

Hartimi i kriterëve të veçanta të DT

Për këtë procedurë prokurimi me urdhrin e prokurimit nr. 4286 datë 16.05.2023|të titullarit të autoritetit kontraktor ku është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga:

- Znj. N.Ç, Ing. Ndërtimi
- Z E.P, Ing. Ndërtimi
- Z. B.D, Jurist

Hartimi i kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit është bërë nga njësia e prokurimit, ndërsa hartimi i kriterëve të kapacitetit teknik është bërë nga specialisti i fushës E. P dhe N. Ç.

- **Nga auditimi i kriterëve të veçanta të DT u konstatua se:**

2.3.4 Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, te pajisur me dëshmi profesionale të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht si më poshtë :

- Elektracistë 2 (dy)
- Mekanik 2 (tre)
- Saldator 2 (tre)
- Murator 3 (tre)
- Hidroizolues 3 (tre)
- Punëtor/Specialist ndërtimi 4 (katër)
- Bojaxhi 4 (katër)
- Shofer 2 (dy)
- Për punonjësit e kualifikuar duhet të paraqesin:
- kontratën individuale të punës;
- një dokument që të vërtetojë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikatë/ diplomë), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të

licencuara/akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore. sipas ligjit nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R .Sh.”

Rezultoi:

- Në kriteret e veçanta të DT, pika 2.3.5 të seksionit “Kapaciteti teknik”, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të ketë një punësim jo më të vogël se 60 (tridhjetë) punonjës, për periudhën Mars-Maj 2023, nga APP është rekomanduar që për realizimin e punimeve objekt kontrate është i mjaftueshëm minimalisht 30 persona, AK ka kërkuar vërtetim të leshura nga Sigurimet shoqërore ose administratat Tatimore për periudhën Mars-Maj 2023, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

“Për çdo procedurë prokurimi ,autoriteti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:

1.argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit...”.

-nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2, ku thuhet:

Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.

2. ...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik, konkretisht neni 39, pika 6.ç, kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore. Nisur nga data e zhvillimit të tenderit, duhet që të zhvendoset periudha kohore, duke përfshirë muajin e fundit të mundshëm për deponimin e listëpagesave, për të patur një informacion sa më koherent në lidhje me këtë kriter. Punonjësit e kërkuar do të marrin pjesë në realizimin e kontratës së ardhshme e cila do të lidhet pas zhvillimit të prokurimit publik.

Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:
, duke vepruar jo në përputhje me nenin 78, pika 2 e, ku thuhet:

“Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar”. Është dokumentuar me pv por nuk është i argumentuar teknikisht.

Në Pikën 2.3.7 të kapacitetit teknik:

Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet.

Nr.	Lloji i Makinerive	Statusi	Sasia
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
2	Kamionçine minimumi 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Copë 1
3	Skela metalike minimumi 500 m2	në pronësi ose me qira	500 m2
4	Vinc karel (portativ) i levizshem me kapacitet minimumi 0.3 ton:	në pronësi ose me qira	Cope 1
5	Pajisje niveluese per nivelim shtresash	në pronësi ose me qira	Copë 1
6	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Copë 1
7	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qira	Copë 1

Nga auditimi rezultoi se:

- Kamioni me vete shkarkim me kontratë qiraje me targë AA 590 DF në lejen e qarkullimit është me kapaciteti 20 Ton, në kriter është vendosur kriteri Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës minimumi 3.5 ton.
- Mjeti kamion në leje qarkullimi 17 ton, ndërsa në kriter Kamionçinë minimumi 3.5 ton. Kërkesa të pa argumentuara teknikisht dhe ligjërish, kriteret e veçante duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës.

Vlerësimi i ofertave: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në SPE dhe ato të paraqitura pranë AK, operatori fitues, ka rezultuar se ka plotësuar kriteret e kualifikimit, si ato të përgjithshme, kapacitetet financiare dhe kapacitetet teknike, të përcaktuara në DT, në përputhje me Ligjin nr.162/2021, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”.

Zbatimi i kontratës: Nga titullari i AK, ka dalë Urdhri nr.7534/1, datë 20.09.2023, për ngritjen e komisionit për ekzekutimin e kontratës me objekt Rikonstruksioni Godinës ISSH, i përberë nga E.P, N.Ç dhe B.D ,është jo në përputhje me VKM –së, 285 /2021 “Për prokurimin Publik” neni 75 komisioni i vlerësimit të ofertave pika 2. personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

3. Procedura e prokurimit “Sistemit të ri të Kondicionit të ISSH –së”, me fond limit 20,950,000 lekë pa TVSH, është zhvilluar referuar Ligjit 162/2021, neni 42 “Procedurë e hapur pune publike”, neni 47, VKM nr.285, datë 19.05.2021. “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik “Te dhënat mbi procedurën.

Procedura e prokurimit me objekt: “Sistemit të ri të Kondicionit të ISSH –së ISSH –së”		
1.Urdhër Prokurimi nr. 4269 datë 16.05.2023	3.Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 4269 datë 16.05.2023 E.P, Anëtar N.Ç, Jurist B.D, Anëtar	4.KVO,Urdhri nr.4269/1 datë 22.05.2023 E.K Kryetare F.F Anetar L. Sh Anetar
2.Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur pune publike:		
5.Fondi limit pa TVSH: 20,950,000 lekë.	6. Oferta fituese pa TVSH: 16,323,540 lekë,	7. Diferenca me fondin limit pa TVSH: 4,626,460 mijë lekë
8. Data e hapjes së procedurës: 30.06.2023, ora 11:00,30	9. Burimi i financimit: Buxheti i ISSH për vitin 2023	10. Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 12 (një) OE b. Kualifikuar: 11 (një) OE c. S'kualifikuar: -1
11. Ankimime: S'ka	12. Përgjigje ankesës nga AK:	13. Përgjigje ankesës nga APP/KPP:
14. Lidhja e kontratës datë 19.09.2023	15. Vlera e kontratës: 16,323,540 lekë (pa tvsh) ose 17,870,740 lekë me tvsh	16. Likuiduar deri në datë 27.01.2024

Burimi i të dhënave: ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Përlllogaritja e fondit limit, fondi limit është përcaktuar në bazë të procedurës së organizuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, procedure me vlerë të vogël me objekt “Hartimi projekti mbi realizimin e sistemit të ri të kondicionit mit VRF në Godinën ISSH-së”. Përlllogaritja e vlerësimit të kontratës është referuar preventivit të zbatimit të hartuar nga firma fituese e kontratës.

-Hartimi i kriterëve të veçanta të DT, për këtë procedurë prokurimi me urdhrin e prokurimit nr. 4269, datë 16.05.2023, të titullarit autoritetit kontraktor është përcaktuar njësia e prokurimit e përbërë nga:

- Z E.P. ing. ndërtimi
- Znj. N.Ç. ing. ndërtimi
- Z. B.D. jurist

Hartimi i kriterëve të veçanta të dokumenteve të tenderit është bërë nga njësia e prokurimit, ndërsa hartimi i kriterëve të kapacitetit teknik është bërë nga specialisti i fushës E.P dhe N.Ç.

-Në datë 05.06.2023, nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) Duke marrë shkas nga problematikat e konstatuara në këtë procedurë prokurimi, APP vlerëson se, kriteret në vijim nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislationit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1, të nenit 77, të Ligjit nr.162/2020, “Për prokurimin publik”, dhe nenit 41, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cënuar kështu edhe

përcaktimet e nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

- Nga auditimi i kriterëve të veçanta, Aftësitë teknike dhe profesionale të DT u konstatua se: Në kriteret e veçanta të DT në pikën 2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Mekanik

1 (një) Inxhinier Elektrik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik për secilin pjesëtar të stafit teknik duhet të paraqesë:

- CV përkatëse
- Kontratë pune e vlefshme
- Diplomë

Kërkesat për paraqitjen e CV si kriteret e veçanta nuk përmbush kriterin ligjor sipas kuptimit të legjislacionet të prokurimit, megjithatë kjo kërkesë rezulton të mos jetë e zbatuar, nga te gjithë pasi në CV nuk rezulton që është i punësuar në shoqërinë si më poshtë:

- Ing N.L.
- Ing Elektrik A.H.

Në kriteret e veçanta të DT, pika 2.3.5. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar staf teknik të pajisur me dëshmi profesionale të lëshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, minimalisht 6 (gjashtë) persona konkretisht:

- Instalator Sistemi VRF: minimumi 3 (tre)
- Mekanik: 1 (një)
- Elektricitist/Instalues dhe riparues i pajisjeve dhe rrjetit elektrik: minimumi 2 (dy).
- Punonjësit që figurojnë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Janar- Prill 2023.

Emër Mbiemër i punonjësit	Kontrate pune	Në,ISSH/deklaruar/kodi	Deshmi kualifikimi	Librezë pune	Certifikat kualifikimi	Cv
M.Z.	15.06.2023, Inxhinier elektrik kohe e plotë	Janar, shkurt, mars, prill nuk figuron 1 sig ne kontrate është sp me kohe të plotë	Aud Energjitike	-	Auditues energjitike	Dr Teknik
Xh.S.	Dt.08.05.2020 afat 5 vjecare kohe e plotë, nuk është drejtues teknik	E sig	Inxhinier metalurgjik /materiale	08.05.2020, in g mekanik	Sigurim teknik	Në kontrate pune nuk është drejtues teknik, jonëprputhjem e piken 2.3.4 dhe
A.H.	25.09.2019 afati 5 vite	Janar ska	Ing elektrik	04.05.2019	Siguri teknike	Ska
N. L.	04.12.2019 afati 5 vjecare, kohe te plote Drejt Teknik Ing Ndertimi	E sig	Ing ndërtimi	23.01.2018	Certifikat sig teknik	ska
L.T.	04.01.2013 kontrata me funksion Hidraulik në kontratë me kohe të plotë.	Janari 11 ditë	Sitem, ngrohje ftohje	-	-	Hidraulik

Kërkesat që punonjësit të jenë në listepagesat e shoqërisë për periudhën Janar- Prill 2023, nuk janë të plota pasi nuk janë të gjithë të siguruar, nuk përmbush kriterin ligjor sipas kuptimit të legjislacionet të prokurimit.

Vendosja e kriterit se punonjësit duhet të jenë të punësuar për një periudhë Janar- Prill 2023, në operatorin ofertues, është e pa nevojshëm.

Numri i punonjësve nuk i shërben autoritetit kontraktor për të provuar përvojën e duhur të mëparshme, në mënyrë që të vendosen afate kohore për muaj të caktuar në liste pagese por i shërben për realizimin e kontratës. Është e mjaftueshme liste pagesa e muajit të fundit për numrin e duhur të

kërkuar të punonjësve. Operatori ekonomik mund të lidh kontratë edhe përpara zhvillimit të tenderit me një punonjës i cili mund të mos jetë fare i punësuar deri në këtë moment dhe kjo gjë është tërësisht në rregull.

Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik, kërkon përvoja pune të mëparshme, të ngjashme me objektin e kontratës, por jo përvojë në kohëzgjatjen e punësimit të punonjësve, pra nuk kërkon kohën që është i punësuar në një shoqëri të caktuar punonjësi.

Pavarësisht se mangësitë e mësipërme janë të një niveli të ulët dhe nuk kanë dhënë efekt negativ në zhvillimin e procedurës së prokurimit, pasi kriteret e vendosura janë të nivelit minimal, ato janë evidentuar, me qëllim që të korrigjohen dhe eliminohen në ardhjen nga njësia e prokurimit.

- Nisur nga data e zhvillimit të tenderit, duhet që të zhvendoset periudha kohore, duke përfshirë muajin e fundit të mundshëm për disponimin e listëpagesave, për të patur një informacion sa më koherent në lidhje me këtë kriter. Punonjësit e kërkuar do të marrin pjesë në realizimin e kontratës së ardhshme e cila do të lidhet pas zhvillimit të prokurimit publik. *Operatori për muajin Janar nuk ka të siguar një punonjës dhe në tre muaj është me disa ditë ndërkohë që në kontratë, është përcaktuar me kohët plotë, si dhe CV për disa punonjës të trajtuar në tabelën më sipër.*

Kuadri ligjor në fuqi për prokurimin publik, konkretisht neni 39, pika 6.ç, kërkon fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, por jo periudha kohore të punësimit të fuqisë punëtore. Vërtetimet për periudhat e mëparshme, lidhen me përvojat për punë të ngjashme e jo me fuqinë punëtore.

Për sa më sipër është në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, sipas neneve të mëposhtëm:

- nenin 2 “Dokumentimi i procesit”, pika 2, germa (c), ku thuhet:

“Për çdo procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor duhet të dokumentojë të paktën:... argumentimin e kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike të përcaktuara në procedurën e prokurimit...”

nenin 39, pika 6.ç, ku thuhet: Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;

-nenin 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 1 dhe 2, ku thuhet:

Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi.

2. ...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit”.

Operatori për muajin Janar nuk ka të sig një punonjës dhe në tre muaj është me disa dt ndërkohë që në DT, është përcaktuar në kontratë më kohë të plotë.

AK duhet të mbajë në konsideratë që, në zbatim të përcaktimeve të nenit 78, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, *çdo kriter i veçantë dhe specifikim teknik duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, përlllogaritja e vlerës së fondit limit duhet të argumentohet dhe dokumentohet* sipas përcaktimeve të nenit 76, të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, duhet t’i përmbahet edhe përcaktimeve të nenit 3, të LPP, *për të garantuar trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.*

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Makinerive	Sta statusi	Sas sasia
1	Kamioncine deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qira	Co copë 2
2	Kamion me Vincme kapacitet mbajtës 5-7 ton	në pronësi ose me qira	Co copë 1
3	Kamion me kosh per punime ne lartesi,	në pronësi ose me qira	Co cope 1
4	Gjenerator	në pronësi ose me qira	Co copë 1

Në kriteret e veçanta të DT, **pika 2.3.6 të seksionit “Kapaciteti teknik”**, është vendosur kriteri se operatorët ekonomik duhet të disponojnë mjetet dhe pajisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontratës, ku midis të tjerash është kërkuar - *Kamionçine deri ne 3.5 ton cope 2, Kamion me Vinç më kapacitet mbajtës 5-7 ton copë 1, Kamion me kosh për punime ne lartësi, cope1*, për të cilin në procesverbalin e argumentimit të kriterëve, nuk janë dhënë argumente për nevojën të këtyre mjeteve. Gjithashtu konstatohet se nuk ka zëra punimesh që të justifikohet nevoja për 4 mjetet, kërkesa 4 kamion , është e pa nevojshme dhe e pa argumentuar teknikisht në procesverbalin e mbajtur për këtë qëllim, veprim në kundërshtim me nenin 78, pika 2 e VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” .

Rezultuan të pa mbështetura në analiza teknike për parashikimin e numrit të nevojshëm të makinerive mbështetur në afatin e realizimit të punimeve, grafikun dhe volumin e tyre.

Sasia e mjeteve të kërkuara në DT duhet të përcaktohet sipas volumeve të preventiv ara për zërat e punimeve të ndërtimit, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Në dosjen e tenderit nuk ka dokumente, që të vërtetojë konkretisht argumentimin teknik për numrin e mjeteve në përputhje me volumin dhe punët që do kryhen dhe grafikun e punimeve.

Konkluzion: Nga auditimi rezultoi se në vendosjen e kriterëve Njësia e prokurimit, ka kryer veprime jo në përputhje me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku thuhet:

”Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. ... ”; si dhe me Neni 75 Komisioni i vlerësimit të ofertave pika 4 në çdo rast, përgjegjësia për vlerësimin e ofertave është e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

-Zbatimi i kontratës: Nga titullari i AK, është ngritur komisionit për ekzekutimin e kontratës me objekt Rikonstruksioni Godinës ISSH, jo në përputhje me VKM –së, 285 /2021 “Për prokurimin Publik” neni 75 komisioni i vlerësimit të ofertave pika 2. personat përgjegjës për hartimin e dokumenteve të tenderit nuk mund të emërohen anëtarë të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Për këto veprime mbajnë përgjegjësi punonjësit e lartë përmendur.

Rezultoni se; tre tenderët e zhvilluar për periudhën objekt auditimi, likuidimet janë kryer sipas situacioneve si më poshtë:

Nr	Emertimi	Vlera e Kontrates	Situacioni i paguar	Data Likujdimit	Vlera e palikujduar
1	F/V Sistemi Kondicionimit ISSH-se	17,870,740 leke (me tvsh)	Nr 1: 15,297,660 Nr.2: 1,511,744	Dt.30.10.2023 Dt. 28.11.2023	893,516 lekë
2	Rikonstruksioni godines se ISSH-se	26,375,456 leke (me tvsh)	Nr.1: 8,354,400	Dt. 27.12.2023	16,702283 lekë
3	Sigurimi I Aseteve te ISSH-se	7,877,667 leke	7,877,667 leke	Dt. 6.06.2023	-

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

2.8. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.

Në zbatim të drejtimit nr.8 të Programit të Auditimit “*Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Procedura, procese pune, etapa raportimi;

-Procedurat per te raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etiken dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara;

-Plani strategjik;

-Struktura dhe organika e Institucionit;

-Rregulla të brendshme të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimin e tyre;

-Vlerësimet e punës të punonjësve të ISSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet sa më poshtë vijon:

Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Aktivitetet e kontrollit, Informimi/komunikimi, si dhe Monitorimi.

1. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

Strukturat përgjegjëse të Zyrës së ISSH kanë dijeni mbi kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke filluar me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Manualin për MFK-në, miratuar me urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, ndryshuar me urdhrin nr. 224, datë 16.12.2021) si dhe urdhrat dhe udhëzimet e dala në zbatim të këtij ligji.

Mjedisi i kontrollit vlerësohet bazuar në komponentët si më poshtë;

1.1 Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike.

ISSH ka një Kod Etike të miratuar me vendimin nr.5 të datës 14.08.2020 si dhe ka procedurën për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara bazuar në Kodin e Punës *si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit* sipas përcaktimeve të nenit 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “a” të Ligjit 10926 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 ku përcaktohet se “Kuari i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje”. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

1.2 Politikat menaxheriale dhe stilin e punës.

Konstatohet se ISSH ka hartuar një plan strategjik i cili përmban objektivat afatmesëm dhe vjetore prioritare të institucionit si dhe ka përgatitur planet e masave dhe veprimet në mënyrë që të monitorojë zbatimin e tyre, sipas përcaktimeve në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa “a” Nëpunësit autorizues të të gjitha niveleve të njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto përgjegjësi kryesore: a) propozimin te nëpunësi autorizues i njësisë publike të sistemit të rregullave dhe procedurave të brendshme të njësisë, të planeve strategjike dhe të objektivave afatmesëm dhe vjetorë, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre në njësi; dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.10 “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, germa a.

ISSH për periudhën e auditimit, ka miratuar grupin e menaxhimit strategjik(GMS) me Urdhërin nr.3676/2 datë 30.05.2022 “Për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik”, të njësisë publike. Përbërja e grupit është përcaktuar sipas nenit 27 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010,

Koordinatori Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit është caktuar Nëpunësi Autorizues, sipas shkresës nr.241/1 datë 11.01.2023.

Punonjësit e ISSH, marrëdhëniet e punës me punëdhënësin i rregullojnë në bazë të Ligjit nr. 7961 të datës 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.

Sa i përket delegimit të kompetencave, konstatohet se *ISSH ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre*, konkretisht shkresa me nr.3676 datë 26.05.2022, sipas përcaktimeve në nenin 15 të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar si dhe Kap. III ‘Delegimi i Detyrave’, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

1.3 Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Struktura organizative e ISSH është miratuar me anë të Vendimit nr.2051 datë 18.03.2022, me numër të përgjithshëm të punonjësve prej 1338, me një shtesë prej një punonjësi në pozicionin “Koordinator kundër Korrupsionit”, e ndryshuar me VKA nr.13, datë 28.12.2023 me numër të përgjithshëm të punonjësve prej 1271, ku strukturat analitike do të përcaktohen brenda datës 31.03.2024.

1.4 Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore.

Në rregulloren e brendshme të institucionit, ISSH ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet

strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, hyrjen dhe qëndrimin në mjediset e punës etj., sipas përcaktimeve në nenin 20, të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010. Nga institucioni rezulton të jetë bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, i cili është bashkëlidhur dosjeve personale të punonjësve. Konstatohet se për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore ka plan veprimi për trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve, të cilat realizohen sipas nevojave, konkretisht me shkresën nr.323/2 prot; të datës 16.01.2023.

2. Menaxhimi i riskut

ISSH ka hartuar një strategji për menaxhimin e riskut, me anë të shkresës nr.685/1 datë 22.01.2023. Gjithashtu, konstatohet se njësia ka përcaktuar koordinatorin e riskut, me anë të shkresës nr.241 prot; datë 11.01.2023, z.E.K, këto sipas përcaktimeve në nenin 8, pika 8/a të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, dhe nenin 21, pika 2: “Menaxhimi i riskut”.

Gjithashtu është ngritur edhe grupi i menaxhimit të riskut me Urdhërin nr.3676/1 prot; datë 30.05.2022 “Për krijimin e grupit të menaxhimit të riskut”.

3. Aktivitetet e kontrollit

ISSH ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit me anë të shkresës nr.7863/1 prot; datë 14.11.2018, për procese të tilla si menaxhimi i aktiveve, procedura e marrjes në dorëzim, inventarizimi fizik i aktiveve, shpërndarja e fondeve buxhetore, ekzekutimi i shpenzimeve, mbi miratimin e planin vjetor, sipas përcaktimit në nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditit” dhe nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e NZ”.

4. Informimi dhe komunikimi

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të ISSh si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet kryesisht me anë të postës elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

Nga kërkimi i ndërveprimit të ISSH me qytetarët, konstatohet se institucioni ka një faqe web ku përmban edhe nën seksion ku pasqyrohet programi i transparencës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 119/2014 ‘Për të drejtën e informimit’ ku në nenin 4 përcaktohet se “Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni”. Gjithashtu është i pasqyruar koordinatori për të drejtën e informimit, sipas shkresës nr.3834 prot; datë 30.01.2015 ku është përcaktuar punonjësja Xh.K.

5. Monitorimi

Për periudhën e audituar, konstatohet se ISSh ka plotësuar pyetësorët e vetëvlerësimit në zbatim të formatit të miratuar pjesë e Manualit për MFK si dhe ka një sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave sipas përcaktimeve në nenin 24, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010.

✓ Me shkresën nr.1080/1 prot; datë 30.01.2024 për **vitin 2023** është dërguar deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raporti për funksionimin e SKB për vitin 2023, pyetësori i vetëvlerësimit, plani i veprimit të MFK i plotësuar sipas përcaktimeve të Urdhrit të Ministrit të MFE nr. 224 datë 16.12.2021 “Për disa ndryshime dhe një shtesë në Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016 “Për miratimin e manualit të menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

Konkluzion: Nga auditimi rezulton se, menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm ka funksionuar në mënyrë të plotë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

2.2.8. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.

Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm (DAB këtu, e më poshtë). Niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e vijueshme.

- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), raportimi në këtë drejtori.
- Plani vjetor, realizimi i planit vjetor të DAB.

- Auditim me zgjedhje mbi misionet e auditimeve të kryera nga DAB, zbatimi i kritereve ligjore dhe nënligjore në fushën e auditimit të brendshëm, standardet dhe manualët të dalë në zbatim të tyre.

Auditimi i funksionimit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm(DAB).

Misioni i Auditit të Brendshëm, mbështetur në nenin 5, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, është të japë siguri të arsyeshme Titullarit të Institucionit, në mënyrë të pavarur dhe objektive.

Objektivat e DAB.

- Siguri dhënia objektive ndaj Titullarit të ISSH-së, zbatimi i proceseve të punës kryhet me efikasitet, efikasitet dhe ekonomikitet, në përmbushje të objektivave të përcaktuara.

- Zhvillimi i një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit.

Organizimi dhe funksionimi i DAB.

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se krijimi i DAB në ISSH është përcaktuar në nenin 12, të vendimit nr. 1022, datë 09.07.2008, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 161, datë 11.4.1994, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore". DAB për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar.

Bazuar në nenin 29, të ligjit nr. 9377, datë 21.04.2005, për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 DAB në aspektin organizativ dhe funksional ka varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH, si dhe punonjësit e saj emërohen prej tij.

Me shkresën nr. 7376 prot, datë 07.09.2017, të Titullarit të ISSH, bazuar në pikën nr.4, të vendimit nr.5 prot; datë 20.07.2010 “Për ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së”, të Këshillit Administrativ, struktura e drejtorisë është organizuar me 9 punonjës (1+6+2), të ndarë në Degën e Auditimit Financiar (1+5) dhe në Sektorin e Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut (2).

Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2023 ashtu si edhe në vitin 2022, DAB ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur 3 vende vakante, dy në pozicionin auditues, në Degën e Auditimit Financiar dhe një në pozicionin auditues, në Sektorin e Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut. Pavarësisht mungesës në strukturë dhe rekomandimeve të lëna nga ana e KLSH, njësia e burimeve njerëzore nuk ka proceduar me shpalljen e tyre, duke përjashtuar vetëm një rast në datën 27.12.2023 (verifikuar në linkun: https://www.iss.gov.al/?page_id=9334), për pozicionin auditues në Degën e Auditimit Financiar.

Mungesa në strukturën organizative të kësaj drejtorie sjell pasoja në performancën e njësisë, duke rrezikuar përmbushjen të objektivave të përcaktuara.

Nga auditimi u konstatua se, punonjësit e DAB kanë arsim bazë: 4 prej tyre profil ekonomik, 1 profil juridik, 1 prej tyre ka profil ekonomik dhe juridik si dhe janë të pajisur me certifikatën “Auditues i Brendshëm në sektorin publik”. Gjithashtu, të gjithë kanë përvojë pune, mbi 5 vite si auditues të brendshëm. Pra, punësimi i tyre është bërë në përputhje me nenin 11, pika 2, gërma a, të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Punonjësit e DAB kanë kryer trajnimet e vijueshme të detyrueshme, 40 orë në vit dhe kanë marrë pjesë në të gjitha trajnimet që ka organizuar Njësia Qëndrore e Auditit të Brendshëm (NJQAB), duke i zhvilluar ato nga data 03-07 Prill 2023 dhe për drejtuesin nga 05-09 Qershor.

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik:

DAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në ISSH dhe e ka përditësuar atë, gjë e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr.7671, datë 12.11.2019.

Plani Strategjik 2023-2025 dhe Plani Vjetor:

Ne mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik dhe plani vjetor. Për periudhën objekt auditimi, DAB në ISSH ka hartuar planin strategjik dhe vjetor për vitet 2023-2025, ku është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm me shkresën nr.6400/1 prot; datë 17.10.2022, i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i

ISSH. Nga auditimi u konstatua se, planet janë dërguar brenda afatit (20 Tetor), të përcaktuara në pikën 3.2 “Plani vjetor i auditit të brendshëm” dhe pikën 3.3 “Afati i përgatitjes dhe dërgimit të planit vjetor dhe strategjik të auditit të brendshëm.

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm ka përcaktuar objektivat strategjike për periudhën 2023-2025, ndër të cilat janë:

- Siguridhënia objektive ndaj titullarit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore se zbatimi i proceseve të punës kryhet me efikasitet, efikasitet dhe ekonomi në përmbushje të objektivave të përcaktuara.
- Kryerja e auditimeve të vazhdueshme, duke siguruar që çdo DRSSH dhe degë të mos mbetet pa u kontrolluar për një periudhë më shumë se dy vjet, me qëllim shmangien e risqeve që mund të kërcënojnë skemën e sigurimeve shoqërore, aktivitetin e njësisë vartëse të ISSH si dhe vetë aktivitetin e ISSH-së në tërësi.

Si dhe Objektivat kryesore për Vitin 2023, të cilat janë:

- Të japë vlerësime vjetore Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së, mbi përshtatshmërinë dhe efektivitetin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit të risqeve të rëndësishëm, dhe për objektin e dokumentuar të punës audituese.
- Të informojë periodikisht menaxhimin e lartë mbi gjendjen dhe rezultatet e planit vjetor të auditimit dhe mjaftueshmërinë e burimeve të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Me shkresën nr.1409/1 prot; datë 08.02.2024, i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE, “Raporti i Veprimtarisë së DAB-së në ISSH për vitin 2023” duke i bashkëngjitur dhe “Pasqyrat Përmbledhëse 1-6” në formatin Excel, kjo sipas përcaktimit të pikës 4.3, të Manualit të Auditimit të Brendshëm.

Planifikimi dhe Realizimi i angazhimeve sipas planit vjetor:

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm për vitin 2023 ka planifikuar 13 angazhime auditimi, në të cilat kryesisht do të auditohet përputhshmëria dhe rregullshmëria e aktivitetit ekonomik e financiar, dhe për sektorë të veçantë do të ketë auditime performance.

Për vitin 2023 janë planifikuar 13 misione auditimi, për 10 subjekte janë planifikuar të auditohen gjithë veprimtaritë organizative e funksionale, të gjitha fushat e sistemet e veprimtarisë së tyre dhe në Drejtorinë Qëndrore të ISSH janë planifikuar të kryhen auditim financiar dhe auditim performance. Është planifikuar një mision auditimi për të gjitha subjektet e audituara gjatë vitit 2022 për të vlerësuar statusin e zbatimit të rekomandimeve.

Nga auditimi rezultoi se, gjatë vitit 2023 nuk ka patur ndryshim plani të auditimeve, por ka një kërkesë nga Titullari i Institucionit, për auditim tematik në DRSSH Vlorë për të audituar ndjekjen e proceseve gjyqësore nga zyra juridike për periudhën 30.06.2022-30.08.2023.

DAB ka realizuar planin e auditimit në masën 93%, për vitin 2023, duke ushtruar misionet e auditimit në 10 DRSSH me përjashtim të DRSSH Berat e cila ishte planifikuar në Nëntor 2023 dhe rezultoi e papërfunduar në vitin 2023, në DAQ dhe në 2 drejtori të Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore. Realizimi i misioneve audituese për vitin 2023, paraqitet në tabelën e ndodhur në aneksin nr. 2.8.1.

Konstatim: sa më sipër vihet re se edhe për vitin 2023 ashtu si në vitin 2022, nuk është planifikuar dhe kryer asnjë auditim në sistemet e teknologjisë së informacionit në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive për të arritur qëllimet dhe objektivat e Institucionit, edhe pse vlerësimi i nivelit të riskut për vitin 2022 dhe 2023 në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit në DAQ është vlerësuar i lartë.

-Nga angazhimet e realizuara për vitin 2023 janë evidentuar në total 95 gjetje dhe shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën 7,731,100 lekë. Gjetjet si numër për vitin 2023 janë 6% më pak se gjetjet e vitit 2022. Gjetjet kryesore nga auditimet lidhen kryesisht me:

- ✓ *Sistemin e proceseve organizative. Menaxhimi i burimeve njerëzore.*
- ✓ *Sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit.*
- ✓ *Sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit.*

Për gjetjet e konstatuara nga DAB janë lënë 97 rekomandime, nga të cilat rezultojnë të pranuar nga

menaxhimi 95, zbatuar 42 rekomandime ose 44.2% e tyre dhe pa zbatuar 5 rekomandime ose 5.2 % e tyre. Pjesa tjetër e rekomandimeve është në proces zbatimi pasi janë lënë afate për realizim në vitin 2024.

Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm, ruajtja dhe arkivimi i tyre: Grupi i auditimit shqyrtoi për vlerësim, 5 dosje me zgjedhje të cilat renditen dhe si rajonet me rëndësinë dhe volumin më të lartë, nga 13 dosje në total, të angazhimeve të kryera në vitin 2023. Në këto dosje u evidentua se grupet e auditimit kanë grumbulluar informacionin e nevojshëm për përgatitjen e Raporteve të Auditimit. Audituesit e DAB në ISSH, kanë analizuar të gjithë informacionet e grumbulluara nëpërmjet metodave dhe teknikave të përdorura të auditimit, që janë gjykuar më të përshtatshme dhe të besueshme për subjektin. Në dosjet e auditimit gjenden të administruara letrat e punës, evidencat e përshtatshme si dhe pyetësorët e dhënë nga grupet e auditimeve, të cilat lënë gjurmë dhe dëshmojnë mbi proceset e ndjekura për zbatimin e programit të auditimit të miratuar.

Tabela nr.2.8.2: Të dhëna mbi procedurat, nr. e programeve dhe zbatimin e afateve të auditimeve për vitin 2022:

DRSSH	Tiranë	Shkodër	Fier	Durrës	Korçë
Autorizimi	Po	Po	Po	Po	Po
Deklarata e konfliktit të interesit	Po	Po	Po	Po	Po-
Njoftim për fillimin e auditimit	09.10.2023	20.04.2023	19.01.2023	27.06.2023	07.09.2023
Vlerësimi riskut	Po	Po	Po	Po	Po
Programi auditimit	13.10.2023	26.04.2023	26.01.2023	30.06.2023	08.09.2023
Takimi fillestar/përmbyllës	Po	Po	Po	Po	Po
Testet individuale	Po	Po	Po	Po	Po
Projekt raporti	20.12.2023	31.05.2023	02.03.2023	15.08.2023	27.12.2023
Dërgim konfirmimi nga subjekti	09.01.2024	14.06.2023	13.03.2023	25.08.2023	09.01.2024
Raporti përfundimtar	27.02.2023	27.06.2023	27.03.2023	29.08.2023	27.02.2024
Raporti i dërguar nga sub.	29.03.2023	11.08.2023	JO	03.10.2023	JO
Memo	Po	Po	JO	Po	PO
Rishikimi cilësisë së punës	Po	Po	Po	Po	Po

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit

Konstatim: sa më sipër, nga ana e grupit të auditimit vihet re se:

-Në praktikën e auditimit të DRSSH-ve, Memot e përpiluar nga DAB nuk përmbajnë datë, sipas përcaktimeve në nenin 13 “Mbi normat tekniko profesionale për arkivat”, ku shprehet se: “Dokumentet e brendshme si: Vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e jo shtetëror etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin”, në dy raste rezultojnë të pa sigluara nga ana e drejtorit të AB.

-Në praktikën e auditimit të DRSSH Fier nuk rezulton të jetë përpiluar Memo për Titullarin si dhe mungon Reagimi(feedback) nga ana e subjektit të audituar në lidhje me Raportin Përfundimtar, e cila nuk është në përputhje me përcaktimin e pikës 4.1.12, të Manualit të Auditimit të Brendshëm. Gjithashtu, më datën 13.01.2023 është përpiluar Autorizimi nga Dr i Auditit për fillimin dhe përgatitjen e angazhimit për auditim nga A.B, Sh.B, M.T, G.B dhe V.Gj. Nga verifikimi i praktikës rezulton se deklarata e konfliktit të interesit nuk është plotësuar nga të pestë audituesit por nga katër. Pra mungon deklarata e konfliktit të interesit nga audituesi A.B, i cili është caktuar dhe përgjegjës i grupit të auditimit, kjo jo sipas përcaktimit të pikës 2.6.3 të Manualit të Auditimit të Brendshëm.;-Në praktikën e auditimit të DRSSH Tiranë, auditimi në terren ka filluar më 18.10.2023 dhe ka përfunduar më 24.11.2023, Projekt Raporti është dërguar më 20.12.2023 ose 5 ditë me vonesë. Raporti përfundimtar është dërguar më 27.02.2024 ose 41 ditë me vonesë, kjo në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm pika 4.1.12;

- Në praktikën e auditimit të DRSSH Korçë, në një rast deklarata e konfliktit të interesit e paplotësuar, por e nënshkruar.

2.9. Mbi përputhshmërinë e procedurave të kryera në përlllogaritjen dhe pagesat e pensioneve, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës.

Në zbatim të drejtimit nr.9, të programit auditimit, mbi auditime funksionimit të strukturave të kontrollit në drejtim të inspektimit të pensioneve, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Raporti vjetor 2023 (analiza vjetore);
- Dosjet e pensioneve;
- Të dhënat në sistemin CMIS dhe PCAMS;

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës është institucion në varësi të ISSH-së dhe është e organizuar dhe funksion në bazë të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” miratuar me Urdhër nr.215 prot, datë 15.08.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së. Në përbërje të saj janë edhe 6 Agjenci rajonale: Nr.1(2 punonjës); Nr. 2 Durrës (1 punonjës); Sukth (5 punonjës); Shijak (4 punonjës); Krujë (5 punonjës); Fushë Krujë (4punonjës). Struktura dhe organigrama e saj është e miratuar me Urdhër nr.8300/1, datë 04.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së si më poshtë:

1.	Drejtor	1 (një)
2.	Inspektor i përgjithshëm kordinues	1 (një)
3.	Kabineti	4 (katër)
4.	Dega e financës	7 (shtatë)
5.	Dega e kontributeve	4 (katër)
6.	Dega administrimit te përgjithshëm	3 (tre)
7.	Dega e informatikës	4 (katër)
8.	Dega e përfitimeve	25 (njëzete e pesë)
9.	Dega e arkivës	11 (njëmbëdhjetë)

Në total numri i miratuar përputhet me numrin në fakt, që është 81 punonjës. Dega e përfitimeve rezulton e plotësuar sipas organikës së miratuar.

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës gjatë vitit 2023 ka realizuar përlllogaritjen e pensioneve si më poshtë:

Tabela nr.9.1. Pensionet sipas llojit me ndryshimet gjatë vitit 2023

Lloji i pensionit	Gjendja në fillim 01.01.2023	Lidhur gjatë vitit dhe transferuar	Mbyllur gjatë vitit dhe transferuar	Gjendja në 31.12.2023
Pension pleqërie	51,745	3,744	2,176	53,313
Pensione invaliditeti	7,326	269	336	7,259
Pensione Familjar	4,992	305	201	5,096
Pensione social	334	32	45	321
Pensione Suplementare	2701	241	191	2,732
Totali	67,098	4,591	2,949	68,721

Burimi i të dhënave: DRSSH Durrës përpunuar nga Grupi auditimit KLSH

- Në total numri i përfituesve gjithsej është 68,721, krahasuar me vitin 2022 është rritur me 1,623 përfitues. Peshën specifike më të lartë e zënë pensionet për pleqëri në masën 78% e më pas pensionet e invaliditetit në masën 11%, pensionet familjare zënë 7.4%, pensionet sociale zënë 0.4% dhe pensionet suplementare zënë 4 % të totalit të numrit të pensioneve.
- Nga 4,583 përfitime të lidhura gjithsej 11% ose 501 përfitime janë të ardhura/transferuara nga drejtori rajonale të tjera dhe 89% ose 4.082 janë përfitime të reja.
- Nga 3,010 përfitime të mbyllura gjithsej 8% ose 239 përfitime janë të transferuara në drejtori rajonale të tjera dhe 92% ose 2,771 përfitues janë mbyllur.
- Gjatë vitit 2023, kërkesat për lidhje pensionesh të cilat janë pranuar dhe refuzuar nga DRSSH Durrës paraqiten sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr.9.2: Pensionet e lidhura dhe të refuzuara gjatë vitit 2023

Lloji i pensionit	Kërkesa	Caktuar	Të Refuzuara
Pleqëri	4332	3322	1010
Invalide	321	238	83
Familjare	348	277	71

Sociale	31	31	-
Suplementar	114	61	53
Total Pensione	5146	3929	1155

Burimi i të dhënave: DRSSH Durrës përpunuar nga Grupi auditimit KLSH

- Nga platforma e Bashkëqeverisjes, janë trajtuar 257 raste ankesash, nga të cilat vetëm 41 raste kanë rezultuar me zgjidhje në favor të qytetarit dhe kanë qenë kryesisht nga mosnjohja e vjetërsisë së punës, ndërsa rastet e tjera kanë rezultuar me problematika të ndryshme dokumentacionesh.

Nga të dhënat e mësipërme janë përzgjedhur për auditim 70 dosje pensionesh të kategorive: pleqëri, invaliditet dhe familjar, nga të cilat rezultoi se:

-Nga auditimi i afateve nga paraqitja e kërkesës nga përfituesi deri në caktimin e pensionit, rezultuan me parregullsi 3 dosje përfitimi, në kundërshtim me përcaktimet në Rregulloren Nr.1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, në mosrespektim me kapitullin XI “Afatet për çdo hallkë të procesit të caktimit të pensionit”, të rregullores.

Gjithashtu, nga auditimi i dosjeve fizike u konstatua se fleta shoqëruese nuk rezultoi të jetë e nënshkruar dhe e plotësuar në të gjitha hallkat e saj, kjo jo sipas përcaktimeve të Rregullores nr.1 datë 21.10.2008, kapitulli I.

Tabela nr.9.3: Të detajuara 3 rastet e tejkalimit të afatit të caktimit të pensionit

Nr.	Kategoria e Pensionit	Nr. Kërkesë	Data e Kërkeses per Caktim Pensioni	Nr. Vendimi	Data Vendimit per Caktim Pensioni	Afati i lidhjes së pensionit	Komente
1	Invaliditet	4105200000	08.08.2023	3468	07.11.2023	95 ditë	jashtë afatit
2	Pleqëri	1994800000	16.03.2021	998	11.05.2021	56 ditë	jashtë afatit
3	Pleqëri	4753200000	25.05.2021	2216	07.07.2021	43 ditë	jashtë afatit

Burimi i të dhënave: CMIS dhe PCMAS, përpunuar nga Grupi KLSH

1. Nga auditimi kryer në sistemin CMIS dhe PCMAS, në lidhje me inspektimin e pensioneve të pleqërisë rezultoi se: për 8 raste, me vlerë debitore gjithsej 762,484 lekë, të certifikuara, nuk është respektuar masa e ndalesës me 50% të këstit të përfitimit, por në masën 20%, në kundërshtim me nenin 62, pika 2, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, ku ndër të tjera citohet se: “Personi, që ka përfituar pension ose të ardhura të tjera nga sigurimet shoqërore, me mënyra e mjete në kundërshtim me ligjin, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër, të cilën e shlyen duke iu mbajtur çdo muaj 50 për qind e këstit mujor të përfitimit. Të detajuara rastet janë si më poshtë:

Tabela nr.9.4: Tetë raste me ndalesa në vlerë 20%, të këstit mujor të përfitimit

Nr. Rend.	Nr. Dosje	DRSSH Durrës			Lloji Pensionit	Debia(lekë)
		Përfitues				
		Emër	Atësi	Mbiemër		
1	147796	F	E	R	Pleqëri	269,397
2	150698	A	B	M	Pleqëri	68,115
3	151612	E	M	Xh	Pleqëri	104,231
4	151010	Z	H	N	Pleqëri	122,746
5	151084	H	A	D	Pleqëri	27,009
6	151873	R	H	M	Pleqëri	28,362
7	154759	N	A	S	Pleqëri	68,869
8	150195	I	S	K	Pleqëri	73,755
		Total				762,484

Burimi i të dhënave: CMIS dhe PCMAS, përpunuar nga Grupi KLSH-së

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi, Titullari i DRSSH-së Durrës M.K, Përgjegjësi i Degës së Përfitimeve Sh.F, inspektorët e degës së përfitimeve I.A, K.A, E.D, A.B, E.J dhe E. H dhe specialistët e DIP në ISSH për certifikimin e tyre A.M dhe E. Sh.

2. Nga verifikimet e kryera në sistemin CMIS dhe PCMAS, në lidhje me të drejtën e përfitimit për pension invaliditeti, janë konstatuar përfitime të padrejta, pasi përfituesit për pension invaliditeti dhe pleqërie kanë rezultuar njëkohësisht edhe të punësuar: në 15 raste në vlerën 360,427 lekë, të ndara sipas kategorive, të pa certifikuara nga DIP, veprime në kundërshtim me pikën 2 dhe 3, të nenit 57,

të Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar ku citohet: “Tërheqja e kësteve të përfitimit 2. Përfituesi nuk ka të drejtë për këste përfitimi për çfarëdo periudhe, kur merr pagë ose të ardhura nga veprimtaria ekonomike si i punësuar ose i vetëpunësuar; 3. Pagesat e të ardhurave ndalohen për çdo kohë që përfituesi është punësuar ose ka qenë ekonomikisht aktiv”.

Tabela nr.9.5: 15 Rastet e konstatuara pa të drejtë përfitimi për pension invaliditeti, të pa certifikuara nga DIP.

Nr	Numër Dosje	Lloji i pensionit	Vlera Debi (Lekë)	Specialisti i përfitimeve
1	I0000174	Invalid	43.985	A.B
2	I0000421		19.991	H.K
3	I0000401		8.084	
4	I0000373		20.422	K.A
5	I0000190		24.621	I.A
6	I0000230		50.278	B.R
7	I0000262		7.962	B.R
8	I0000306		64.765	B.R
9	I0000320		20.476	E.J
Shuma I:			260.584	
10	F0000273	Familjar	46.030	
11	F0000269		7.254	
Shuma II:			53.284	
12	P0003380	Pleqeri		D.B
13	P0003981		35.749	K.A
14	P0004407		10.740	I.A
15	P0002774		69.976	I.A
Shuma III:			46.559	
Total (I+II+III)			360.427	

Burimi i të dhënave: CMIS dhe PCMAS, përpunuar nga Grupi KLSH-së

3. Nga grupi i auditimit u konstatuan pa rregullsi në 9 dosje në vlerë 192,754 lekë, të certifikuara nga DIP, veprime në kundërshtim me pikën 2 dhe 3, të nenit 57, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

Tabela nr.9.6: Rastet me shkelje të certifikuara nga DIP

Nr.	Numër Dosje	Lloji i pensionit	Vlera Debi (Lekë)	Inspektori i përfitimeve në DRSSH Durrës	Specialisti i Inspektimeve
1	152149	Invalid	3312	E.J	A.B
2	152150	Invalid	15109	E.D	A.B
3	152295	Invalid	22476	E.D	
4	152149	Invalid	3312	nuk ka	A. B
5	155077	Invalid	10108	nuk ka	A. B
6	153931	Invalid	23362	N.C	H. F
7	154425	Invalid	32212	K.A	H.F
8	154421	Invalid	25355	V. N	
9	151612	Pleqeri	57508	K.A	A.M
Shuma			192,754		

Burimi i të dhënave: CMIS dhe PCMAS, përpunuar nga Grupi KLSH-së

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi, inspektorët e DRSSH Durrës E.J, E.D, N. C, K. A, V. N, A.B, H.K, I.A, D.B, B.R, E.Hi dhe specialistë e drejtorisë së inspektimeve A.B, H. F, A. M, E.Sh.

2.10.Të tjera të dala gjatë auditimit.

Mbi auditimin të hedhjes së kartelave të pensioneve dhe të llogaritjes online të përfitimeve: në sistemin CMIS (sistemi i kontributeve) u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Të dhënat dhe përpunimi i tyre në sistemin CMIS dhe PCAMS;
2. Sistemi i përfitimeve dhe sistemi i kontributeve;
3. Analiza vjetore e Drejtorisë së Burimeve të Informacionit;
4. Strategjia dhe politikat e Drejtorisë së Burimeve të Informacionit.

Bazuar në strategjinë e zhvillimit të ISSH-së, si dhe në vazhdimësi të procesit të informatizimit të sistemit të sigurimeve shoqërore, Drejtoria e IT-së është angazhuar gjatë vitit 2023 me detyrat dhe

projektet si më poshtë:

1. Vazhdimi i mëtejshëm i programit të hedhjes së kartelave të pensioneve dhe të llogaritjes online të përfitimeve:

Edhe gjatë këtij viti ka vazhduar puna për hedhjen e kartelave të pensioneve të të gjitha llojeve në programin e hedhjes të dosjeve të pensioneve (kartelave elektronike).

Ecuria e hedhjes nga 01.01.2023 deri në datë 31.12.2023 është si më poshtë:

Tabela nr.1: Kartelat elektronike të pensioneve sipas kategorive për periudhën Janar-Dhjetor 2023

DRSSH	Pleqëri	Invalid	Familjar	Suplement	Total
Dega Sarande	1242	29	36	119	1426
Dega Tropoje	173	36	12	18	239
Drejtoria Berat	2042	70	78	185	2375
Drejtoria Diber	1189	88	80	131	1488
Drejtoria Durrës	3636	239	286	277	4438
Drejtoria Elbasan	3212	445	193	242	4092
Drejtoria Fier	4821	187	180	543	5731
Drejtoria Gjirokastrë	1508	57	67	115	1747
Drejtoria Korçë	3345	252	193	287	4077
Drejtoria Kukës	411	69	41	49	570
Drejtoria Lezhë	1494	130	118	141	1883
Drejtoria Shkodër	2756	149	175	148	3228
Drejtoria Tiranë	8750	625	651	1577	11603
Drejtoria Vlorë	2252	95	125	260	2732
Total	36831	2471	2235	4092	45629

Burimi: të dhëna nga Analiza Vjetore 2023 e DBI në ISSH

Nëpërmjet këtij programi brenda vitit 2023 DBI ka arritur:

- Hedhjen e pensioneve të reja të lidhura deri më 31.12.2023.
- Pasqyrimin në kohë reale të rritjes së pensioneve për vitin 2023, në zbatim të VKM-së 553 Dt. 28.09.2022 “Për indeksimin e pensioneve”.
- Hedhjen dhe pagesat e shpërblimeve dhe bonuseve të fund vitit 2022.

2. Hedhja në sistemin CMIS (sistemi i kontributeve) e të dhënave për sigurimin vullnetar dhe të vetëpunësuarve në bujqësi, sipas tabelës së mëposhtme:

3.

Tabela nr.2: Kontributet për periudhën Janar-Dhjetor 2023 për çdo DRSSH

Nr.	DRSSH	Fermer	Vullnetar
1	Berat	2961	246
2	Dibër	2720	26
3	Durrës	1746	520
4	Elbasan	5000	324
5	Fier	6052	386
6	Gjirokastrë	2402	96
7	Korçë	4369	341
8	Kukës	1351	40
9	Lezhë	2282	114
10	Shkodër	2991	264
11	Tiranë	2984	2638
12	Vlorë	3954	526
	Total	38,812	5,521

Burimi: të dhëna nga Analiza Vjetore 2023 e DBI në ISSH

Në zbatim të Ligjit Nr. 43/2023 “Për Qeverisjen Elektronike”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka në përdorim 4 (katër) sisteme informatike:

- **PCAMS, Pension Calculation and Assignment and Management System**, sistemi elektronik i kalkulimit dhe pagesës së përfitimeve, pleqëri, invalid, familjar, përfitimeve suplementare dhe përfitimeve afatshkurtra.

Sistemi ka si funksion primar llogaritjen në mënyrë automatike të përfitimeve, me qëllim

automatizimin e të gjithë procesit të punës, që nga pritja e kërkesave të të interesuarve deri në momentin e pagesës së përfituar në qendrat paguese. Gjithashtu, përfituesi mund të paraqesë kërkesën për rishqyrtim ose transferim të masës së pensionit, të paraqesë ankesë ose të kërkojë informacion. Përdoruesit e sistemit janë qytetarët aplikant për të qenë përfitues, pritësit e kërkesës, miratuesit, koordinatorët dhe inspektorët. Kërkesa për përfitime afatgjata ose afatshkurta realizohen online nga vetë individët përfitues nëpërmjet aplikimit në portalin qeveritar e -Albania. Këto kërkesa trajtohen në sistemin PCAMS, ku realizohet dhe llogaritja e përfitimit, caktimi i masës së përfitimit për individin deri në pagesën e përfitimeve nga agjentët pagues të ISSH.

- **CMIS, Contribution Management Information System**, sistemi elektronik për menaxhimin e kontributeve.

Sistemi përmban regjistrat elektronik të të vetëpunësuarve në bujqësi dhe regjistrat e derdhjeve të sigurimit vullnetar, si dhe ofron mundësinë e marrjes së të dhënave në mënyrë elektronike nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

- **DMAIS, Document Management and Archiving Information System**, Sistemi arkivimit dhe i menaxhimit të dokumentave të vjetërsisë në punë dhe të periudhave të sigurimit.

Sistemi ka për funksion dixhitalizimin e regjistrave të vjetërsisë në punë dhe listë pagesave për gjithë entet publike dhe jo-publike, si dhe për personat fizik.

- **FMS, Financial Management System**, Sistemi elektronik për menaxhimin e financave të ISSH.

Sistemi financiar bën të mundur menaxhimin, mbrojtjen, përdorimin dhe ndarjen e informacionit financiar të ISSH në të gjithë aktorët e institucionit.

Ëorkfloë (rrjedha e informacionit) në sistemin e pensioneve nga aplikimi deri në përlllogaritjen e masës së pensionit është si në vijim:

1. Individit kryen aplikimin në portalin e-Albania dhe pajisjet me një numër gjurmimi, të nevojshëm për të gjurmuar aplikimin e tij në çdo fazë.
2. Aplikimi regjistrohet automatikisht në modulën e trajtimit të kërkesave për përfitim.
3. Në këtë modul koordinatori i agjencisë së ISSH kontrollon nëse të dhënat e aplikimit janë plotësuar saktë dhe nëse janë ngarkuar të gjithë dokumentat justifikues për aplikimin për përfitim.
4. Nëse aplikimi është i pa plotë, aplikimi shënjohehet me flag-un “Kërkohen dokumenta shtesë” dhe individit i vjen njoftim te rubrika “Hapësira ime”, në portal për dokumentat shtesë që kërkohen për aplikim.
5. Nëse aplikimi është i plotë, koordinatori në agjencinë e ISSH konfirmon aplikimin dhe e kalon për përpunim tek Inspektori përpunues në drejtorinë rajonale përkatëse të ISSH, i cili më tej llogarit dhe cakton masën e përfitimit të aplikimit.

Procesi i punës deri në këtë moment është tërësisht i automatizuar duke minimizuar mundësinë për gabime. Në momentin që kërkesa i kalon inspektorit përpunues për të vijuar më tej me përpunimin e aplikimit, ai përcakton tipin e kartelës, tipin e përfitimit, datën e fillimit të përfitimit dhe datën e lindjes së të drejtës. Procesi i përlllogaritjes vijon më tej nga inspektori përpunues i cili përcakton: bazën e vlerësuar të përfitimit, bazën e indeksuar të përfitimit, llogaritjen e përfitimit, caktimi i përfitimit dhe data e lindjes së të drejtës. Në këto dy faza ka hapësira për gabime nga ana e inspektorit. Identifikimet e këtyre rasteve mund dhe duhet të bëhen gjatë programeve të auditimit të Drejtorisë së Inspektiveve në DRSSH dhe DSSH.

Sistemi nuk shfaq problematika nga ana funksionale në aspekt të përlllogaritjes së masës së pensionit. Gabimet janë të natyrës njerëzore apo nga pakujdesia, të bëra nga inspektorët në fazën e futjes së të dhënave (input). Gabimet më të shpeshta janë të tipologjisë: gabime në përcaktimin e datës kur lind e drejta për pension, gabime në përcaktimin e saktë të kategorisë së pagës së referencës, mos verifikim me sistemin CMIS (sistemi i kontributeve) nëse përfituesi është aktualisht në marrëdhënie pune në shtet në momentin e lidhjes së pensionit, mos përfshirja në llogaritje e periudhave të derdhjes së kontributit vullnetar etj.

Evidentimi i këtyre problematikave në sistem, bëri që grupi i punës të konkludonte se mungesa e ndërveprimit midis sistemit elektronik të kalkulimit dhe pagesës së përfitimeve (PCAMS) me

sistemin elektronik për menaxhimin e kontributeve (CMIS) ka çuar në raste të përsëritura të lidhjes së pensioneve ndërkohë që përfituesi rezulton i punësuar në shtet dhe derdh kontribute njëkohësisht. Kryesisht, kjo ndodh kur:

- Specialisti në momentin e lidhjes së pensionit nuk verifikon në sistemin CMIS nëse përfituesi është aktualisht në marrëdhënie pune.

- Në momentin e lidhjes së pensionit, përfituesi nuk figuron në marrëdhënie pune, por gjatë periudhës së përfitimit të pensionit mund të rifilloj marrëdhëniet e punës, pa pasur mundësi të identifikohet nga inspektorët në kohë reale.

Në kuadër të strategjisë së ISSH-së për informatizimin e gjithë sistemit të sigurimeve shoqërore, me qëllim përmirësimin e proceseve të punës dhe realizimin e ndërveprimit midis sistemeve, gjatë vitit 2023 ka filluar zbatimi i kontratës Nr. 42 Prot; datë 21.12.2022, me objekt: “Përmirësimi i sistemit të ISSH-së dhe infrastrukturës fizike për Institutin e Sigurimeve Shoqërore”, të nënshkruar midis palëve “I. S.” ShPK dhe “D. L.” ShPK në cilësinë e Kontraktorit dhe AKSHI-t në cilësinë e Autoritetit Kontraktor, me ISSH-në në cilësinë e Përfituesit. Sistemi i përmirësuar është marrë në dorëzim në datë 15.12.2023.

Sa më sipër, grupi i auditimit konstaton se nuk kemi ende një manual përdorimi për sistemet në të cilat të jenë të pasqyruara zhvillimet e bëra në zbatim të kontratës Nr. 42 Prot; datë 21.12.2022.

Gjithashtu, sipas rregullores së brendshme të DBI “Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit” ISSH, specifikisht pika 8. Kontrolli i aksesit, ku citohet specifikisht: “Për çdo burim informacioni të ISSH, personelit do ti jepet akses vetëm në përputhje me funksionet e tyre për kryerjen e detyrave dhe ky akses do të kontrollohet me rreptësi për të ruajtur integritetin dhe sigurinë”, konstatohet se nuk ekziston një rregullore për krijimin dhe administrimin e përdoruesve, ku përcaktohen qartë të drejtat dhe funksionalitetet e çdo përdoruesi në përputhje me proceset e tij të punës, element ky shumë i rëndësishëm në garantimin dhe mbrojtjen e integritetit, e disponueshmërisë dhe e konfidencialitetit të të dhënave.

Në vijim, nga verifikimi në sistem, rezulton se sistemi nuk të kushtëzon në vendosjen e një password-i që plotëson kriteret minimale të kompleksitetit të tij (nr minimal i gjatësisë së password, moslejimi i përdorimit të username emër ose mbiemër përdoruesi, kombinim text, numra dhe karaktere etj). Për kriteret e fjalëkalimit të përdoruesve fundor nuk janë hartuar apo implementuar standarde për parametrizimin për nga kompleksiteti dhe gjatësia e tij me qëllim rritjen e sigurisë.

Përsa i përket disponibilitetit të DRSSH-ve dhe DSSH-ve për përdorimin e sistemit, sipas DBI sistemi përdoret në masën 100% nga drejtoritë vendore, duke qenë se automatizimi i proceseve të punës e bëjnë sistemin domosdoshmëri në plotësimin e detyrave funksionale të inspektorëve.

IV. REKOMANDIME

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI

1. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Inspektimit të Pensioneve (DIP) ka konstatuar të paktën 78 raste të tërheqjes së kësteve të përfitimit, në kundërshtim me nenin 57 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, duke kërkuar shumat e përfituara padrejtësisht nëpërmjet ndalesës së pensionit në masën 50% të tij deri në shlyerjen e plotë të detyrimit. Nga ana e grupit të auditimit konstatohet se masat e marra si dhe rekomandimet e lëna nga ana e DIP për DRSSH-të, nuk janë të plota ashtu siç parashikohet në nenin 62, pika 2, të ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, ku ndër të tjera citohet se: “*Personi, që ka përfituar pension ose të ardhura të tjera nga sigurimet shoqërore, me mënyra e mjete në kundërshtim me ligjin, detyrohet ta kthejë të gjithë shumën e marrë tepër, të cilën e shlyen duke iu mbajtur çdo muaj 50 për qind e këstit mujor të përfitimit. Gjithashtu, personi dënohet me gjobë në masën katërfish të dëmit të shkaktuar*”.

Grupi auditimit ka konstatuar se kjo masë e parashikuar në nenin 62, pika 2, nuk është aplikuar për vite me radhë.

Nga përmbajtja e nenit 62 të sipërcituar, rezulton se individ i cili ka përfituar pension ose të ardhura të tjera nga sigurimet shoqërore, me mënyra e mjete në kundërshtim me ligjin, krahas detyrimit për të kthyer shumën e përfituar (restitucioni i dëmit të shkaktuar) dënohet edhe me gjobë, në një masë

të barabartë me 4-fishin e dëmit që i ka shkaktuar autoritetit të sigurimeve. Parashikimi i një mase të tillë në nenin 62 të ligjit, vlerësohet jo proporcional në raport me qëllimin për të cilin është parashikuar aplikimi i sanksionit. Për vlerësimin e proporcionalitetit duhen mbajtur në konsideratë disa kriteret: (i) nëse objektivi i ligjvënësit është mjaftueshmërisht i rëndësishëm për të justifikuar kufizimin e së drejtës; (ii) nëse masat e marra janë të lidhura në mënyrë të arsyeshme me objektivin, ato nuk mund të jenë arbitrare, të padrejta ose të bazuara mbi vlerësime alogjike; (iii) nëse mjetet e përdorura nuk janë më të ashpra se sa duhet për të arritur objektivin e kërkuar, sa më të mëdha efektet e dëmshme të masës së përzgjedhur, aq më tepër duhet të jetë i rëndësishëm objektivi për t'u arritur, në mënyrë që masa të justifikohet si e nevojshme. Proporcionaliteti i një kufizimi vlerësohet rast pas rasti, duke pasur parasysh që kriteret e mësipërme të mos analizohen veç e veç, por të ndërthurura me njëra-tjetrën.

Në këtë kuadër, sanksionimi me ligj i një mase fikse të dënimit me gjobë (pa përcaktuar një hapësirë midis dy kufijve minimal dhe maksimal), përbën një parashikim jo proporcional dhe diskriminues në raport me kategorinë e përfituesve të skemës së sigurimeve shoqërore, e drejta e të cilëve gëzon mbrojtje të posaçme me Kushtetutë (Objektivat Socialë, neni 59, shkronja e).

Vlerësohet se, masa e përdorur për të kontrolluar shkeljet në fushën e sigurimeve, në situatën kur individit ka vepruar në shkelje të kriterëve ligjore mbi bazën e të cilëve mund të realizojë përfitimin nga skema e sigurimeve, është jo proporcionale në raport me atë që përfiton subjekti. Pavarësisht e natyrës jo proporcionalë për sa kohë dispozita nuk bëhet objekt i goditjes për antikushtetutshmëri, ajo mund të propozohet të ndryshohet, duke vlerësuar ndryshim ligjor.

(Më hollësisht trajtuar në pikën.2.4, faqe 50-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1 Rekomandimi: Këshilli Administrativ, të propozojë në strukturat përkatëse përmirësimin e nenit 62, pika 2 të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, ku minimalisht të përmbajë një klasifikim të masës së penaltetit në varësi të shkeljes, duke parashikuar ose kufij maksimalë dhe minimalë të vlerës së gjobës, ose aplikimin e penaltetit të kategorizuar me fasha.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi mbi saktësinë e raportimit të planit dhe faktit të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe rezultatit fiskal të ISSH ka rezultuar se:

a. Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara nga ISSH (kontributet/të ardhura tatimore) dhe të dhënave të Tabelës së treguesve fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, Kapitulli II.3 “Të ardhurat nga fondet speciale”, rezulton se fakti i të ardhurave nuk është i rakorduar. Sipas të dhënave të Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MFE) fakti i të ardhurave nga fondet speciale (sigurimet shoqërore) paraqiten në vlerën 124,628 milionë lekë, ndërsa nga ISSH, janë deklaruar 124,618 milionë lekë, ose deklaruar nga MFE me 10 milionë lekë më shumë.

b. Sipas MFE “Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga kontributet për sigurimet Shoqërore nga DPT për vitin 2023” midis të dhënave të DPT dhe të dhënave të rakorduara midis ISSH me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbi të ardhurat nga kontributet për sigurimet rezulton një diferencë në shumën 1,294 mijë lekë, që është pakësim i të ardhurave në debi të llog.75. Ky sistemim i rakorduar midis ISSH dhe MFE, nuk është reflektuar në të dhënat e DPT-së. Të ardhurat nga kontributet sipas ISSH janë në total shumën 119,979,210 mijë lekë, ndërsa sipas DPT-së janë në total në shumën 119,980,504 mijë lekë.

c. Nga verifikimi i të dhënave mbi planin dhe faktin e shpenzimeve për ISSH, në raport me Treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, të raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është evidentuar se përse i përket planit, midis dy institucioneve ka një mos rakordim në shumën 4,011 milionë lekë. Sipas të dhënave të ISSH, referuar gjithë akteve ligjore dhe nënligjore mbi alokimin e fondeve, plani i shpenzimeve është në shumën 171,326 milionë lekë, ndërsa nga MFE është raportuar në shumën 167,315 milionë lekë. Kjo diferencë ju përket shtesave në buxhetin e ISSH me VKM, në lidhje me financimin e programeve të veçanta, me shpërblimin e fund vitit të pensionistëve, me indeksimin e pensioneve.

d. Rezultati fiskal i vitit, që paraqitet si diferencë ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit, tregon se nevojat për financimin e skemës së pensioneve, i cili krahasuar me vitin 2022, ka qenë 62,872 milionë lekë, dhe se në vitin 2023 është ulur në shumën 16,145 milion lekë, por për shkak të rezultatit fiskal pozitiv, nevoja për përdorimin e këtij financimi ka qenë në shumën 45,620,073 mijë lekë, ose 1,107,162 mijë lekë më pak se financimi i tërhequr, shifra që mbeten ende të larta.

e. Të ardhurat nga kontributet vijnë në mos mbulojnë shpenzimet e skemës së pensioneve për qytetin e fshatit, duke vijuar me një deficit, i cili rezulton të jetë 18,358 milionë lekë, ose 0.79% i PBB. Krahasuar me vitin 2022 ka një përmirësim prej 7,680.5 milionë lekë, ose 0.43% të PBB, nga 0.79% që zinte në vitin 2022.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 20-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit të shqyrtojnë mospërputhjet me Treguesit e Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, përse i përket fondeve për ISSH, të raportuara në Kapitullin II “Të ardhurave tatimore”; II.3.1 “Të ardhura nga Fondet Speciale” (ISSH) dhe në Kapitullin I “Shpenzimet korrente”, pika 5 “Shpenzimet për fondet speciale” (ISSH). Instituti i Sigurimeve Shoqërore në vijimësi të mundësojë rritjen e të ardhurave dhe numrin e kontribuesve, të cilat do të sjellin uljen e defiçitit të skemës së pensioneve, zvogëlimin e subvesionit nga buxheti i shtetit dhe përmirësimin e raportit kontribute me prodhimin e brendshëm bruto (PBB).

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i planifikimit, realizimit dhe raportimit të planit të të ardhurave nga ISSH rezulton se: Referuar ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, i ndryshuar, si dhe akteve ligjore e nënligjore për ndryshim të tij, ka rezultuar se MFE i ka dërguar ISSH-së, planin e të ardhurave dhe shpenzimeve, i cili detajohet në të ardhura nga kontributet dhe nga transfertat e buxhetit të shtetit.

- Plani i të ardhurave me ndryshime për ISSH, nga kontributet është në shumën 124,599 milion lekë dhe përfaqëson të ardhura tatimore të klasifikuara si të tilla edhe në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit.

- ISSH në realizimin e të ardhurave nga të vetë punësuarit në bujqësi në shumën 2,901,153 mijë lekë ka përfshirë edhe të ardhura nga gjodat në shumën 185,640 mijë lekë.

Nga ISSH, nuk është bërë një detajim i saktë i planit dhe faktit të realizimit të të ardhurave, referuar klasifikimit në të ardhura tatimore dhe jo tatimore sipas Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pasi në fakt ka përfshirë në mënyrë jo të drejtë, si realizim i të ardhurave, edhe të ardhura jo tatimore (nga gjodat, kamatat, interesat), gjithsej në total në shumën 1,740,926 mijë lekë (nga DPT për 561,156 mijë lekë dhe nga ISSH 185,640 mijë lekë + 994,121 mijë lekë). ISSH duhet t’i referohej vetëm të ardhurave tatimore “nga kontributet”, të cilat sipas rakordimeve me DPT, MFE, ISSH në fakt janë realizuar në total në shumën 122,877,175 mijë lekë (119,418,054 mijë lekë nga DPT dhe 3,427,402 mijë lekë nga ISSH; të ardhura të tjera derdhur në llogari të ISSH-së në shumën 31,719 mijë lekë).

Sa më sipër, realizimi i të ardhurave nga kontributet e mbledhura nga DPT dhe ISSH, kundrejt planit të miratuar nga MFE në shumën 124,599,000 mijë lekë, është 122,877,175 mijë lekë, pra me një mosrealizim në shumën 1,721,825 mijë lekë ose realizuar në masën 98,6 % në raport me planin e buxhetit dhe jo 100% siç është raportuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën.2.3, faqe 20-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1.Rekomandimi: Strukturat drejtuese të ISSH-së, në vijim, në detajimin e planit të të ardhurave nga kontributet dhe të realizimit të tyre, të mos përfshijnë të ardhurat jo tatimore (Të tjera DPT dhe ISSH), në zbatim të klasifikimit të të ardhurave tatimore dhe jo tatimore, sipas Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pjesë e ligjit dhe akteve normative.

Në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i të dhënave mbi detyrimet e rapambetura për kontribute të sigurimeve shoqërore, konstatohet:

a) Në fund të vitit 2023 konstatohet rritje e numrit të subjekteve debitore me 1,019 subjekte si dhe rritje të detyrimeve të prapambetura me 1,327,717 mijë lekë.

- Deri në 31.12.2023, fondit të sigurimeve shoqërore nuk i janë vënë në dispozicion rreth 18,456,251 mijë lekë detyrime të prapambetura, që u përkasin 110,129 subjekteve debitore.

- Subjektet aktive debitore rezultojnë në numër 44,980 dhe në vlerë 8,585,900,712 lekë, të cilat zënë rreth 41% të numrit gjithsej të subjekteve debitore dhe 47% të totalit të detyrimit.

- Në total vlera për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore, të papaguara në afat për subjektet ShPK, sipas kategorisë buxhetore, jo buxhetore, subjekte private është 203,245,810 lekë ose 2.4% e totalit të detyrimeve të subjekteve aktive.

b) Detyrimet kontributive të cilat ndiqen nga ISSH, janë në total 5,882,737,711 lekë, të cilat në krahasim me një vit më parë, janë rritur në shumën 225,014,906 lekë. Gjendja e kësaj kategorie të debitorëve krijon probleme, pasi mos shlyerja e detyrimeve mund të ndërpritet për shkak të moshës, e cila bën edhe likuidimin e tyre të vështirë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën.2.3, faqe 20-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore t'i kërkojë Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zgjidhje të problematikave të mbartura midis bashkëpunimit të saj dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me detyrimet e kontributeve për sigurime shoqërore nga subjektet publike dhe private, të cilat rezultojnë në 110,129 subjekte debitore në vlerë 18,4 miliard lekë.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria kontributeve në qendër dhe në drejtoritë rajonale të marrë masa që nëpërmjet rritjes së trajnimeve dhe bashkëpunimit më të madh midis tyre, të fokusohet në llogaritjen e saktë të përfitimeve dhe monitorimin e rregullt të tyre, me qëllim uljen e detyrimeve kontributive që ndiqen nga vet institucioni, të cilat rezultojnë me 5,9 miliardë lekë, me synim mbrojtjen e sigurinë financiare të pensionistëve dhe për funksionim të qëndrueshëm të sistemit të sigurimeve shoqërore.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i të dhënave mbi listë pagesat sigurimeve shoqërore të munguara, konstatohet:

-Mungesë bashkëveprimi e komunikimi të rregullt ndërinstytucional ndërmjet ISSH dhe DPT, problematikë e cila vijon ndër vite. Nga ISSH janë ndjekur në vijimësi mangësitë në lidhje me sistemin e transmetimit të listë pagesave dhe ka kërkuar bashkëpunimin dhe angazhimin e organeve tatimore, për sa i takon rolin të saj në mbledhjen e detyrimeve të prapambetura për kontribute të sigurimeve shoqërore, për të cilat ajo nuk ka tagër të plotë për të vepruar dhe ndërmarrë masa shtrënguese, pasi menaxhimi i tyre kryhet nga DPT.

-Në fund të vitit 2023 Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka dërguar në ISSH gjithsej 15,173,028 listë pagesa të formatit elektronik që i përkasin periudhës kohore 2012 – 2023, krahasuar me vitin 2022 ka dërguar më shumë 1,384,460 listë pagesa, por ende vijnë problematika në transmetimin e tyre drejt ISSH-së.

-Në fund të vitit 2023 rezultojnë gjithsej 1,482,748 listë pagesa të munguara (format letër) të subjekteve paguese që i përkasin periudhave tatimore 2006–2012.

-Për periudhën 1994-2011, rezultoi se nuk kishte përfunduar procesi i marrjes në dorëzim të listë pagesave të munguara të format letër, sipas subjekteve.

(Më hollësisht trajtuar në pikën.2.3, faqe 20-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandim: Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria e Arkivit Qendror dhe Sektori i Arkivës në drejtoritë rajonale të sigurimeve shoqërore, të marrin masa për përditësimin e të dhënave për listë pagesat e munguara për kontributet e sigurimeve shoqërore, për subjektet buxhetore, jo buxhetore, biznes i madh, biznes i vogël, me qëllim plotësimin e fondit të arkivës dhe përfitimin e qytetarëve nga skema e sigurimeve shoqërore.

ISSH për personat “Të vetë punësuar që kanë edhe të punësuar të tjerë”, që rezultojnë të kenë derdhur kontribute, të vijnë me njoftime dhe sensibilizime, me qëllim maksimizimin e grumbullimit të listë pagesave të kësaj kategorie.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i planifikimit dhe zbatimit të buxhetit të vitit 2023 rezulton se:

-Planifikimi i treguesve të fondit të sigurimeve shoqërore nuk bazohet mbi një planifikim të mirë studiuar, dhe se nuk është bërë mbi analiza treguesish realë, konkretisht:

-Në planifikimin strategjik për vitin 2023, tavanet e shpenzimeve të dërguara nga MFE janë 585 milionë lekë më pak se sa shpenzimet e planifikuara nga ISSH. Hartimi i treguesve të buxhetit vjetor dhe afatmesëm në fazën strategjike kryhet i përqëndruar në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH-së, duke mos përfshirë 15 njësitë shpenzuese rajonale, me arsyetimin e institucionit se nuk kanë tregues të plotë e të mjaftueshëm makro, duke mos marrë kështu në konsideratë përvojat, eksperiencat dhe rezultatet më pozitive të punës së tyre.

-Konstatohen ndryshime në buxhetin e shpenzimeve administrative të cilat nuk janë bazuar në analiza të thelluara për çdo zë shpenzimesh, dhe se në disa raste kanë qenë të pa argumentuar, pasi realizimi është më pak se plani fillestar.

Shpenzimet administrative të ISSH-së për vitin 2023 janë realizuar më pak se plani i ndryshuar me 253,296 mijë lekë, ose 7% më pak. Realizimi i tyre është mbajtur nën kontroll, por ndryshimet e bëra gjatë vitit në shumën 100,680 mijë lekë tregojnë për një realizim jo real të tyre. -Shqyrtimi dhe miratimi i PBA 2023-2025 nuk rezulton të jetë miratuar në Këshillin Administrativ, në kundërshtim me nenin 75 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën.2.3, faqe 20-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës në vijim, të marrë masa të duhura për një planifikim sa më real të fondeve buxhetore nëpërmjet analizave të mirë studiuar të sistemit të sigurimeve shoqërore me qëllim shmangien e transferimeve buxhetore midis artikujve dhe midis njërive shpenzuese. Shqyrtimi dhe miratimi i PBA-së të ndjekë të gjitha hapat e procesit deri në miratimin në Këshillin Administrativ, në përputhje me kërkesat e ligjit të sigurimeve shoqërore.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezulton se nga DIP janë 9,614 dosje të pa inspektuara dhe të pa certifikuara, nga të cilat 8,775 dosje pensioni të pa inspektuara, që i përkasin vitit 2020 si dhe 839 dosje që i përkasin viteve 2019-2021, për rishqyrtim. Në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993, neni 62, pika 3. Sipas përcaktimeve të këtij neni, duhej të ishin marrë masa, me qëllim shmangien e efekteve financiare për ISSH-në dhe buxhetin e shtetit për shkak të tejkalimit të afatit ligjor 3 vjeçar për kërkimin e tepërcave të përfituara padrejtësisht nga përfituesit. Për këtë, nga ana e grupit të auditimit vihet re një mungesë vullneti për të arritur qëllimet e përcaktuara brenda afateve, edhe pse kjo nga ana e KLSH është konstatuar dhe kërkuar ndër vite.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 50-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm, të hartojë plan masash me afate, për të mundësuar çertifikimin e dosjeve të pa certifikuara, duke vlerësuar të angazhojë edhe Drejtorinë e Përfitimeve në ISSH, e cila ka në përbërje të saj specialistë të fushës së lidhjes së pensioneve. Gjithashtu, të marrë masa për inspektimin dhe çertifikimin e të gjitha dosjeve të përfituesve brenda afatit 3-vjeçar.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi është konstatuar se në DRSSH-të, ndalesa e masës së pensionit në një pjesë të konsiderueshme është kryer në masën 20%, kjo jo sipas përcaktimeve të nenit 62, pika 2, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar. Si pasojë dëmi i shkaktuar do të dojë një kohë më të gjatë për tu kthyer, ose në rastin më të keq nuk mund të mblidhet më. Gjithashtu, nga debitorët progresiv rezulton se ndalesa e masës së pensionit nuk përditësohet sipas indeksimit të pensionit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 50-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa që DRSSH-të të ndryshojnë masën e ndalesës së pensioneve nga 20% në 50%, ashtu siç parashikohet në përcaktimet e nenit 62, pika 3, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar, si dhe të marrë masa dhe të sigurohet që ndalesa e pensionit të jetë në përpjestim të drejtë me indeksimin e tij.

Menjëherë

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të përfituesve për pensione në sistemet CMIS dhe PCAMS, janë konstatuar 3 raste të përfitimit të padrejtë, pasi: a) përfituesit kanë rezultuar njëkohësisht ekonomikisht aktiv në administratën publike/institucione shtetërore; b) nga përlllogaritja e bërë nga grupi i auditimit kanë rezultuar diferenca në vlerën prej 110,337 lekë në 2 raste janë evidentuar nga përlllogaritjet e bëra nga Dega e Përfitimeve Tiranë dhe një rast evidentuar që përfituesi ka kaluar ekonomikisht aktiv pas certifikimit nga Drejtoria e Inspektimit, përkatësisht dosjet me nr. 282853, nr. 113409 dhe nr. 112426), në kundërshtim me nenin 57 të Ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 i ndryshuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2.4, faqe 50-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për analizimin e situatës si dhe të nxjerrë përgjegjësitë sipas rasteve, të marrë masa për rishqyrtimin e dosjeve të nxjerra me problematikat e trajtuara dhe të evidentuara nga ana e grupit të auditimit, të marrë masa për ngritjen e një grupi pune i cili të kryej në mënyrë periodike ballafaqimet midis sistemit CMIS dhe PCAMS, duke krijuar mundësinë që përfituesit në shkelje të nenit 57 të arrihen të evidentohen në një kohë sa më të shpejtë duke minimizuar vlerën debitorë, si dhe të marrë masa në përpilimin e një shkrese ku të informojë të gjithë institucionet shtetërore, ti bëjë me dije në lidhje me përcaktimet ligjore kryesisht të nenit 57. Kjo, për t'u siguruar që drejtoritë e financave përkatëse të lajmërojnë/njoftojnë në kohë reale nëpunësit të cilët kanë mbushur moshën e pensionit sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi rezultoi se në rreth 462 dosje përfitimi, DRSSH/DSSH nuk kanë zbatuar afatet e përcaktuara sipas ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, neni 62, pika 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën.2.4, faqe 50-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Titullarët e DRSSH/DSSH-ve, të marrin masa dhe të sigurohen që dosjet e konstatuara me problematikë nga ana e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve, të rishqyrtohen brenda afateve të përcaktuara në Rregulloren e DIP dhe të përcaktimeve ligjore sipas Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, neni 62, pika 2.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, në sistemin CMIS dhe PCMAS, në lidhje me inspektimin e pensioneve të pleqërisë rezultoi se: për 8 raste, me vlerë debitorë gjithsej 762,484 lekë, të çertifikuara, nuk është respektuar masa e ndalesës me 50% të kështit të përfitimit, por në masën 20%, në kundërshtim me nenin 62, pika 2, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar.

Nga verifikimet e kryera në sistemin CMIS dhe PCMAS, në lidhje me të drejtën e përfitimit për pension, janë konstatuar përfitime të padrejta, pasi përfituesit për pension invaliditeti dhe pleqërie kanë rezultuar njëkohësisht edhe të punësuar, kjo në 15 raste në vlerën 360,427 lekë, të pa çertifikuara nga DIP dhe në 9 dosje në vlerë 192,754 lekë, të çertifikuara nga DIP, veprime në kundërshtim me pikën 2 dhe 3, të nenit 57, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 50-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Durrës, të marrë masa që në vijimësi struktura përgjegjëse të jetë më vigjilente duke i evidentuar dhe eliminuar efektet negative që mund të rrjedhin prej këtij shkak, në kohë sa më të shpejtë.

Në vijimësi

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të vogël rezultoi: Nga 19 procedura të realizuara gjithsej, 14 prej tyre rezultuan me pa rregullsi si më poshtë: dy procedura prokurimi me vlerë gjithsej 1,468,000 lekë pa TVSH, janë zhvilluar duke copëzuar fondin limit, pasi i përkasin të njëjtit objekt prokurimi - "Kërkesë për shtypshkrime", konkretisht: "Blerje artikuj të kancelarisë me Logon e ISSH-së për vitin 2024" me fond limit 485,000 lekë dhe "Shtypshkrime për Drejtorinë e Kontributeve për Sektorin e të Vetëpunësuarve në Bujqësi dhe

Sigurimit Vullnetar”, me fond limit 983,000 lekë, veprim në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56, pika 1.

- Për 6 (gjashtë) procedura prokurimi të blerjeve me vlerë të vogël rezultoi se fatura tatimore nuk është likuiduar brenda afateve ligjore, duke sjellë risk për krijimin e detyrimeve kontraktuale ndaj operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me nenin 7 të Ligjit nr. 48/2014, datë 24.04.2014, “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare.

- Në 5 (pesë) procedura prokurimi të blerjeve me vlerë të vogël rezultoi se përllogaritja e fondit limit nuk është bazuar në marrjen e ofertave mbi çmimet e tregut, duke mos iu krijuar mundësi pjesëmarrje më shumë OE, por është bazuar në çmimet e kontratave të mëparshme të realizuara nga vetë institucioni apo nga autoritete të tjera kontraktore, në kundërshtim me VKM-në nr.285, datë 09.06.202 neni 13, 56 dhe 76 të “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

- Në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje karburanti” nga subjekti “O”, rezultoi se: a) nuk është paraqitur sipas Ftesës për Ofertë licenca përkatëse, (e vlefshme), për ushtrim aktiviteti në tregtinë me pakicë të karburanteve për automjetet për përdorim nga konsumatorët fundor, veprime këto në kundërshtim me Ligjin 162 “Për Prokurimin Publik”, datë 23.12.2020, neni 77, pika 1, neni 92 pika 3 si dhe me VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 56, pika 4.

b) nuk është paraqitur dokumenti i pronësisë apo kontratë qeraje (të vlefshme) të pikave të shpërndarjes të karburantit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin 162 “Për Prokurimin Publik”, datë 23.12.2020, neni 77, pika 1, Neni 92 pika 3 si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 56, pika 4.

-Në të gjitha procedurat e prokurimit të sistemit dinamik të biletave të Transportit Ajror Ndërkombëtar, Ftesa për pjesëmarrjen në takimet e organizuara, ardhur në adresë të institucionit është paraqitur në procedurën e prokurimit në gjuhën angleze dhe jo në gjuhën shqipe, veprime këto në kundërshtim me VKM 285, “Për miratimin e rregullave të prokurimit”, neni nr. 24, “Udhëzimet për ofertuesit/kandidatët”, pika 2.

Në të gjitha procedurat e prokurimit me vlerë të vogël:

a) Nuk është hartuar Relacioni përmbledhës, në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 2, 84.

b) Dosjet e prokurimit nuk janë të inventarizuar dhe arkivuar, në kundërshtim me nenin 3, 29 “Norma Tekniko - Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

c) Në të gjitha procedurat e prokurimit të blerjeve me vlerë të vogël mungon formulari i vetëdeklarimit, në kundërshtim me VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Neni 26.

- Njësia e prokurimit (funksionale) nuk ka marrë pjesë në asnjë trajnim në fushën e prokurimeve, në kundërshtim me LPP dhe Manualin e Prokurimit dhe VKM nr.285, datë 9.05.2021, neni 74, pika 1, paragrafi 2.

(Më hollësisht trajtuar në pikën .2.7, faqe 65-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Titullari Instituti të Sigurimeve Shoqërore të zbatojë menjëherë masat korrigjuese për të rregulluar shkëlqjen e procedurave të blerjeve me vlerë të vogël nëpërmjet shqyrtimit të detajuar të proceseve të blerjes për rastet e mëparshme, një rivlerësim të dokumentacionit dhe procedurave të përdorura për marrjen në dorëzim të aktiveve të furnizuara, për të siguruar përputhshmërinë me ligjin dhe rregulloret në fuqi të sektorit publik.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt “Sigurim i Aseteve” rezultoi se: primi i sigurimit të asetëve të siguruara (ndërtesa dhe instalime, paisje teknike) nga operatori ekonomik fitues janë bërë mbi vlerën jo reale të tyre, të paraqitura në bilancin e konsoliduar të vitit 2022, për 176.292.568 lekë më pak, e cila sjell mos mbulim të plotë të sigurimit të të gjithë vlerës së ndërtesës në rast të ndodhjes së rrezikut. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 65-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës dhe grupi i punës i ngritur para zhvillimit të procedurës së prokurimit për sigurimin e asetëve të institucionit qendror dhe të drejtorive rajonale të marrin masa dhe të rakordojnë paraprakisht vlerat e asetëve që do të sigurohen, dhe të vlerësojnë llojin e primit të sigurimit sipas rrezikut që paraqet çdo aset.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer për procedurën e prokurimit me objekt Rikonstruksion godinës, konstatohet se nga njësia e prokurimit janë vendosur kritere të veçanta jo në përputhje me objektin e prokurimit, konkretisht: në lidhje me punësimin e një arkitekti si drejtues teknik, kriter ky i ezauruar në fazën e procedurës së prokurimit për hartimin e projektit të rikonstruksionit të godinës, si dhe me deklarimin në listëpagesë të fuqisë punëtore për një periudhë jo më pak se 3 muaj, para shpalljes së tenderit, *kritere këto në kundërshtim me Nenin 78, pika 2 e VKM-së nr.285, datë 09.06.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”.*(Më hollësisht trajtuar në pikën.2.7, faqe 65-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandim: Autoriteti Kontraktor, Njësia e Prokurimit në procedurat e prokurimit të mallrave /shërbimeve dhe punëve që do zhvillohen në vazhdimësi, të marrë masa që çdo aplikimin për kriteret e veçantë të jetë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Vendosja dhe vlerësimi i çdo kriteri duhet të jetë i argumentuar dhe i dokumentuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se gjatë vitit 2023, Drejtoria e Auditit të Brendshëm ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur 3 vende vakante, dy në pozicionin auditues, në Degën e Auditimit Financiar dhe një në pozicionin auditues, në Sektorin e Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut, njësia e burimeve njerëzore vetëm një rast ka publikuar për pozicionin auditues në Degën e Auditimit Financiar.

-Gjithashtu nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, ka rezultuar se: në vitin 2022 edhe në vitin 2023, nuk ka planifikuar dhe kryer asnjë auditim në sistemet e teknologjisë së informacionit në lidhje me ruajtjen e asetëve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive për të arritur qëllimet dhe objektivat e Institucionit, edhe pse vlerësimi i nivelit të riskut për vitin 2022 dhe 2023 në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit në DAQ është vlerësuar i lartë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën.2.8., faqe 81-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ISSH dhe Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm të marrin masa për plotësimin e pozicioneve vakante në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm.

Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për planifikimin e auditimit të sistemeve IT.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer, në lidhje me aksesin që kanë inspektorët për të hyrë në sistemin elektronik të kalkulimit dhe pagesës së përfitimeve (PCAMS) rezultoi se nuk të kushtëzon në vendosjen e një fjalëkalimi që plotëson kriteret minimale të kompleksitetit të tij.

Gjithashtu nuk janë hartuar apo implementuar standarde për parametrizimin për nga kompleksiteti dhe gjatësia e tij me qëllim rritjen e sigurisë, veprime në kundërshtim me pikën 8 të Rregullores së brendshme *“Mbi parimet dhe rregullat e përgjithshme të sigurisë së informacionit”*, u konstatua se nuk ekziston një rregullore për krijimin dhe administrimin e përdoruesve, ku përcaktohen qartë të drejtat dhe funksionalitetet e çdo përdoruesi në përputhje me proceset e tij të punës.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 89-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Nga strukturat përgjegjëse të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të merren masa për hartimin dhe miratimin e rregullores për krijimin dhe administrimin e përdoruesve të brendshëm si dhe për hartimin dhe miratimin e politikave mbi fjalëkalimet e përdoruesve në sistem ku të përcaktohet kompleksiteti minimal në gjatësi, karaktere speciale apo numra, me qëllim rritjen e sigurisë.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kryer, për zhvillimet e bëra mbi sistemet kompjuterike në përdorim të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në zbatim të kontratës Nr. 42 Prot; datë 21.12.2022, me objekt: “Përmirësimi i sistemit të ISSH-së dhe infrastrukturës fizike për Institutin e Sigurimeve Shoqërore”, nuk janë hartuar ende manualët e përdorimit të sistemeve në të cilat të jenë të pasqyruara zhvillimet dhe përmirësimet në sistem.

(Më hollësisht trajtuar në pikën 10, faqe 89-92 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1. Rekomandimi: Nga strukturat përgjegjëse të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të merren masa për të hartuar manualët e reja të përdorimit të sistemeve, duke pasqyruar në to të gjitha zhvillimet e kryera mbi sistemet e informacionit, në zbatim të kontratës Nr. 42 Prot; datë 21.12.2022, me objekt: “Përmirësimi i sistemit të ISSH-së dhe infrastrukturës fizike për Institutin e Sigurimeve Shoqërore”.

Menjëherë

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi ka rezultuar se nuk janë kryer plotësisht trajnimet për stafin e ISSH-së, në përputhje me planin vjetor të miratuar në fillim të vitit.

-ISSH funksionon mbi rregulloren e vitit 2018, kjo dhe pas ristrukturimit të bërë në vitin 2023 ende rezulton e pa përditësuar dhe miratuar nga Këshilli Administrativ, veprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 7303 “Për Sigurimet Shoqërore në republikën e Shqipërisë”, neni nr. 74 “Kompetencat e Këshillit Administrativ”, pika 1/e.

-Listëprezenca nuk përpilohet dhe firmosen nga Drejtorët e Drejtorive/ përgjegjësit e sektorëve, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 69.

- Format i listë pagesës në ISSH, nuk rezulton të jetë plotësisht në përputhje me udhëzimin e përbashkët të MFE dhe DAP nr. 1, datë 21.05.2021, “Për formën, elementët dhe plotësimin e listë pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

- Listë pagesat përgatiten nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, dhe më pas nuk kryhet kontroll i menjëhershëm nga Drejtoria e Financës, në kundërshtim me Urdhërin e Brendshëm nr.1298, datë 16.02.2018, pika 9. *“(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 61-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

17.1. Rekomandimi: Drejtori i përgjithshëm të marrë masa për miratimin në Këshillin Administrativ të Rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e ISSH-së në përputhje me strukturën organizative aktuale.

-Drejtorja e Administrimit të Përgjithshëm në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të realizojnë ndarjen e përdorimit të sistemit financiar (Sistemit të pagave), me përdorues të veçantë sipas përgjegjësi përkatese që duhet të ketë secila drejtori.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditimi: Nga ana e ISSH nuk është respektuar afati ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, në kundërshtim me pikën nr. 2, neni 30, të ligjit nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Në total janë rekomanduar 16 masa organizative, të cilat janë pranuar nga ISSH dhe nga auditimi rezulton: janë realizuar 9 masa, është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe janë në procesin e realizimit 6 masa. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 10 faqe 11-14-107 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

18.1. Rekomandimi: Këshilli Administrativ të shqyrtojë dhe të analizojë në veçanti zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, duke nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin dhe/ose mosrealizimin në afat, si dhe të marrë masa që të sigurojë zbatimin e plotë të tyre.

Menjëherë

D. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi dosjeve të pensioneve, referuar sistemit CMIS dhe PCAMS, në lidhje me të drejtën e përfitimit, janë konstatuar parregullsi në 10 raste në vlerën 322,379 lekë, kjo pasi përfituesit e pensionit kanë rezultuar njëkohësisht edhe ekonomikisht aktiv në administratën publike/institucione shtetërore; e llogaritjes së gabuar nga Njësitë e Përfitimeve dhe Drejtoria e Inspektimit, në kundërshtim me nenin 57, të Ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2,4, faqe 51-55të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1. Rekomandimi: Drejtoria e Inspektimit të marrë masa që të ri kontrolloje dhe të evidentojë, përfitimet e llogaritjes së gabuar nga Njësitë e Përfitimeve, më qëllim arkëtimin e tyre.

Menjëherë

E. MASA DISIPLINORE

E.1 Për punonjësit në marrëdhënie pune.

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 21, pika 3, germa h si dhe neni 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Rregullores nr.3/2, datë 26.02.2008 “Për personelin e institutit të sigurimeve shoqërore”, dhe të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH-së, që bazuar në performancën e secilit punonjës dhe të shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore, si më poshtë:

a- “Mbajtja e 1/3 e pagës së plotë, për një periudhë 6 (gjashtë) muaj” deri në “Largim nga puna” për 2 punonjës:

1. Z. V.A., me detyrë inspektor i Degës së Përfitimeve (DRSSH Berat).

2. Znj. B.C., me detyrë inspektor i Degës së Përfitimeve (DRSSH Tiranë).

Për shkeljet e si mëposhtme:

-Në dosjen nr.282853 e cila i përket përfituesit I. Xh., ka rezultuar debitor në vlerën 707,024 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht ekonomikisht aktiv). Nga verifikimet e kryera, grupi i auditimit ka konstatuar që vlera debitorë nuk është 707,024 lekë, por 730,104 lekë, me një diferencë në masën debitorë prej 23,080 lekë. U konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv, ç’ka do të thotë se ka qene në kundërshtim me pikat 2 dhe 3 të nenit 57, Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

-Në dosjen nr.113409 e cila i përket përfituesit A., ka rezultuar debitor në vlerën 81,187 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht ekonomikisht aktiv). U konstatua që vlera debitorë nuk është 81,187 lekë, por 168,444 lekë, me një diferencë në masën debitorë prej 87,257 lekë. Nga grupi i auditimit u konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv.

-Në dosjen nr.112426 e cila i përket përfituesit D.LL., ka rezultuar debitor në vlerën 31,304 lekë (përfitues pensioni, njëkohësisht ekonomikisht aktiv). U konstatua se përfituesi që në momentin e lidhjes së pensionit ka qenë ekonomikisht aktiv.

Sa më sipër, inspektorët e përfitimeve, nuk kanë kryer verifikimet e duhura në sistemet përkatëse, duke krijuar një dëm ekonomik prej 141,641 lekë në buxhetin e shtetit.

b- “Vërejtje” për 28 punonjës, me detyrë specialistë të DIP dhe inspektorët e përfitimeve, si më poshtë:

znj. A.V dhe specialisti i DIP, i cili ka inspektuar dosjen nr. 281536-37; znj. A. C; znj. J. S; znj. I.A; z. O.A; znj. A.M; znj. E.L; z. V.S; z. K.G; z. G.M; znj. A.N; z. E.Sh; znj. M.C; znj. E. D; znj. I.A; znj. K.A; znj. E.D; znj. A.B; z. E.J; znj. E.H; znj. N.Ç; znj. V.N; znj. H.K; znj. D.B; znj. B.R; znj. A.B; z. H. F;

Për shkeljet e mëposhtme:

-Nga auditimi kryer në sistemin CMIS dhe PCMAS, në lidhje me inspektimin e pensioneve të pleqërisë rezultoi se nuk është respektuar masa e ndalesës me 50% të këstit të përfitimit, por në masën 20%, në kundërshtim me nenin 62, pika 2, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993 i ndryshuar.

-Nga verifikimet e kryera në sistemin CMIS dhe PCMAS, në lidhje me të drejtën e përfitimit për pension, janë konstatuar përfitime të padrejta, pasi përfituesit për pension invaliditeti dhe pleqërie kanë rezultuar njëkohësisht edhe të punësuar, veprime në kundërshtim me pikën 2 dhe 3, të nenit 57, të Ligjit 7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar.

-Ka patur diferenca në vlerë nga përlllogaritja e grupit të auditimit, krahasuar me vlerën e nxjerr nga Njësitë e Përfitimeve dhe Drejtoria e Inspektimit.

c- “Vërejtje”, për Drejtuesit Rajonal dhe Kryetarët e Degëve të Përfitimeve të DRSSH/DSSH Tiranë, Berat, Dibër, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastër, Korçë, Kukës, Tropojë, Lezhë, Shkodër, Sarandë dhe Vlorë.

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT